

RAMIZ LIKA

# DALLGËT E DETIT

NOVELË



RAMIZ LIKA

DALLGËT E DETIT

(NOVELË)



SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

Vera nuk është kthyer akoma nga stërvitja e çetave territoriale. Ajo kthehet më vonë nga shoqet e tjera, se është komisare. Përveç kësaj ajo është sekretare e grup-organizatës së partisë në sektorin e parë të kooperativës bujqësore. Pra ka një punë të dyfishtë. Djali ynë, vogëlushi Arben, është mërzitur, qan. E marr dhe përpinqem ta pajtoj. Po gënjehet vështirë, shejtani. Shkoj në dhomë me Arbenin. I shfletoj një album. Pastaj një tjetër. Arbeni habitet. Si duket, i pëlqejnë ato fotografie e tablo. Në njerën nga fotografatë jemi unë e Vera, të dy me uniformë marinarësh. Një seri fotografish të tjera ngajeta e detit. Edhe një pikturë: një anije në mes të dallgëve. Arbenin e tërheqin ngjyrat dhe shikon një copë herë me vëmendje.

— Bukulisha, babi.

— Po, mor pëllumb i babit.

Ai merr fotografinë, ku jemi unë e Vera, detarë.

— Kus ëstë ky, babi?

— Mami dhe babi.

Më vjen që t'i hap të gjitha ato koleksione, kujtime nga deti. Vera i ka mbledhur e ruajtur me kujdes. Ato na kujtojnë çaste të bukura të jetës sonë. Ja fotografia me të gjithë anëtarët e ekuipazhit. Ja komandanti, Luftari, ja kuzhinieri, Bektashi, Nikua, Sadriu, Vangjeli, ja të gjithë shokët. Ja anijet, ja deti. Parafytyroj lundrimet e gjata, dallgët e egërsuara, netët pa gjumë, alarmet, avaritë, takimet e ndarjet. Pastaj bombat reaktive, topat automatikë, bombat e thellësisë, siluret. Ndërkaq hyjnë Vera. Na përshëndet. Është e lodhur. Var pushkën.

— Nep pushkën mua, mami — thotë Arbeni dhe

qan. E do pushkën patjetër. Vera i heq fishekët dhe ja vë pushkën pérpara. Arbeni kënaqet.

Pastaj Vera merr fotografitë dhe i shikon me radhë.  
— Janë vërtet të bucura këto kujtimet e jetës në det — thotë ajo.

2

Shiu pushoi. Nga strehët e çative binin currilat e trasha të ujit të mbledhur, po edhe ato pushuan shpejt mbas shiut. Ndërkohë përroi i vogël oshëtinte rrëth e rrotull ndërtesave. Ne dualëm nga streha e ndërtesës së degës ushtarake, se shoferi i ra borisë së maqinës, me të cilën do të niseshim.

— Po ndahemi, bir, — tha babai — dhe porosia ime e fundit asht kjo: Të mos ma nxijsh fytyrën. Po qe rasti ndonjëherë për gisht, mos të të dhimbsetjeta. Se ne malësorëve s'ka q'na duhetjeta, kur të turpnohem. Jemi shqiptarë, biro.

— Edhe unë do të tregoj kudo se jam shqiptar. Mos u bëj merak; po të jetë nevoja, ashtu siç ke luftuar dikur përkrah Dedë Gjo' Lulit, do të luftoj edhe unë së bashku me komandantët e mi.

— Komandantët dueji shumë e mos u kundërshto, se po ndëgjova gja, nuk ke pse më mësyn shtëpinë. Ti po ke fat që po bahesh edhe detar.

— Po, mor plak, po deti thonë ka rreziqe të mëdha. Kam frikë se s'ka për të ditun — tha nëna.

— Hajt moj plakë, mos u ba merak, se nuk asht deti si të kanë thanë ty! Ehu, sa mjete ka ba partia tashti, o plakë, aq të mira paçim! Unë i kam pa në film anijet e flotës sonë.

— Letra na shkruej shpesh — tha nëna.

— Po, letra duam, se mërzitemi. Ti do të jesh larg. Det s'kemi këtej. E... edhe një herë po të them për punën e nuses. Ndigjo babën ti: të del mirë si të them unë. Ne do të gjemë një vajzë të mirë me të cilën të fejchesh, mandej, si të mbarosh ushtrinë, martohesh. A s'asht bukur kështu? Si thue?

— Unë të kam thënë disa herë, baba. Nuk dua të martohem ashtu. Dhe sidomos pa kryer ushtrinë. Deri tani nuk më ka pëlqyer ndonjë vajzë, prandaj nuk kam si të fejohem. A nuk të vjen keq, baba, për këto fjalë?

— Jo, mor bir, unë për të mirën tande e kam. E di që tashti kanë ndryshue kohmat dhe ju nuk duhet të martoheni si na. Ban si të duesh, mor bir. Por, edhe po të gjesh ndonjë nuse ti yetë, due ta shoh edhe unë, se shpesh ju të rinxjtë gaboheni.

Shoferi i ra borisë edhe një herë. Unë u shtrëngova duart prindërve.

— Mos hyn të lahesh në det vetëm, mor bir — më tha nana.

— Lene, moj plakë, se nuk është fëmijë — tha baba. — Thueji ma mirë: banu ushtar trim. Nga unë këtë porosi ke, mor bir; për të tjerat bëj si të duesh. Udhë e mbarë të qoftë! Të priftë shëndeti dhe fati!

— Të pastë nana! Tu dhashtë e mbara, mor bir, se gjithmonë ke qenë djalë i mbarë! Mos u mërzit!

— Mirë u pafshim.

Nëna, babai dhe të afërmit e mi diç flisnin e bënин me duar, po unë nuk i merrja vesh më nga brohoritjet e rekrutëve. Ishim ngritur më këmbë dhe bërtisnim të gjithë «Parti-Enver — jemi gati kurdoherë», «Ushtria — garancia» dhe pastaj ja morëm këngës «Shqiponjat partizane». Maqina gumëzhiu dhe ne kaluam sheshin e vogël para degës ushtarake. Shefi i degës na përshëndeste nga dritarja. Disa metra prindërit na ndoqën prapa, pastaj maqina eci më shpejt dhe ata mbetën grumbull duke përshëndetur me dorë. Në bulevardin e qytetit kish shumë njerëz që përshëndetnin nga kalonim ne dhe ne i përshëndetnim me brohoritje.

«... të mos ma nxjish fytyrën! Po qe rasti ndonjëherë për gisht, mos të të dhimbsetjeta. Se ne malësorëve s'ka ç'na duhetjeta, kur të turpnohem...»

Këto fjalë të babait më bënин të mallëngjehesha. Kurrë nuk do t'i harroj këto fjalë, mendoja, ndërsa maqina vravonte, duke lënë prapa qytetin me kalanë e

vjetër. Shokët brohorisnin me të madhe, kurse unë merrja pjesë pa vetëdije, se vëmendja ime ishte shpërndarë në pejsazhin që vraponte anash maqinës. Unë nuk kisha qenë kurrë nga ato anë, nuk i kisha parë kurrë ato vise. Për mua çdo gjë ishte e re, prandaj më tërhiqte. Përpipesha të përipija me sy të gjitha objektet që më rrëshqisnin përpara me aq shpejtësi.

— Mos rri i mërzitur! — më tha detari i vjetër që na shoqëronte.

— Përkundrazi. S'kam as kohë të mërzitem.

— Ki parasysh gjithnjë porositë që të dha babai.

— Thonë se në marinë teknika ushtarake është e ndërlikuar.

— Është fjala e fundit e teknikës.

— Atje do të më hasë sharra në gozhdë. Unë nuk kam shkollë.

Detari qeshi. Pastaj tha:

— Ashtu mendoja edhe unë në fillim. Por më doli ndryshe. Unë arrita të bëhem detar shembëllor. Përpjekje duhet shumë, natyrisht. Gjumi duhet bërë me kufi.

— Mor, po të jetë për përpjekje, unë s'lë gjë pa bërë.

— Puno kështu dhe flasim bashkë pastaj. Hapësirat e reja që shpaloseshin para meje më rrëmbejin dhe nuk më lejonin të bisedoja me detarin. Kështu vazhdova gjatë gjithë rrugës.

Maqina u ndal dhe zhurma e motorit u shua. Për të parën herë në jetën time dëgjova zhaurimën e dallgëve të detit. Megjithëse isha i trullosur ngaqë më kish zë në maqina, kisha dëshirë për të soditur sipërfaqen e hapët të detit të trazuar nga era. Muzgu po binte. M'u duk e pabesueshme që do të kryeja shërbimin ushtarak mbi kurritzet e atyre dallgëve kërcënuese. Ndërkohë pashë dhe një anije, tej në thelli.

— Ajo do të jetë shtëpia jonë — tha shoku, që kisha përbri.

— Ajo? !... — pyeta unë i habitur.

— Ajo ndoshta jo, po ndonjë tjetër si ajo. Shtëpi që lundron do të jetë me siguri.

Zhurma e maqinës, që u ndez në atë çast, na ndër-preu bisedën.

Në repart arritëm natën. Sapo zbritëm në tokë, na futën në banjë, na veshën me rroba ushtarake, pastaj hëngrëm bukë dhe na shpunë në kapanonet ashtu siç ishim, të grupuar në bazë rrëthesh. Kapanonet ishin ca dhoma të mëdha të lyera e të zbuluruara me kujdes dhe të mbushura me shtretër hekuri me sustë. Mbi shtretër kish nga një dyshek të mbushur me pambuk. Ndërkohë na ndanë nga dy batanie dhe çarçafë të larë e jastëkë, që mbanin aromën e sapunit. Sapo rregullova krevatin, unë rashë, kurse disa shokë të tjerë ndenjën duke biseduar ose duke kënduar. Unë, ndonëse rrugës kisha që-në entuziast, tani kisha rënë në mendime. Më kish push-tuar një mallëngjim i çuditshëm për shtëpinë, duke men-duar se do të rrija një kohë aq të gjatë larg saj. Unë nuk isha mësuar të qëndroja larg shtëpisë. Edhe kur nisësha të shkoja ndonjëherë mysafir, nëna më thosh:

— Mos rri shumë, biro! Nesër hajde në shtëpi!

Kurse tani s'do më shihte me muaj të tërë.

Lodhja e tepërt dhe netët pa gjumë që kisha kaluar më parë, bënë që të më zinte gjumi. Më zgjuan vetëm tingujt e borisë në mëngjez.

Ajo ditë kaloi pa ndonjë veprimtarë ushtarake. Shë-tisnim e rrinim. Të nesërmen ndryshoi puna. Sapo shkoi ora gjashtë, me gjithë të ftohit që bënte (kish kaluar gjysma e dhjetorit), ra boria e zgjimit dhe dezhurni i kapanonit erdhì tek ne dhe bërtiti:

— Çoooou! Pregatit për gjimnastikë!

Detarët e rinj u zgjuan e filluan të ngriheshin nga krevatet, po me ngadalësi.

— Shpejt, shpejt, lëvizni nga vendet!

Unë fillova të vishesha, po shoku im nuk po luan-te nga vendi. Dezhurni iu afrua te krevati dhe i hoqi bataniet.

— Po ti pse nuk ngrihesh? Nuk ka rënë për ty boria?

— Prit, mor shok, mos m'i hiq bataniet!

— Duhet të dalësh në gjimnastikë, ore, akoma nuk e ke marrë vesh? I sheh shokët apo jo?

Rri, ore, mos më prek me dorë se...

— Lëri fjalët, Niko, e ngrehu! — ja priti njeri nga fundi i kapanonit. Siç duket, e njekte.

Dezhurni u largua dhe Nikua nisi të ngrihej.

Kur dolëm jashtë të gjithë, na thanë të rreshtohenë shrim. Thëllimi i atij mëngjezi të ftohtë na depërtonte në trup. Ish një nga ato mëngjezet e acarta që të thanin.

Ndërkokë na u dha urdhëri «gatitu» dhe ne, të rresh-tuar shtremba-shtremba, e «zbatuan». Pastaj na u dha «prap ktheu!» dhe, mbasi ecëm ca ashtu, komandan-ti na urdhëroi të niseshim me vrap. Këtë prisja unë. Mjaft i çrrëgullt qe rreshti më parë, po tani u bë lëmsh i djallosur. Secili vraponte më shumë se tjetri bregut të detit. Edhe komandantin e bëmë të qeshte. Dallgët e detit ngriheshin kurrise - kurrise dhe përplaseshin bre-gut me një ritëm të ngathët. Filluam të dihasim dhe ndjemë se gjymtyrët e trupit na u ngrohën. Pastaj komandan-ti na urdhëroi të mblidheshim në një fushë dhe na rreshtoi në formacionin për gjimnastikë. Bëmë ca ushtrime, po nuk zgjatën shumë, se na theri thëllimi. Atëhere përsëri vrapim dhe me atë të vrapuar komandan-ti na solli te kapanoni. Hymë, muarëm peshqirët dhe shkuam te çesmat për të larë sytë.

— U këputëm — tha Nikua.

— Qenke dembel, po këtu do të vesh mend patjetër ja prita unë.

— Po të më tekët, unë s'pyes. Atë q'kam mundësi ta bëj, e bëj.

— Ti do t'i shmangesh edhe asaj që mundesh. Po këtu ka rregullore ushtarake.

— Nuk ma njeh kokën ti mua — tha ai.

Mbasi lamë sytë, shkuam në kapanon, rregulluam krevatet sipas modelit që na tregoi nënëficeri dezhurn, që gjithë jastëkët të ishin në një vijë të drejtë ashtu si dhe çarçafët e kthyer te koka dhe peshqirët të palosur trecepash; pastaj prapë dolëm në rresht dhe shkuam në mensë për të ngrënë mëngjezin.

Kur dualëm nga mensa, na çuan për të punuar në sheshimin e një kodre pas kapanoneve, vend që ish i

mbushur me gurë gëlqerorë, copëra tjegullash e tullash, që tregonin se dikur kish qënë qendër e banueshme. Këtu më vinte përdoresh të punoja. Kapa një kazmë të rënëdë e ja hyra një pirgu dheu e gurësh derisa u djersita. Katër-pesë tezga bartnin gurët e dheun që nxirrja unë dhe nuk ma dilnin dot. Të ishte e tërë vështirësia e shërbimit ushtarak kështu, mendoja, do ta kaloja fare lehtë. Puna e krahut éshtë zanati im. Kazmën di ta përdor mirë në çdo kohë e kudo. Dhe m'u kujtua se si punonim atë vjeshtë për hapjen e një toke të re në kooperativën tonë bujqësore malore. Atje ish tokë e vështirë: pyll i dendur dhe gurë të mëdhenj që duhesin shkulur nga rrënjet. Unë kisha arritur të bëja dy-tre norma në ditë. Iшин të rrallë kooperativistët pë punonin sa unë, prandaj më donin dhe më cilësonin si bujk të mirë. Kryetari i kooperativës më kish bërë shëmbull sa herë para anëtarëve të tjerë.

— I riu Çlirim Haka éshtë nderi i kooperativës. E, pra, shumë kooperativistë janë më të fuqishëm nga ai fizikisht, po ai ua kalon të tjerëve. Merrni shembull nga ai.

Sa mirë e kisha pasur punën atje! Po tani si do të bëja? Tani duhej të bëhesha detar, duhej të përdorja alamet teknikë luftarake dhe kushedi sa gjëra të ndërlikuara, unë, një fshatar që mezi i kisha bërë shtatë klasat! Në fshatin tim nuk kish shkollë shtatëvjeçare atëhere, ndaj unë vitet e fundit, kur u hap ajo, e vazhdovala natën. Dhe, q'është e vërteta, për shkollë nuk ma priste fort. Veç sa për të kaluar. Isha i dhënë tepër mbas punës. Të më kishin çuar në xhenjo, mendoja, do të isha në rregull. Atje do të punoja e do të kryeja detyrën tamam si ushtar i vërtetë, kurse këtu e kisha pisk. Siç tregonin detarët e vjetër, këtu ishte punë me kokë dhe jo hamallëk. Më të shumtët e shokëve, me të cilët isha mobilizuar, ishin me arësim të mesëm e bile edhe me institute e universitete me korespondencë. Dhe aty të njëjtat mësime do të na jepeshin. Më dilnin parasysh laboratorët që ishin të vendosur nëpër klasa, ku do të mësonim në, aparaturat e çuditshme që s'i kisha parë as në ëndërr dhe e mendoja punën shumë të vështirë.

Të shohim një herë, mendoja dhe vazhdoja t'i mëshoja kazmës me fuqi. Shokët donin të më ndërronin, po unë vazhdoja me këmbëngulje. Punuam sa punuam, po pastaj na doli një shkëmb i madh që duhej rrrokullisur.

— Tani na dolën telashe — tha komandanti, që na drejtonte. Shkëmbi duhet rrrokullisur, se dinamit nuk mund të përdorim, mbasi është shumë afër kapanoneve.

— Ku dreqin paska qenë ky gur kaq i madh! — thashë unë dhe e shikova një copë herë. — Do t'ja bëjmë gjëmën.

Muarëm dy-tre qysqi të gjata dhe ja hymë përtta rrrokullisur. U munduam e u munduam, po nuk e lëvizëm dot. «Ç'po turpërohem!» mendova i dëshpëruar. «Vetë i dola zot punës e tani po tërhiqem. Malësorët nuk bëjnë kështu». Iu hodha shkëmbit me tërë fuqinë. «Jepini, shokë! O burra! Edhe pak, edhe pak! Lëvizi guri. Mos e lini!»

U lëshuan një mori detarësh me qysqi e me duar dhe më në fund shkëmbi lëvizi nga vendi. U rrëkellye në krahun tjetër.

— Qenke i mirë për punë të tilla — më tha komandanti.

— Për hamall nuk ja lëshon rrugën kujt ky, jo — tha Niko Gjosha.

— Edhe ti për llafe qënke i vetmi, — i tha komandanti Nikos me të qeshur.

— I ke rënë në të, — tha ai.

Mbas dreke u mblodhëm para kapanoneve pa na thirrur njeri. U krijua një orkestër aty për aty pa ditur se nga dolën elementët: një fizarmonicist, një violinist, një me klarinetë, një mekitarrë, dhe hoqëm një valle populllore. Shumë detarë e oficerë u mblodhën aty dhe shikonin e gjzonin bashkë me ne.

— Qenke edhe për valle e jo vetëm për qysqi — më tha komadanti.

— Kam qejf të përzihem me shokët, — i thashë. — Shumë gjëratë të vështira nuk do t'u trembesha, po kjo jeta e detarit se si më duket. Kam pak shkollë e nuk di në do të mund ta kap apo jo. Kjo më shqetëson.

— Mos u bëj merak — tha ai. — Do ta kapësh, po tē them unë. Në qoftë se do tē bësh përpjekje, do ta kapësh ashtu si mund tē kapet nga detari më i mirë. Deti nuk është aq i tmerrshëm.

— E kam fjalën te teknika më tepër.

— Edhe teknika ashtu.

Atë ditë festa jonë zgjati deri në mbrëmje, kur ra boria e darkës.

### 3

Kish disa minuta që kish rënë boria e zgjimit. Detarët po vraponin në gjimnastikën e mëngjezit. Po disa ende nuk ishin zgjuar. Dezhurni i shkonte secilit te koka dhe i lëvizte bataniet duke menduar se nuk ish zgjuar.

— ...Mos ma prek batanien, tē them! — i bërtiti Nikua dezhurnit me nervozizëm.

— Çohu, ore! Dil në gjimnastikën e mëngjezit!

— Nuk dal! Ç'u bë se nuk dola një ditë në gjimnastikë?

Dezhurni me tē qeshur i kapi batanien dhe i tha:

— Çohu, ore, megjithë mend e kam tanë. E sheh se po na kalon koha me ty?

Nikua u ngrit me vërtik nga krevati me qëllim që tē zihej me dezhurnin, po s'ja arriti dot, se ndërhyra unë dhe tre-katër detarë tē tjerë.

— Ç'bën kështu, mor Niko? — i them. — Je në vete?

— Të lutem, Çlirim, largomu. Ky ma ka prurë në majë tē hundës! Çdo herë që është me shërbim ky, vjen e më kap bataniet. Të bëhet g'të bëhet. — Ai përdori dhe disa shprehje fyese kundër dezhurnit. Pastaj u ul prap në krevat.

— Ngreu, mor Niko, tē mos e marrë vesh komanda, se është turp për ne! — i thashë unë dhe ai nisi tē ngrihej.

Ndërkaj arriti oficeri i rojes i repartit.

— Ç'bën kështu, mor shoku detar?! — i foli Nikos.

— Ku je kështu ti? Kush tē lejon tē veprosh kështu?

Në ushtri të ndodhin gjëra të tillë?! Të fyesh nën oficerin e shërbimit?! Jo, mor djalë, kjo nuk lejohet.

— E po s'durohet gjithshka, de! Durimi ka kufi.

— Pse, kështu do ta zgjidhësh problemin ti?

— Kështu e zgjidh unë — tha Nikua pa lëvizur nga krevati, pa shikuar fare nga oficeri i shërbimit.

— Ore shoku detar, je apo s'je në vete?

— Të lutem shumë mos më fyej! — bërtiti Nikua.

— Ti ke fyer dezhurnin dhe tani po na fyen të gjithë ne! Hajde, ngreu të dalësh me shokët.

— Nuk dal.

— Do të dalësh se të urdhëroj!

— Nuk dal e pikë.

Njëri nga shokët e mi ndërhyri:

— Është nervoz nga natyra Nikua. Mos ja vini re, shoku oficer.

— Të keni parasysh, shoku oficer... — thashë unë, po ai ma preu:

— E kam krejt parasysh dhe e shoh c'arrogant qenka. Do ta shikojmë çështjen e tij. Ngreu e dil në gjimnastikë, se do ta kesh keq.

Nikua nuk u ngrit nga krevati. Më vonë e thirrën shefi i shtabit dhe zëvendësi për punë politike. Tani i kish rënë ca inati, dhe pranoi të shkonte. Ata e mbajtën një kohë të gjatë në zyrë dhe biseduan gjérësisht. Atje e pranoi gabimin. Shefi i shtabit i tha:

— Meqë është faji i parë, sado i rëndë që është, po ta falim. Na duket tepër shpejt të ndëshkohesh. Ti je djalë i ri me perspektivë.

Kur erdhi Nikua në kompani, na gjeti duke zhviluar stërvitje zjarri. Hyri në rresht pa bërë zë. Komandanti i togës e shikoi me vrejtje, por nuk i foli.

Bënte shumë ftohtë. Maleve binte borë, kurse aty rigonte nga pak shi dhe frynte një erë që dukej sikur të thante edhe mushkëritë, sikur edhe në palcë të kurritizit futej. Ne ishim veshur me kapota, po megjithatë ngrinim këmbësh e duarsh. Komandanti i togës e kish hequr kapotën dhe na jepte shembullin e manovrimeve me karabinë.

— Po na lagen dhe do të na prishen pastaj — tha Nikua.

Disa nga detarët qeshën.

— Mos u bëj merak se janë të vajisura. E kemi pasur parasysh edhe këtë. Ti përdore armën pa merak. Megjithëse ti s'ke hallin e armëve — ja priti komandanti i togës.

Thëllimi sa vente e shtohej, bëhej më i padurueshëm. Ne bënim lëvizje me armë në pozicione të ndryshme dhe ndonjëherë binim barkas. Më parë binte komandanti i togës, pastaj ne. Nikua mbështete njerin bërryl në tokë dhe e zgjidhte mirë vendin për bërrylin tjetër, vend të pastër e me pak lagëشتirë. Era shtohej gjithnjë dhe bëhej gjithnjë më e ftohtë. Deti ish bërë tym nga mjegulla. Dëgjohej një zhaurimë rrënqethëse. Ditët e para më bënte përshtypje përplasja e dallgëve, po pastaj u mësova dhe s'më dukej gjë.

Orën e fundit kishim stërvitje rreshtore, elementet e para të kësaj stërvitjeje: kthimet në vend, ç'quhet rresht, ç'quhet rreshtim, ç'quhet vijë e zhdërvjelltë, kolonë e të tjera sipas programit.

Kur hymë në rresht, pashë se Nikua po pinte duhan. I bëra ca shenja që ta hidhte cigaren, por ai me të njejtat shenja më thosh se s'po bëhej kiameti.

Komandanti i togës i tha:

— Shuaje cigaren tani. E sheh se kemi filluar stërvitjen.

— Nuk e kam mbaruar akoma. Tani po e fik — tha Nikua.

— Shoku detar, fike cigaren! E shoh që e pike shumë, po ç'të bëj unë. Orar stërvitjeje. Qëndro mirë në rresht, të lutem! Edhe këtë orë, pastaj do të pish duhan sa të duash.

Menduan se Nikua do të vazhdonte të kundërshtonte, po heshti; fiku cigaren dhe mori qëndrimin gatit. Komandanti vazhdoi:

— Ne i mendojmë hallet tuaja. Dhe të jeni të sigurt se, po që gjë që bëhet, ju jap lejë vetë.

— Nuk u bë nami se hoqa tri herë një cigare, pasi ra boria — tha Nikua gjithë inat.

— Për disiplinën u bë nami e kiameti. Ne s'mund të bëjmë përjashtime. Ti theve disiplinën dy herë: një herë se kalove orarin dhe e dyta se fole pa lejë. Po të mësohem i thyejmë këto rregulla në kohë paqeje, do t'i thyejmë edhe në kohë lufte. E shoh që ne të dukemi pedantë, por arësyeto një gikë më shumë. Ke edhe arësim... Nejse fillojmö. Dalëngadalë do t'i mësoni këto gjëra.

Nikua e shikoi oficerin për një kohë pa ja ndarë sytë. Pritëm se do të fliste, po nuk bëzajti. Nga mimika e fytyrës dukej se diç bluante në kokë.

Dita e stërvitjes u mbyll.

Mbasdite u mblozhëm në sallën kulturalo-politike dhe shefi i shtabit na njoftoi se do të vazhdonim kursin gjashtëmuajor. Unë isha caktuar elektroshtruman.

— Ore shoku oficer, po kjo fjalë ç'djall është, xhanëm? — tha Nikua. — Pse s'më keni futur mua në këtë zanat? Ky si duket nuk të lë pa bukë. Oficeri qeshi, siç qeshën edhe të tjerët.

— Rri, ore Niko, ti dashke të dish gjithshka.

— Mirë që s'kam vdekur deri tani, se do të kisha shkuar pa ditur për elektroshtrumanët.

Nga bisedat që u bënë aty e morën vesh q'ish ky lloj specialiteti.

Mbasi mbaruam me shefin e shtabit, erdhë përgjegjësi i klubit të kulturës. Ai tha se do të krijonim estradën e repartit, si çdo vit tjetër.

— Ne nuk ju njobhim akoma, — tha ai — prandaj të na ndihmoni ju; të na tregoni kush këndon, kush i bie ndonjë vëgle, kush reciton, kërcen e interpreton role. Pastaj do t'ju shohim.

— As mua s'më njeh, shoku shef? — tha Nikua.

— E kush nuk e njeh kitarën tënde, thuaj! — tha shefi i shtabit.

Shumë detarë dhanë emrat për aktivitete të ndryshme. Mua më rrihte zemra. Kisha dëshirë të regjistrohesha edhe unë, po kisha frikë mos më qeshnin. Kisha mundësi të recitoja. Në grupin artistik të kooperativës kisha recituar, kisha qenë aktor. Më thoshin që kisha diksion

të mirë. Si të veproja tan? Isha zënë ngushtë. Po sikur të talleshin me mua? Sikur të qeshnin të gjithë, kur unë të dilja para tyre? Do të mbetesha i turpëruar. Apo nuk e kisha zakon të skuqesha në fytyrë! Megjithatë e dhashë emrin.

Dolëm para zhurisë. Recitova një vjershë. Nga duartrokitjet që shpërthyen m'u mbush mendja se ma pëlqyen. Si mbarova atë, u nisa të shkoja në vend.

— Prit! — tha përgjegjësi i klubit. — A dini ndonjë vjershë tjetër nga autorët tanë të njohur?

U mendova një copë herë, po s'po më kujtohej gjë. Se si më ra ndër mend që dija pak nga «Bagëti e bujqësi» dhe «Shqipnisë së robnueme». Ja thashë përgjegjësit të klubit.

— Mirë fort! Na recito aq sa të dish — më tha.

Kur mbarova, një oficer tjetër i tha atij:

— Ka diksion të mirë. Po të punohet me këtë... Ka mundësi të bëhet jo vetëm recitures, po edhe aktor i mirë.

Edhe Nikua doli me kitarë.

Qysh të nesërmen filluan provat rregullisht, se shfaqjen e parë duhej ta jepnim pak ditë më vonë, me rastin e ditëlindjes së një shoku të dalluar. Unë e kisha kapur me qejf dhe po përparoja në mënyrë të çuditshme. Kështu më thoshin edhe shokët, kurse Nikua e kish me të tekur. Një ditë paraqitej mirë dhe me humorin e tij na nxiste të gjithëve, një ditë i binte kitarës pa qejf ose na pengonte edhe provat. Njéherë i foli edhe sekretari i komitetit të rinisë.

— Po pse, mor Niko, kështu, pse? — i thosha unë.

— As unë nuk di pse, po kështu vjen ajo ora e keqe — bënte hoka pastaj.

#### 4

Thyerja e disiplinës ushtarake nga ana e Niko Gjoshit po ndodhë shpesh. Nisi të binte në sy në të téré repartin për këtë punë. Një ditë e gjeti komandanti i kompanisë të shtrirë në krevat, kur shokët po bënин gjimnastikën e mëngjezit.

- Po ti pse s'ke dalë në gjimnastikë? — e pyeti.  
— Jam sëmurë — u përgjegj ai me një «zë të këputur» pa lëvizur fare nga vendi.  
— Ke pushim mjeku?  
— Ku ta marr pushimin? jam sëmurur gjatë natës.  
— E ke njoftuar oficerin e rojes së kompanisë?  
— Jo.  
— Nuk erdhi kush të të zgjonte?  
— Po, erdhi posta e kapanonit dhe... nën oficeri rojës. Komandanti thirri nën oficerin e rojes, dhe i foli:  
— Pse nuk e shpure në vizitë këtë detarin?  
— Ku di unë ç'të bëj me të, shoku komendant. Edhe një ditë e kam çuar dhe e ka nxjerrë shëndoshë.  
— Dërgoje edhe një herë!  
— S'ka orar vizitash tani, shoku komendant!  
— Mor po të çohet te ndihmësmjeku shpejt! Ç'është orari! Detari është keq. E sheh sa me zor flet? — tha komandanti, duke e ditur se Nikua shtirej; e dinte se ai ishte fare mirë, bile më shëndoshë se në fillim. — Të jap unë një letër për ndihmësmjekun.
- Nën oficeri i rojës i priu përpara Nikos dhe e shpurratje. Ndihmësmjeku i bëri një vizitë të kujdeshme, duke dyshuar mos i kish shpëtar gjë tjetër herë.
- Po ku të dhëmb, mor vëlla? — e pyeti.  
— Më është këputur tërë trupi.  
Ndihmësmjeku e kontrolloi sa e kontrolloi, por i doli në rregull prapë.  
— Dreq o punë! Do të dërgoj te mjeku në bazë sa të të heq merakun që të mos kërkosh më vizita kështu tha ai i vrejtur.  
— Pse, do të thuash se unë shtirem?  
Ndihmësmjeku e shikoi me ngulm si të donte të lexonte diçka në tiparet e fytyrës së tij. Ai kish pasur të bënte edhe të tjera herë me të tillë tipa.  
— Shiko, mor djalë i mirë. Nuk e ke drejt kështu. Ke për të bërë këtu qindra herë gjimnastikë mëngjezi edhe kështu si e ke zënë ti nuk është e ndershme. Kur ke ndonjë farë pengese, ua thuaj komendantëve. Njerëz

janë e t'i qajnë hallet. Po jo kështu. Mua më vjen keq për ty — i tha oficeri.

— Shoku oficer, mos m'i thoni mua këto fjalë! Thuhajani atij me të cilin jeni mësuar — tha Nikua.

— Çudi! — tha oficeri pa e humbur durimin — Unë e gjuaj me grurë e ky me gur. Më vjen keq se je ushtar i ri, por do të të raportoj te komandanti i repara-

tit.

— Aman ore, se më trembe! — tha Nikua dhe doli me rrëmbim jashtë e shkoi e u shtri në krevat. — Jam sëmurë! — i tha nën oficerit të rojës — E di unë që më dhemb trupi.

I kishin hipur dreqërit dhe donte t'i dilte e veta, sadoqë e kish shtrembër.

Nën oficeri i rojes i raportoi komandantit të kompanisë ato që kishin ndodhur me Nikon. Oficeri i erdhë prapë te krevati.

— Ç'është kjo punë, more detar Gjoshi?

— Jam sëmurë, shoku komandant. Unë e di që më dhemb trupi, s'bëj kot.

— Të dërgohet në bazë te mjeku — urdhëroi komandanti i kompanisë.

— Duhet dorë nga ndihmësmjeku — tha nën oficeri i rojës.

— S'ka gjë. E marr unë në telefon.


— Mirë, mor shoku oficer, po e njëjta gjë do të ndodhë.

— Ik, or ik, po ku e di ti! Shko atje, zbato urdhërin! Ne do t'ja kryejmë shërbimet detarit tonë dhe, kur t'i dalim hakut, do i kërkojmë llogari. Mirë, mjeku e ka vizituar; po ndoshta ky ndjen dhëmbje. Kështu më ka ndodhur edhe mua njëherë. Më dhimbte këmbla, kurse mjeku më thosh s'ke gjë.

«Mirë, more vëlla, ti thua se qen kam shëndoshë, po ç'ti bëj këmbës që më dhëmb?» — i kthehesha unë.

Kështu vazhdoi kjo punë derisa bëra radiografinë e më doli vërtet e sëmurë.

E dërguan te mjeku i bazës. Para se të fillonte vizitën, mjeku e shikoi më vëmendje dhe diç foli me



shokun e tij rusisht; pastaj e vizitoi një copë herë të gjatë.

— Ku ndjen dhëmbje më shumë? — e pyeti mjeku.

— Kur vrapoj apo lodhem në ndonjë mënyrë tjetër kam dhëmbje të tmerrshme në ije, kurse nëpër të gjithë trupin kam dhimbje të vazhdueshme, një të këputur që s'më le të mbahem më këmbë.

Mjeku e vizitoi prapë. Më në fund tha:

— Çudi! Unë s'diktoj asgjë — dhe bisedoi prapë me shokun rusisht. — A ke bërë lundrime ndonjëherë?

— Kam bërë — tha Nikua.

— Të zë deti?

— Të zë, the? Më merr shpirtin, ore! Detin nuk e duroj. Po të lundroj dy dit, vdes fare.

Mjekët qeshën.

— Ne nuk të diktojmë dot ndonjë sëmundje, por do të të dërgojmë në klinikën e qytetit. Po s'doli gjë edhe atje, atëhere të dërgojmë në komisionin mediko-legal. Po s'doli gjë edhe atje, s'kemi q'bëjmë. Kjo sëmundje për t'u larguar nga deti dhe për t'u shmangur nga stërvitja, është sëmundje e keqe fort.

— Ju po më fyeni rëndë me këtë. Ju do të thoni që unë shtirem.

— Aspak mos u fyeni. Mendimi ynë nuk është absolut. Prandaj po të dërgojmë te mjekët kompetentë. Që ju keni sëmundjen e shmangjes nga stërvitja është vetëm mendimi ynë.

— Ju s'keni të drejtë të futni njerëzit në të tilla kallëpe. Një njeri që shmanget nga stërvitja është kundërrevolucionar, prandaj ju bëni gabim që më futni mua atje.

— Mirë, mirë, nesër në ora shtatë të jesh këtu se do të shkojë autoambulanca në qytet. E qartë? — i tha pastaj mjeku nën oficerit.

— Si urdhëron, shoku doktor.

— Raport për pushim nuk ka. Mund të marrë pjesë në stërvitje.

Me t'u kthyer nga vizita, Nikuá u shtri në krevat.

Disa shokë i shkuan pranë. Ishim të shqetësuar për sjelljen e tij. Të vërtetën e dinim.

— Pse, mor Niko, e çove veten deri këtu? — i thashë unë.

— Çfarë bëra?

— Ne e dimë shumë mirë që ti s'je sëmurë.

— Të gjithë doni të më sulmoni. Keni frikë se kanë fuqi oficerët, a?

Ne i folëm mjaft, po ai nuk lëvizi nga krevati. Kujtonte jetën e mëparshme, kujtonte shokët...

...Mëbasi kish mbaruar shkollën e mesme, Nikua as kish bërë përpjekje të vazhdonte më tej, as kish hyrë në punë për ca kohë. Gjendjen ekonomike e kish të mirë në shtëpi dhe familja e përkëdhelte. Këto gjëra i kujtonte Nikua shpesh, këto m'i kish thënë edhe mua. Po për shokët e tij pak më kish folur, pak e turbull. Ai kishte tre shokë të ngushtë. Të tre pinin duhan e raki, visheshin me pantallona të ngushta dhe gjëndeshin kudo nëpër kënde rrugësh të qytetit, shfaqeshin papritmas nëpër lulishte e rrugë të mbështetur për muresh, duke u hedhur fjalë vajzave. Dalngadalë Nikua u bë shok i ngushtë i tyre. Nisi të shoqërohej edhe mbrëmjeve me ta. Familja u pendua shumë për përkëdhelitë që i kish bërë. Tani ai kish dalë dore. Mobilizimi në radhët e ushtrisë qe një sihariq i madh. «Atje i vinë mëndtë me siguri», mendonin prindërit. Por Nikos kjo i erdhi e hidhur. Nuk donte të ndahej prej shokëve të tij të ngushtë. Prandaj tani i kujtonte me nostal gjji...

Të nesërmen ai shkoi në klinikën e qytetit. Atje i dhanë tri ditë pushim dhe disa ilaqe. I thanë të shkonte edhe një herë mbas pak ditësh. Kjo e solli tërë punën së prapthi. Doktori i ngjalli iluzione dhe i përkëdheli tekat.

«Po e fitoj betejën», mendonte Nikua. «Kështu po shtyhem: një herë me një vizitë, një herë me një pushim, një herë tjetër... Kështu do ta fitoj betejën. Pse të rri unë katër vjet në marinë duke qenë se mund të bëj vetëm dy vjet e të shkoj te plaka?»

Një tjetër ditë Nikua u zu me komandantin e repar-

tit. Vetë komandanti e dëgjoi kur po fyente një shok dhe e thirri.

— Hajde këtu ti, shoku detar!

Nikua, dalëngadalë, pa e prishur gjakun, iu paraqit.

— Shoku komandant, detar Gjoshi, sipas urdhërit tuaj, ju paraqitet!

— Qetësohu, detar Gjoshi. Në cilën kompani je?

— Në kompaninë e dytë.

— Shko më thirr komandantin e kompanisë.

— Për punën time?

— Shko zbato urdhërin.

— Po pate gjë përmua, bisedojmë bashkë. Komandanti i kompanisë s'ka faj për ato që bëj unë.

Ky qëndrim mospërfillës i Nikos e nevrikosi komandantin. Mbas pak ra borja.

U mblohdh gjithë reparti, sipas urdhërit të komandanit. Nikua doli para repartit të rreshtuar. Komandanti foli për veprimin e Nikos. Ky ishte një paralajmërim dhe kur preokupohej komandanti i repartit me një detar, ishte puna keq. Kjo kishte ndodhur rrallëherë. Komandanti na kritikoi edhe ne, shokët e kompanisë së Nikos.

— E gjithë kompania është përgjegjëse për indisiplinimet e detar Gjoshit — tha ai; — të gjithë ju keni qëndruar indiferentë. Ne s'durojmë të na hipë kush në qafë. Durojmë shumë, por durimi ynë ka kufi.

Kësaj here Nikua do ta kish pësuar keq, se komandantit i qe mbushur mendja të merrte masa ndëshkimore, por ndërhyri zëvendësi për punë politike.

—5—

Dita e betimit ushtarak.

Ne ishim rreshtuar të tërë para tribunës dhe prisnim. Një xhips u ndal te postobloku i repartit. Zbritën që andej komandanti i flotës, një oficer madhor i Ministrisë, një instruktor i Komitetit Qëndror dhe dy-tre oficerë të tjera. Komandanti doli para repartit të rreshtuar dhe dha komandën:

— Reparti gatitu! Majtas ndero! Shoku komandant i flotës luftarako-detare të Republikës Popullore të Shqipërisë, reparti ndodhet i rreshtuar për të bërë betimin ushtarak. Komandanti i repartit, Kapexhiu.

— Qetësohu!

Të ardhurit hipën në tribunë. Ne filluam betimin. Unë shikoja komandantin e flotës dhe shokët e tjerë në tribunë, shikoja repartin e rreshtuar, anijet e ankoruara, dy reaktivë që fluturonin lart në qiell mbi detin. «Tani u bëra ushtar» mendova. Kujtova një natë alarmi para disa ditësh. Ra boria në orën dy të natës dhe ne dëgjuam një «çohul» të fuqishëm dhe zbritëm nga krevatet. U rreshtuam dikush së prapthi dikush së mbari. Dikusn kish veshur bluzën e tjetrit, dikush pantallonat e tjetrit, dikush kish dalë fare zhveshur, dikush zbathur, por asnieri s'thoshte se ish keq. Sigurisht që të zhveshurit i kthyen komandantët. Për ata u desh të ndizej drita. Pastaj nëpër terr hymë në armaturë, muarëm armët dhe zumë prapë rreshtat. U dha komanda për marshim. «Armiku» nga veriu. Nata ishte sterrë. Ne ja dhamë vravit andej nga na prinin komandantët. Papritmas unë rashë në një kanal. U zhyta në ujë e në baltë deri në bel. Por kurrujt s'i thashë. Nuk doja të dinte kush se kisha rënë në kanal. Në alarmin e parë të biesh në kanal, është dobësi. Vërtet më rrëshqiti këmba, por s'duhej të më rrëshqiste. Vrapova së bashku me shokët ashtu duke mërdhitur. Kur iu ngjitëm malit, nuk ndjeva më të ftohtë. Në gjysmë të malit u dha «pushim alarmi». Ky ishte alarmi i parë. Ai ishte një alarm mësimor, prandaj çdo e metë na falaj. Atëherë akoma nuk ishim betuar, kurse tani po bëtoheshim zyrtarisht. Tani kushdo mund të thoshte «Ti ke bërë betimin para popullit dhe atdheut, prandaj kikujdes».

Pas ceremonisë së betimit dhamë edhe shfaqjen e estradës sonë.

Më pastaj Nikon e kërkoi zëvendësshefi i degës politike të flotës. Në zyrë me ne ishte edhe shefi i shtabit të repartit.

— Kam dëgjuar disa herë se ju keni thyer disip-

linën — tha zëvendësshefi i degës. — Po, të them të drejtën, sot që ju pashë në shfaqje s'di si m'u dukën ato thënje. Ju jepni shpresa pér t'u bërë një kuadër i mirë dhe nuk e kuptoj si mund të bëheni edhe objekt diskutimi pér thyerje discipline.

— Hë, pra s'di as unë se si më vjen ashtu...

— Jo, s'vjen gjë, po s'e solle vetë. Unë s'e kuptoj se si ti, që duke shfash kaq i zgjuar, të mos jesh në gjëndje të përbash veten. Më fal që po hyj ndoshta pak si te-pér në botën tënde intime, po unë kisha qejf të dija diçka pér ty, se unë jam i bindur se ti ke argumentet e tua pér ato që bën, domethënë e justifikon veprimin tënd. Se ti nuk udhëhiqesh nga instiktet. A s'mund të më thuash mua çfarë halli ke?

— Asgjë.

— Leri ato. S'bën njeriu kështu kot së koti. Je i shqetësuar tej masës dhe ndizesh e nuk përbahesh dot. Ne do të t'i zgjidhim telashet... Pa na thuaj, si e ke banë?

— Sipas letrave që marr, mirë është.

— E përvëlon malli shumë pér familjen — tha shefi i shtabit... — Dhe... me sa duket, ka ndonjë të zemrës... — Shefi qeshi. — Ka ndonjë pa të cilën s'mund ta kalojë. Si thua, Niko?

— Unë, të zemrës? Aman, bre shoku shef! Kush do të bëhet pér zemrën time? Jo, nuk i kam tërhequr kurë vajzat — tha me të qeshur.

— Mua nuk më besohet. Diku është ajo që i ke vënë syrin ti.

— Jo, jo, pér nder. Po të ishte gjë, do t'jua tregoja. Fundja nuk është ndonjë turp t'i tregosh komandantit.

— Jo, unë s'po të them që të më tregosh. Kjo është dishka intime, po unë jam i shqetësuar pér faktin se ti shpesh po na prish punë. Nganjëherë je plot gaz, shakaxhi i rrallë, i qeshur sa s'bëhet, kurse nganjëherë, fap, ndryshon a thua se u këmbeve me një tjetër.

— Ka ndonjë rast, po edhe unë s'di si të them... Do të mësohem.

— E di që do të mësohesh, po fajet nganjëherë

janë të rënda. Tani në qoftë se ke ndonjë hall, më thuaj mua. Po qe se ke nevojë të shkosh në shtëpi, na e thuhaj. Ne e shqyrtojmë çështjen dhe, po qe e arësyeshme, të japim lejë. Ne jemi prindërit tuaj.

— Ju jam shumë mirënlohës, shoku shef. Pritja juaj më bën shumë përshtypje.

— Nga goja je bilbil ti. Dhe mua më pëlqen të jesh gjithnjë kështu.

Nikua u zotua para shefit që të mos e thyente më disiplinën.

—6—

Pastaj na filluan provimet për periudhën e parë të stërvitjes.

Më mirë dola në stërvitje zjarri. Në lëndën e mësimit politik u paraqita më dobët. E studioja këtë lëndë, po nuk kisha atë sukses. që kërkoja.

— Nuk më kënaq — më thosh zëvëndësi për punë politike.

Kjo më bënte të pëlcisja. Nikua më thoshte:

— Po mirë, ore Çlirim, çka mundesh, mundesh, çka s'mundesh s'ke ç'i bën. Kështu e ka kjo punë. Pse mërit zitesh?

— Ama edhe ti, Niko, nuk ke sedër fare. Atëhere pse na ushqen populli ne këtu? Që të majemi? Kemi detyrrë ndaj popullit, ore! Je në vete ti apo s'je?

— Kur nxehesh kështu, bëhesh djalë i mirë — më thosh ai.

Hajde merru vesh me Nikon tonë!

Po mua për mësimet politike nuk më zinte as gjumi. Për temat e mësimeve mblidhja material plotësues: broshura e revista nga ishin e nga nuk ishin. Dhe u vura për fill me këtë lëndë, sidomos kur filluam specialitetin, se atëhere kishim edhe kohë më shumë për studim; orët e stërvitjes rreshtore e të preqatitjes së zjarrit ishin pakësuar, vetëm fiskultura vazhdonte si më parë.

Por tani filluan hallet e mëdha për mua, ato që i kisha parashikuar qysh në fillim. Unë duhej të mësoja elektroteknikë. Për gjashtë muaj duhet të asimiloja gati

tërë programin e teknikumeve. U futëm në morinë e ligjeve të Ohmit, të Faradajt, të Kulombit, u futëm në labirintin e skicave dhe formulave pa fund. Më nxirrte koka tym.

— E, si dukesh? — ma bënte Nikua — Jepi, mos na korit!

— Pse, si thua ti, s'do t'ja dal? Të paktën në laborator jam i fortë.

— Pa teorinë nuk ke gjë.

Nikua bënte shaka me mua, se ai nuk e kish problem elektroteknikën. Me pak ai e përvetësonte. Ai kishte baza, kurse unë nuk rrija pa mësuar, po mësoja përmendësh, nuk i kapja dot logjikisht skemat, formulat dhe ligjet e elektroteknikës.

— Do të plakesh para kohe — ma bënte Nikua me të qeshur kur më gjente duke studjuar.

Ndonjëherë edhe më pengonte studimin, por nuk i hidhërohesha. Ai dëshëronte të bënte shaka me mua. Nganjëherë më tregonte gjatë për jetën e tij.

— Rrogën time e harxhoja vetë — thosh. — Asnjë lek nuk më kërkonte shtëpia. Bile më jepnin të tjera. U mësova keq me raki e me duhan sidomos. Këto nuk më linin asnje grosh në xhep. Po kam ca vëllezër që nuk i ka kush. Ata, dhe t'ua digjja shtëpinë, nuk më bënин zë. Ti e ke rehat. Më mirë jeton këtu se në fshat. Nuk i njeh pijetoret dhe bilardot! Dhe oficeri vjen e më çon me orë në dorë apo vonoj unë për të dalë në fiskulturë!

— Po ne kalitemi për mbrojtje këtu.

— E di, mor vëlla, mos ma trego mua ate ti, po ne, po të jetë nevoja për luftë, luftojmë. Fundi i fundit q'rëndësi ka për luftën pse nuk dalkam unë në gjimnastikën e mëngjezit apo në stërvitje rreshtore?

— Aha, tani nuk po na thua gjë fare. Ti që ke bërë edhe shkollë duhet ta dish rëndësinë e fiskulturës më mirë nga unë.

Kështu grindesha me Nikon vazhdimisht. Ai ishte ekstremist. Shumë nga urdhërat e rregulloret i quante si rregulla skrupuloze dhe komandantët pedantë. Dhe unë e kisha vështirë ta sqaroja. Mua më donte, por nga-

njëherë më përgmonte. «E ku di ti?» më thoshte. Emri i qe bërë i njohur në të gjithë repartin, ndonëse njihej edhe si kitarist i mirë.

— Mua më ka marrë lapsi për keq — më thosh.

— Sido që të veproj, do të më thonë i padisiplinuar.

— O, po bëj kthesë ti, pa të shohësh pastaj sa shpejt do t'u hiqet ai mëndim njerëzve. Nuk është ashtu si mendon ti. Nuk të ka kush inat.

— Ore, ç'më je bërë ferrë ti, Çlirim! S'më lë rehat kurrikund. Lermë, more, ç'të duhet! Kur pranoj unë të pësoj një të keqe, ç'të duhet ty të dalësh mbi mua?

— Nuk të lë. Ti e di se nuk të lë.

— Do të zihemi ndonjë ditë dhe bile do të rrithemi keq.

— Kurrë s'do të zihemi.

Ai qeshte dhe më binte shpatullave.

— Dua një gjë nga ti — i them një ditë.

— Do një gjë nga unë? Po mirë, po ta jap, në qoftë se e kam.

— Të më betohesh që do të ma japësh.

— Përse të betohem, kur unë mund të ta jap pa u betuar fare!

— Nuk ma jep, por betohu.

— Betohem, se do të ta jap edhe shtëpinë në qoftë se ma lyp.

— Mirë. Pra ti do të më ndihmosh në elekroteknikë.

— Bah, ç'ma ke hedhur! Mos më shtjerë në këtë pyll! Domethënë unë të detyrohem të studjoj për të ndihmuar ty! Të lutem mos ma kërko. Një tjetër ç'të duash. Jo këtë!

— Këtë dua unë. Mos harro se je betuar.

— Hajde djall, pra! Dëgjo mësimin tanë. Elektromotori bëhet nga indotoja, statori, karbonçinat...

— Jo, jo këto gjëra i di dhe unë, se i kam parë në praktikë. Po më folë më mirë për induksionin elektromagnetik.

— Mësuesit mos i ndërhyj. Ku është parë të udhëzojë nxënësi mësuesin dhe pastaj të dëgjojë mësim prej tij.

— Posi, është parë e dëgjuar. Do ta provosh edhe ti tanë e tutje.

Kështu unë nuk i ndahesha. E bëja të më shpjegonte dhe nisi të merrej shumë me mua.

Një ditë ndodhi një zënje e fortë në mes të tij dhe të një shoku tjetër që i binte fizarmonikës. Nikua kish marrë me kitarë një pjesë ritmike të shfrenuar. Unë s'ku-ptoja ç'ish ajo pjesë. Të tilla pjesë ai merrete shpesh. Tek po i binte kitarës, Nikos iu afrua fizarmoniqisti dhe ja hoqi nga duart. Nikua shtangu. Tjetri e shikoi me ner-vozizém.

— Ç'ke kështu? — pyeti Nikua si i frikësuar.

— Ore Niko! Ore tutkun! Na e prishe daullen e veshit. Ku jemi këtu?

— Ku di ti ç'është muzika, o Stefan? Ti je djerr fare në muzikë! Unë e njoh edhe atë muzikë që thua ti, o derëzi!

— Po këto s'janë këngë. Janë marrëzira, britma të çjerra si të kafshëve të egra.

— Këto janë sot të modës. Gjithë bota çmëndet pas tyre, kurse ti dashke të dalësh më i mençur nga këta. Po e di që s'e bën nga mençuria, por nga injoranca. Kam në shtëpi një shirit manjetofoni me këngë të tilla — tha Nikua si me mburrje. — Do t'i sjell një ditë.

— E, ore, po kapitalistëve u interesojnë ato uluritje. E lexove gazetën e djeshtme? Aty tregohej si mbaroi një mbrëmje vallëzimi në Paris. Ishin pikërisht ata që çmenden pas atyre këngëve, që çirreshin, thyenin xhamet dhe dilnin rrugëve duke u rënë në qafë vajzave. Me këto uluritje shthuret rinia, u hiqet vëmendja nga problemet politike e shoqërore. Këtë duan kapitalistët.

— Por sidoqoftë...

— Ç'farë sidoqoftë!

— Si të them...

— Ç'të thuash, ore, ç'të thuash! Ka qenë një periudhë që edhe unë mendoja afërsisht si ti. Por u binda se kjo lloj muzike s'është muzikë. S'të ngjall asnjë ndjenjë estetike, veç të çakërdis fare.

— Të paktën mua s'më mbushet mendja plotësisht.

— Do të të mbushet. Të jesh i sigurt.

Ata vazhduan të grinden, por Nikua e la kitarën.

Një ditë, sipas planit që kish organizata e rinisë, shkuam në një kooperativë bujqësore. Ishte e para herë që unë isha mysafir në këto anë. Atje dhamë një shfaqje të estradës sonë. Siç thoshin, s'kishin mbetur as pleq as fëmijë pa ardhur. Dita ishte e kthjellët. Era e detit vinte deri atje. Ditë vere dhe e freskët.

Kooperativa bujqësore kish një sallë të madhe pranë shtëpisë së kulturës, po ne shfaqjen e dhamë jashtë nën hijet e pemëve që ishin para kryesisë së kooperativës.

Pas shfaqjes na shtruan drekën në klub. Në tryezë me ne u ulën një pjesë e mirë kooperativistësh. Ngritëm dollitë e para. Sekretari i partisë së fshatit foli pak përlidhjet miqësore që kish pasur ai fshat gjithnjë me repartin e afërt të marinës.

Pastaj filloj vallëzimi. Mua më zuri halli, se nuk dija të vallëzoja mirë. Kisha mësuar ca. me shokët në repart, po akoma nuk e njihja muzikën. Me vajza nuk kisha kërcyer ndonjëherë. Me ne kish shumë vajza kooperativiste dhe mua s'do të më linin pa kërcyer.

Orkestra filloj. U ngriten kavalierët. Unë vëreja me kujdes si i hidhnin hapat ata në vallëzim. Sa e patën fuqinë kavalierët nuk u ngrita, i shpëtova telashit. Por s'vonoj që fuqinë e morën damat. U ngriten një mori vajzash. Njëra prej tyre erdhi edhe tek unë. Kishte një trup mesatar; qafën e kish ca të shkurtër dhe koka i dilte vetëm pak mbi supe; kish fytyrë të madhe me ca si pika të kuqe të imta; hundën e kish hark me majë ca të ngritur. Unë u habita se si ajo qeshi kur erdhi para meje e më bëri shenjë të ngrihesha. Ne filluam të kërcenim dhe ajo më shikonte drejt dhe buzëqeshte.

— Më duket se nuk po më njeh — tha.

Unë u mendova ca. Atëhere m'u duk sikur diç m'u kujtua turbull; por asnjë përcaktim nuk isha në gjëndje të jepja. Cila ishte ajo vajzë?

— A të kujtohet kur shkonim malit me dhi dhe luanim unazë me myshk?

Unë gjithnjë i shtangur.

— A ke njojur ndonjëherë ndonjë vajzë me emrin  
Vera Pëllumbi?

— Ti je Vera Pëllumbi?!

— Unë jam.

Deshal të përqafoheshim si është zakoni, por një gjest i tillë nuk do të qe i hijshëm.

— Si do të të njihja unë ty, kur ke ndryshuar kaq shumë? Atëhere ke qënë fare e vogël!

— Jo shumë e vogël. Ti harroke shumë.

Vera kish ndenjur në fshatin tim. Ajo vinte te motra e saj që ish e martuar me një oficer. Ne e kishim shtëpinë afër repartit dhe motrën e Verës e kishim fqinjë. Me atë familje qemë miqësuar shumë. Vera vinte nganjëherë te motra dhe shoqërohej me motrën time si dhe me mua. Por shumë vjet ishin bërë që nuk ishim takuar. Oficeri që kish motrën e Verës ish transferuar prej kohësh dhe ne sikur ishim harruar.

— Sa mirë më njohe ti mua, Vera!

— Me të pyetur gjëndet Stambolli.

Ne kujtuam shkurtimisht ca momente të së kaluarës.

— A të kujtohet si thosh nëna ime për ne? — e pyeta.

— Të gjitha më kujtohen.

Sa herë që vinte Vera me të motrën në shtëpinë tonë, nëna thosh:

— Këtë motër të ma japësh për Çlirimin.

— Me gjithë qejf thosh motra e Verës me të qeshur. Qysh tani merre e rriti të dy bashkë, pastaj një ditë më bën të njojur për dasmën.

Kur flitej kështu për ne, Vera qeshte, kurse unë tur-përohesha e skuqesha.

— Hajt, he dreq! — u thosha atyre.

Ne kishim shumë kujtime, por bisedën s'po e hapnim dot si duhej.

— Çfarë pune bën në kooperativë, Vera?

— Punë të ndryshme. Sipas nevojave që ka bujqësia.

— Punë krahu?

— Po, po pse?

— Thashë mos je kund në administratë.

Ajo buzëqeshi dhe tha:

— Ti mund tē mē shohësh nga duart.

Vetëm atëhere vura re se i kish duart me kallo.

— Duart e tua... — thashë, — po s'vazhdova mē tej.

— Çfarë deshe tē thuash?

— Ja, këto duar s'mund t'i prishë asgjë, pér shëmbëll.

Orkestra pushoi, Radhët e tjera kërcyen shumë herë bashkë dhe biseduan pér shumë gjëra. Desha disa herë ta pyesja mos ish fejuar, po s'e bëra dot atë pyetje.

Në mbrëmje u kthyem në repart. Si gjithnjë, më parë u bë apeli. Ndërsa bëhej apeli, mendja më fluturonte. Kujtoja bisedën që kisha bërë me Verën. «Me siguri do tē jem bërë qesharak para saj» mendoja. «Ajo më dha tē njohur dhe unë atë prita. Si i thashë, si i thashë? «Ja këto duar s'mund t'i prishë asgjë, pér shëmbëll» Ajo do tē ketë menduar: «Ç'qenka një budalla e gjysmë ky i njohuri im! Po atë «pér shembëll» pérse e shtova? Duhej edhe ajo. Fundja në djall tē vejë Vera e duart e saj. Kështu di unë.» Këto fjalë, siç duket, i thashë me zë tē lartë sepse një detar që kisha përbri në rresht më tha: — Në djall tē vesh edhe ti, Clirim!»

-8-

Të nesërmen kishim inspektim. Erdhi vetëm inxhinieri i flotës. Dy orët e para dëgjoi si zhvillohej mësimi, kurse në orën e tretë zuri tē pyeste. Pyeti një herë tre shokë, Kush iu përgjegj mirë e kush mjaftueshëm. Pastaj më pyeti mua. Unë iu përgjegjja pa ndrojtje. Si duket edhe atij i pëlqeu përgjegjja ime, se nisi tē më pyeste më gjatë.

— Ç'arësim keni?

— Kam mbaruar shkollën shtatëvjeçare.

— Ashtu, ë?.. Shumë mirë! E shikon ç'do tē thotë tē mësosh me pasion? Ky e ka marrë punën seriozisht. Kurse ju, — iu drejtua një shoku që nuk kish mësuar dhe aq mirë — ju më duket se keni arësim tē mesmë, apo jo?

— Unë... — detari ngurroi.

— Ky ka qenë dhe në Institut pedagogjik — tha instruktori ynë.

— Me arësim të lartë? — inxhinjeri e shikoi drejt në sy.

— Kam qenë në Institut, po nuk kam marrë diplomë.

— Je rrëzuar në provime?

— Isha sëmurë... pastaj... — ai po fliste duke nguruar.

— Nejse, nuk na intereson se si ke ngelë pa diplomë, por sidooqoftë ti pér mua ke institut. Kështu që përgjegjja jote mbi kapitullin e elektroteknikës nuk kënaq asnjeri. Edhe një i paarësim do të mësonte më mirë. Ne jemi të ndërgjegjshëm pér vështirësitë. Programi është i ngarkuar, lënda e ndërlikuar, por kemi zgjedhur edhe njerëz të preqatitur. Mund të ankohen vetëm dy që janë me shkollë shtatëvjeçare, po jo ju të tjerët që keni të gjithë maturë ose shkollë të lartë. Kështu mëson gjithnjë ky, shoku instruktor?

— Pak mëson — tha instruktori.

— E pse, shoku detar?

— Unë përpinqem, shoku oficer, por... por... Unë mësoj mjaft. Po, edhe pse jam me institut, s'duhet shikuar. Unë kam qenë në fakultetin gjuhë-letërsi, prandaj pér spezialitetin tonë s'më ndihmon shumë. Njëlljo si ata me maturë jam.

— Mirë, na thuaj vetëm një gjë: ka ndonjë çikë nën-vleftësim nga ana juaj?

— Ka raste kur njeriu ka ndonjë preokupim dhe... por nën-vleftësim jo.

— Si mendon ti, instruktor? — tha inxhinjeri.

— Ka nën-vleftësim. Ky ka mundësi të mësojë më shumë, por e ka me naze mësimin. Pér këto është rrëzuar edhe në institut.

— Ky Çlirimi është preqatitur mirë — tha inxhinjeri.

— Ky s'fle as natën si njerëzit. Gjithnjë rri mbi tekste e leksione — tha Nikua, të cilit s'iua durua më. (Ne u habitëm sa shumë ndenji pa folur)

— Kush të dha leje të flasësh ty? — tha inxhinjeri dhe vazhdoi. — Sigurisht ndryshe s'do mund të arrinte atë që ka arritur... Pa ngreu ti! — i tha Nikos.

Nikua mësonte pér elektriçist, por gjashtë muajt e parë mësonim bashkë, sepse edhe ne bënim elektroteknikë.

Inxhinjeri e pyeti atë gjërë e gjatë. Nikua iu përgjeë mirë të gjitha pyetjeve, por zëri i tij tingëllonte ca si mospërfillës dhe gjatë përgjegjes qëndronte mbështetur.

— Ti paske mësuar mirë, por sjellja jote nuk është e hijëshme. Flet kur të tekët dhe, kur pyetesh, shiko si qëndron mbështetur. Kështu jo vetëm në shkollë ushtarake, po në asnje shkollë tjetër nuk lejohet.

— Harrova, shoku inxhinjer!

Inxhinjeri e shikoi me nervozizëm. Tha:

— Edhe budalla kërkon të më bësh?

— Lëreni, — tha instruktori.

— Si, ore, ta lë! Ushtaraku ka kaq kohë në ushtri dhe s'di të qëndrojë në orën e mësimit! S'po them nuk do, se më duket e rëndë.

— Shoku inxhinjer, unë s'mund të bëhem tjetër njeri pér qejfin tënd — thá Nikua, duke ngritur zérin. — Përgjegjet t'i dhashë. Unë vëç të bëj si Nastradini, që pat vënë shtëpinë në qerre, pér t'u përgjegjur kërkeseve të të gjithë atyre që i bënin vërejtje pér ndërtimin e saj.

— Dil jashtë! I padisiplinuar!

— Jo, nga laboratori nuk dal!

— Të urdhëroj të dalësh!

— Ünë dal vetëm me urdhërin e shefit të shtabit ose të komandantit të repartit.

— Ç'është ky njeri i përkëdhelur, mor instruktor? Si është e mundur që një ushtarak të sillet kështu dhe ju të thoni «Lëre?»

— Dil jashtë, Niko! — tha instruktori.

Nikua doli pa folur më gjatë.

Kur dolëm të gjithë, e kapëm dhe i folëm, siç bënim zakonisht.

— E pat, pra, nuk e përbajta dot veten.

— Na turpërove para inxhinjerit të flotës. Ti po poshtëron edhe kolektivin kështu. Të paktën pér shokët e tu ki respekt.

— Ç'të bëj, pra! E pat kjo. Edhe ai më foli ters.

— Ti gjithnjë na thua «e pat kjo» dhe përsëri vazhdon ashtu — thashë unë.

— Nuk do ta përsëris më, nxënësi im — tha Nikua me të qeshur.

— Kështu i merr punët gjithnjë me të qeshur ti, Niko.

— E po ç'të bëj! Të qaj tani? Njerëz jemi e gabime bëjmë. Ha-ha-ha!

— Kaq të bren ndërgjegjja, sa je në humor edhe për shakara.

Mbas mësimit u mblohdh efektivi i kompanisë sonë për të shqyrtuar këtë veprim të Nikos. Merrte pjesë edhe zëvëndësi për punë politike i repartit. Komandanti i kompanisë foli gjatë për sjelljen e keqe të Nikos dhe u ndal kryesishët në rastin e fundit.

— Shpesh kam heshtur para këtyre veprimeve të Nikos — tha ai, nga fundi. — Kam heshtur duke menduar se po na kupton. Tani e ka tepëruar. Ç't'i themi tani këtij, kur nuk respekton as oficerët e shtabit të flotës? Shikoni e gjykoni vetë, shokë detarë!

Njëri nga shokët tanë kërkoi leje për të folur dhë u ngrit.

— Për veprimet e Nikos jemi përgjegjës edhe ne, shokët e tij — tha ai. Shpesh, kur ai e bën fajin, ne qeshim, se mbledhur vidat këtij, e kemi ndihmuar shumë pak. Fajiqë ka kryer sot është i rëndë. Ne nuk e durojmë këtë njeri të na njollsoë, prandaj të çohet e të na thotë këtu ç'e shtyn të bëjë kështu dhe ne të nxjerrim pastaj diagnozën.

— Mirë thotë ky shoku — tha komandanti i repartit.

Pak a shumë kështu folën edhe dy-tre të tjera. Pastaj u ngrita unë.

— Një pjesë e fajit të Nikos më takon edhe mua — thashë. — Unë jam zotuar para organizatës së rinisë se do ta ndihmoja, po nuk jam treguar këmbëngulës sa duhet. Tani e tutje do ta kap punën më seriozisht.

— C'mendon të bëjmë tani? — më pyeti komandanti. Ta ndëshkojmë?

— T'i bëjmë një paralajmërim të fundit për ndëshkim të rëndë.

— Ashtu thua ti, ë? Pa çohu ti, Niko, na thuaj vetë si është puna.

— Tani s'ka ç'më mbetet të flas — tha ai. — Unë jam fajtor. Kam ca ditë që jam sjellë mirë. Vetëm sot se si më erdhi se edhe ai oficeri m'u drejtua pak ash-tu... Unë kam marrë shpesh zotime para jush dhe përsëri zotohem të luftoj me veten time edhe në goftë se komanda do të më ndëshkojë.

— Tani ke folur drejt — tha komandanti.

— S'kam pse ta fsheh. Ata shokë më kanë bërë një çikë mikroborgjez, ndonëse familjarisht s'jam i tillë.

Si mbaroi, komandanti tha:

— Unë mendoj që ky të dënöhët kështu: T'i bëjmë letër familjes duke i treguar të gjitha fajet e tij.

— Jo, shoku komandant! — bërtiti Nikua. — Ju lutem shumë familjes mos i shkruani! Më ndëshkon si të doni, por jo kështu. Ju lutem!

E rrähëm shumë atë problem dhe vendosëm që të mos i shkruanim familjes edhe njëherë. Qëndrimi i Nikos na e imponoi këtë gjë.

— Shiko se kolektivi nuk të lë të vazhdosh kështu

— tha komandanti.

— Nuk do të vazhdoj më kështu — tha Nikua.

— Do të shohim.

— 9 —

Në komisionin e provimeve qe edhe inxhinjeri me të cilin ish zënë Nikua. Nikua mendoi se do ta kish keq me të, po nuk doli ashtu. Ai nuk kish mbajtur mëri. Nikua u përgjegj mirë dhe mori dëshminë me nota të mira. Edhe unë kalova mirë. Me mësimet politike isha kapur edhe nuk çaloja më. Kur përfunduan provimet, organizuan një mbrëmje të madhe me familjet e oficerave dhe me fqinjët kooperativistë. Erdhën shumë vajza. Edhe Vera. Ja, përsëri mua do të më jepej rasti të vallëzoja me të.

Klubi ynë kultural ish zbukuruar si rrallëherë. Koo-perativistët dhe familjet e oficerave zunë vend më parë në një krah, pastaj ndenjëm ne në anën përballë. Pasi zumë vendet të gjithë, na përshëndeti sekretari i partisë

i repartit tonë. Pastaj foli nénkryetarja e kooperativës bujqësore.

— Detyrat tona thuajse janë të njëjta — tha ajo.  
— Ju bëni preqatitjet ushtarake, ne bëjmë preqatitje ushtarake. Ne punojmë në prodhim, ju punoni në prodhim. Ju na keni ndihmuar shpesh dhe fakti që përsëri këto ditë do të vini të punoni tek ne tregon se sa të lidhur jemi... — Ajo foli gjatë dhe ne brohoritëm shpesh.

Unë shpesh gjeja rastin të vështroja profilin e Vërsës. Edhe ajo më shikonte ndonjëherë dhe buzëqeshte. Nuk dija pse më pëlqente aq. Aty kish vajza më të mira, po mua ajo më pëlqente më shumë.

Më në fund na u dha rasti të kërcenim bashkë.

— Paske mësuar të kërcesh mirë tanë — tha Vera.  
— Pse, nuk kam ditur herën tjetër?

— Ke qënë më i ngathët. Nuk e hidhje mirë hapin. Këto fjalë më bënë të skuqesha. S'dita si të vazhdoja bisedën.

— A do të më pranosh në skuadrën tënde? — i thashë.

— Po të jesh punëtor i mirë.

— Në arë nuk jam si në vallëzim, atje jam më i mirë — thashë unë.

— Po qe puna ashtu, mund të vish.

Atë mbrëmje vallëzova disa herë me Verën.

Të nesërmën u gjendëm në arë me kooperativistët. Ishte fushata e korries së misrit. Kallintë qenë rritur e ngarkuar me bukë. Desha të shkoja me skuadrën ku ish Vera, po komandanti i kompanisë nuk më la.

— Do të punojmë më vete — tha ai. — Jam në garë me kooperativistët dhe do të shikojmë se kush e fiton. Si thua ti, Çlirim? Nuk është mirë kështu?

Unë nuk dija q'të thoshja, po i hyra punës. Eh, zanati im! Sa shpejt i prisja kashtat e misrit dhe i rrëzoja përdhe! Komandanti më thosh:

— Po prit, se do të theresh në këta kunjat e misrit ose do të pritesh me drapër!

— Eh, shoku komandant, me këtë zanat kam lerë e jam rritur.

— Edhe unë ashtu, por duhet kujdes.

Deri në drekë punuam ashtu dhe e realizuam normën e ditës. Pastaj kooperativistët kërkuan që të bashkohenim ushtarakë e fshatarë dhe komandanti ua plotësoi dëshirën! Kështu m'u dha raشتë të punoja afër Verës.

— Vërtet këtu nuk qenke si në vallëzim — më tha ajo buzagaz; — këtu qenke disa herë më i fortë. Tani pranchesh në skuadrën time.

— Gjithnjë do të më mbash këtu?

— Po të të lënë, edhe gjithnjë të mbaj, posa. Por ti ke ardhur të kryesh detyrën ushtarake, se misër ke pasur edhe në fshatin tënd.

Qeshëm të dy. Rrezet e diellit na digjnin dhe djerësët tonë kullonin në dheun e zhuritur. Ajo i fshinte shpesh djersët me shami.

— Edhe ti u djersitke si unë — i thashë.

— Unë djersitem si unë e jo si ti — tha ajo buzagaz.

Ne biseduam shumë atë ditë. Nikua na kish vrejtur. Në mbrëmje ai më tha.

— Mor djall, më duket se e ke rregulluar me atë vajzë ti. Paske qenë djalli vetë. Je fshatar ti e të shkon fjalë me fshatarët. — Fjalët e fundit i shqiptoi si me tallje.

— Ti ke një farë... si të them.... i nënvliftëson fshatarët — i thashë unë. — Ç'ka një qytetare më shumë se Vera? Kjo ka edhe kulturë. Vazhdon klasën e dhjetë të mbrëmjes.

— Ik, or djall, se të ka gënjer, pa ku ka kohë të vazhdojë shkollë, duke punuar në bujqësi! Apo s'e kanë larg gjimnazin.

— Këtu disa vajza e djem vazhdojnë shkollën e mesme pa u shkëputur nga bujqësia.

Në mbrëmje dola nga shtëpia e kulturës me Verën.

Kur mora vesh se po bëheshin transferimet nëpër anije, shkova me vrapi te shefi i shtabit të repartit dhe iu paraqita. Ai më pyeti për nevojën që kisha.

Unë dua të shkoj në një anije me Niko Gjoshin dhe kërkoj të ma plotësoni dëshirën.

— Ashtu, ë? Të shikojmë. Mbështetje bëjmë gjë. Do të bisedoj me shefin e kuadrit. Mua më vjen mirë që ti e do kaq shumë Nikon — tha shefi.

— Kam edhë diçka, shoku shef i shtabit, po ndoshta po e tepëroj.

— Folë një herë, të shohim.

— Do të dëshiroja shumë të shkoja në anijen e Luftar Bibës.

Shefi i shtabit më shikoi me kureshtje.

— Po kjo ç'do të thotë? Në anije të tilla ka vësh-tirësi.

— S'prish punë.

— Mirë, mor djalë, kjo kërkesë plotësohet, po Nikua me siguri do të prishet me ty, kur të marrë vesh se ke kërkuar ta çosh në atë anije — tha me të qeshur shefi i shtabit dhe më rrahu shpatullat. — Besoj se do të realizohen të dy dëshirat.

Unë nderova dhe dola nga zyra i kënaqur.

Kur ishim rreshtuar për të dëgjuar transferimet, unë kisha ndenjur afér Nikos dhe dëgjoja me padurim.

— ... Niko Gjoshi, Shyqyri Pëllumbi, Dedë Marku, he Clirim Haka caktohen në anijen që komandohet nga Luftar Biba.

— Mos, more! — bërtiti Nikua, që kish qejf t'i dilte emri në anije ndihmëse.

— S'ke ç'i bën. Jemi mirë dhe atje — i thashë unë.

— Mirë që qenkemi bashkë — tha i vrejtur Nikua.

— Por në dragamina ka mjaft vështirësi.

Mbasi u shpërndamë, shkuam në kapanone, murem valixhet, çantat e shpinës e gjithë ç'kishim dhe, si morëm fletëshqërimet te kujdestari i kompanisë, u nisëm në drejtim të bankinës, ku prisnim të vinte një anije të na merrte, për të na çuar në repartin tonë.

Atje pritëm shumë, por anija s'po vinte. Pastaj na thanë se do të shkonim në një anije që kish ardhur atje me shërbim. Koha ishte e mirë, ditë me diell, por erë frynte mjaft. Kreshtat e bardha të tallazeve dëbonin një-

ra-tjetren dhe përplaseshin me furi në bregun shkëmbor të detit. I ndieja shokët se thoshin fjalë jo të mira për detin atë ditë, por unë as që bëhesha merak, mbasi s'dija ende ç'do të thoshte det. Kisha hipur në anije shpesh për praktikë, kur mësonim në kurs, por s'më kish takuar të lundroja me dallgë të furishme.

Sapo shkelëm në anije, dezhurni na dha urdhërin të futeshim në kubrik. Nikua s'u bind. Qëndroi andej nga kici. Dezhurni iu afrua i hidhëruar dhe i tha:

— Po ti je burrë më i mirë se të tjerët që s'i bindesh urdhërit a?

— Se mos po të bëj ndonjë dëm unë këtu!

— Ka dhënë urdhër komandanti, shoku detar.

— Unë s'e shoh të nevojshme të hyj në kubrik.

Kam qejf të shoh veprimet e detarëve.

— Ah, kokëkrisur që qenke! Me këtë mendje s'do të kalosh mirë në anije ti! S'ka shkollë instruksioni atje!

— Pse? Si të duket shkolla e instruksionit? Gjë pa rëndësi a?

— Nuk është pa rëndësi atje, por në shkollë ke pasur detyrë vetëm për të mësuar, kurse në anije ke detyra të tjera. Këtu ke postin luftarak. Përgjegjësia për çdo punë të bie ty mbi supe. Mbi ty e mbi ne së bashku rëndon përgjegjësia e mbrotjes së Atdheut.

— Nëpër vende qëndroni! — nga bankina për t'u çakostuar u dha urdhëri me anë të portavoçit.

Ndërkaq dezhurni e ndërpreu bisedën me Nikon dhe ja dha vrapt te posti i tij luftarak.

Shpejtësia me të cilën anija u shkëput nga bankina na mahniti. Veprime të gjalla të detarëve. Komanda dhe zbatime të përpikta. Sapo anija nisi të çante dallgët me bash, filluan lëkundjet e paprovuara kurrë nga ana ime. Herë-herë ndjeja dhe një farë frike nga ato lëkundje të tmerrshme. Megjithatë, ende s'ndjeja vështirësi.

Bluaja në mendje të ardhmen time në anjen luftarake, ku isha caktuar të shërbeja. Papritmas mbi kuvvertë doli një nga shokët e mi, me të cilin isha caktuar në një grup, dhe me sy nga bordi, me bulçinj të fryrë dhe i skuqur spec në fytyrë.

— Ku vete?! — i bërtiti një nga detarët e kicrit.  
— Mos lëviz, se do të mbytesh në det! — e urdhëroi tjetri. — Vill aty mbi kuvertë! S'ka gjë. Do ta pastrojmë!

Shoku im ja plasi të vjellit si mos më keq. Mua më kalli neverinë. Dola edhe unë në kuvertë.

— Mbaje veten pak! — i bërtita. — S'bëhet kështu!

— Të shikojmë si do ta mbash ti — tha detari i mëparshëm. — Prit se rruga është e gjatë. Kemi për të ecur më shumë se një orë kështu.

Më duket se s'pat mbaruar ende ai detari, kur unë ndjeva një të përzier në stomak. Nga lëkundjet e mëdha më ngjiteshin zorrët nga poshtë barkut dhe më dukej sikur donin të dilnin nga goja. U mundova ta mposhtja këtë gjendje me këmbëngulje, por s'po e mbaja dot veten. Me gjithë këshillimet e detarëve dhe urdhërat që vinin nga ura e komandantit, unë u afrova në bord që të villja në det. Më vinte rëndë të bëja pis kuvertën e ta pas-tronin të tjerët. Dhe ndoshta do të kisha fluturuar në mes të dallgëve, sikur të mos më kishte kapur nga mbrapa njëri nga detarët.

— Qenke i krisur fare! — ma pat ai me të egër.

Unë po villja pa ndërprerje. Më ziente koka, më ziente stomaku. Kurse Nikua më shikonte dhe qeshte. Kaloi kështu një farë kohe. E shihja veten gjithnjë më rëndë.

— Lëshomë! — i bërtita detarit. Dhe u vërsula nga bordi.

— Mos u çmende? Ku do të shkosh? — më tha ai, ndërsa shokëve u tha: — Më ndihmoni ta çoj në kubrik!

Pa dëshirën time më dërguan atje. Atje ishte një ajr i rëndë që të zinte frysë. Desha të mos rrija aty, po q'të bëja? Edhe shokët e mi kishin rënë mbarë e mbrapshtë nëpër kubrik, por më keq nga unë s'dukej asnjëri.

Sa më thellë shkonte anija në det të hapur, aq më tmerrsisht lëkundej poshtë e lart. Nikua mbahej fort. Ende s'kish vjellë.

— Çlirim, qëndro tani! Qëndro, se shkuam, he derr!  
Burri i fortë në ditë të vështirë. A më shikon mua si  
qëndroj?!

— Lërmë, Niko, të lutem! E gjete kohën për shaka.

— Jo ashtu, Çlirim! Mos u shburrëro! Do të mëso-  
hesh. Ja, i shikon shokët tuaj, detarët e kësaj anije?  
Asnjë s'e zë deti. Edhe këta i ka zënë kështu në fillim.  
Hë, derr! — qeshi ai.

S'më kujtohej të kisha qenë ndonjëherë më ngushtë.  
Gjithë ç'kisha pasur i kisha nxjerrë.

Ndérkohë nëpër anije u dëgjuan zilet që tingë-  
llinin me ndërprerje e sikur të fusnin gjëmba në tru.

— Arritëm! Arritëm! — u dëgjuan zërat nëpër kub-  
rik.

Vërtet ashtu dukej, se edhe lëkundjet e anijes vi-  
nin si më të pafuqishme.

Kur anija u qetësua fare, ne hapëm derën e kub-  
rikut dhe na urdhëruan të dilnim jashtë. Në atë ban-  
kinë luftarakë ku u ndalëm ne, ishin rreshtuar një mo-  
anijesh të tipave të ndryshëm. Vendi ishte shumë i bu-  
kur. Kregulli mbretëronte brënda në port.

Kur dolëm në bankinë, na dhanë urdhër të rreshto-  
heshim. Atje na priti shefi i organizimit të repartit. Ai  
bëri apelin dhe na ndau simbas nënreparteve.

— Ju — na u drejtua neve të anijes së kapiten  
Luftar Bibës — sonte do të flini në bazë, se anijen  
tuaj e keni në rimont «X». Nesër do të shkojë një katër  
silurues torpedinier atje dhe do të shkonit me të.

— Prapë do të udhëtojmë me anije? — thashë pa-  
vetëdije.

— Po si kujtovë ti? Aeroplan deshe? Në anije do  
të jesh gjithnjë. Të paska zënë deti? Do të mësöhesh.

— Jo, shoku shef, neve na gjeni një vend këtu në  
bazë. Anija na zë shumë — tha Nikua. — Na ka marrë  
shpirtin.

— Ju kemi caktuar atje që të kaliteni me dallgët  
e detit.

— Nuk mundemi, shoku shef! — tha Nikua.

— Qenke edhe i padisiplinuar! Ku ke parë ti të  
kundërshtosh urdhërat e komandës?

Unë e tërhoqa pak Nikon nga mbrapa që të mos bëzante.

— E ka munduar shumë deti, — tha njëri. — Mos ja merrni pér keq!

— Sa të gjatë e paska gjuhën se! — tha shefi i organizimit dhe u nda nga ne. — Merri e çoja në kapanon — urdhëroi një nënëoficer. — Të hanë e të flenë sonte atje!

— Si urdhëron, — ja priti nënëoficeri.

— Ju ka lodhur deti — tha ai. — S'ka qenë dita aspak e përshtatshme pér udhëtimin tuaj sot. Po... kështu kemi hequr të gjithë. Mos u mërzitni! Do të mësoheni! Nesër do të shkojmë së bashku me katrin tonë te anija juaj. Edhe nja dy-tri javë kemi remont e, pastaj... ehu! Kështu e ka kjo. Veçse njeriu s'duhet të mërzitet.

Të nesërmen nuk u nisëm pér në repartin tonë, siç na kishin thënë. S'di se si e kish anuluar planin komanda. Nisja e katrit silurues u shty edhe një ditë më tej. Atë ditë unë e kisha marrë veten. Tërë ditën e kaluam duke shetitur nëpër territorin e garnizonit. Në mesditë na shoqëroi përsëri ai nënëoficeri. Mbi të gjitha atje më pëlqeu «Klubi i detarit». Ai kishte pamjen e një shtëpie kulture me të gjitha pajisjet e nevojshme: qendër zëri, sallë lojnash, bibliotekë mjaft të madhe, sallë shfaqjesh dhe salla të tjera rezervë pér punëtë ndryshme që s'i vizitova. Ngjitur me të ishte dhe një bufe në të cilën punonte babai i një oficeri të katraje silurues.

Në mbrëmje në kinema verore «Detari» pamë filmi «Shigjetat e kaltra». Unë e kisha parë dhe një tjetër herë këtë film, por kësaj radhe më pëlqeu më tepër. Sigurisht kjo vinte se tashmë unë kisha filluar të mësohesha me jetën e detit.

Të nesërmen na zguan herët pér t'u nisur te anija jonë. Kur shkuam në bankinë, katrin e gjetëm të gatshëm. Motorët e tij gumëzhinin me një zhurmë shurdhuese dhe nxirrnin një tym të dendur si të kaltër. Sapo më ra ai tym, m'u zu fryma. M'u duk se aty pér

aty do të villja. «Si do të kaloj katër orë kështu?» tha-shë me vete.

Ai nënöficeri, i veshur i tëri me llastikë, ashtu si të gjithë detarët e katrit silurues, më erdhi pranë:

— Mos ki frikë se torpedinieri nuk të zë si anjet e tjera — më tha. — Ky shkon me shpejtësi dhe nuk tundet fare. Fluturon mbi dallgët.

Kur hipëm në torpedinier dhe ai mori semaforët në dorë pér të kërkuar lejë te operativi, e mora vesh se nënöficeri na qenkesh bocman i torpedinierit. Në torpedinierët e vegjël bocmani kryen njëkohësisht dhe detyrën e sinjalistik.

Si dualëm nga porti, anija e vogël u drejtua nga pika ku do të arrinim, pra, siç i thonë detarët, u vu në kursin e saj. Motorët buçiten. Zhurma e tyre shkrihej në një melodi të vetme. Bashi i saj thua se ish drejtuar nga qielli. Një mjegull e dendur uji ngrihej përpjjetë. Prapa torpedinieri linte një shirit të trashë shkume dhe pér një kohë s'mund të lëviznin as dallgët, që ngrinin kurrizin pér nën të. Tek e shihnim veten në atë tunel uji që kish hapur torpedinieri, rrnim si të hutuar. Ndjenim një farë frike, ndonëse e dinim që kështu kish lundruar gjithnjë ai ekuipazh dhe s'kishte pësuar ndonjë të keqe.

Si m'u zhduk ajo frikë dhe kureshtja e parë e atij udhëtimi, nisa të mendoj pér gjëra të tjera. Më së pari më shkoi mendja te familja, pastaj te Vera. S'di sepse mendoja ashtu pér të. Më kish pëlqyer shumë. Momentet që e kisha parë më dukeshin vetëm si vegime të çastit.

Nga gjysma e rrugës torpedinieri e pakësoi shpejtësinë. Muret e mëdha të shkumës së bardhë që na shoqëronin anash u fashiten. Filluan të duken luginat e kodrat e formuara në sipërfaqen e ujit, që detarët i quajnë «det i vdekur». Detarët lëvizën me shpejtësi mbi kuvertë, u mblohdhën kokë më kokë dhe pastaj dëgjuam zërin e komandantit që tha:

— Të zhduket avaria!

Unë u ngrita dhe pyeta nënöficerin ç'kish ndodhur.

— Nuk funksionon njëra helikë — më tha tërë nervozizëm. — Kemi ecur me tërë shpejtësinë përpara,

se duhej tē arrinim shpejt, por tan i na ndodhi një e papritur. Dreqi ta hajë! Ku e gjeti helika tan i?!

Anija hidhej përpjetë si ndonjë gogël. Përsëri fillova tē vjell, po kësaj here nxirria vetëm vrer, meqë, duke ja pasur frikën, s'kisha ngrënë gjë atë mëngjes.

Kishte edhe tē tjerë nga grupi ynë që villnin.  
Edhe Nikon e zuri deti.

— Çudi — thosh Nikua — si s'më zuri dje, xhamëm? S'e kam ndjerë fare, kurse tan i... pra, lëkundjet më duket kanë qenë më tē rënda dje.

— Kjo është punë e vështirë, or vëlla! — thashë unë dhe u shtriva në një mushama.

Atëhere vura re se qelli po zihej nga disa tufa resh si shtëllunga tē bardha, po diku edhe tē zeza. Ndërkakq, retë zunë edhe diellin. Detarët e torpedinierit ishin shqetësuar.

— Po prishet edhe koha tan i?!

— Me tē vërtetë do ta kemi keq.

— Shpejtoni tē zhdukim avarinë!

Flisnin detarët dhe vepronin secili simbas detyrave. Po fjalën tan i e kishin mekanikët. Difekti ish në vend tē keq. Që nga anija s'mund tē bënin asgjë. Prandaj njeri nga motoristët veshi bluzën prej llastiku tē fryrë me ajër, u hodh në ujë dhe nisi tē punojë.

Kaloi kështu një kohë e gjatë dhe anija s'u vu në gadishmëri. Komandanti i anijes lëvizte me nervozizëm sipër kuvertës, por detarëve nuk u fliste. Ai pyeste herë pas here pér gjendjen e avarisë. Po, siç na thoshin detarët, avaria s'qenkej e vetëm në helikë. Ajo vijonte edhe nga aksi i helikës e kështu që ish e pamundur tē zhdukej lehtë. Tre detarë kishin rënë në ujë me salva-xhente dhe punonin.

Qelli u zu krejt nga retë. Koha po prishej, po erë ende s'po frynte. Vetëm kjo i favorizonte detarët që punonin. Majat e maleve u pështollën me një shtresë mjegulle.

— Do ta zhdukin shpejt difektin apo jo? — pyeti mekanikët komandanti. — Të njoftojmë komandën me radiogram dhe tē vijë tē na marrë ndonjë anije, mbasi

u bëmë pér kështu. Ta marrë djalli! Turp pér ne! Kur mbetemi ne, katri siluruës, po anijet e tjera? Anija jonë duhet t'i kapërcejë avaritë më shumë se gjithë tipat e anijeve të flotës. Është turp të njoftoj. Çfarë thoni? — perfundoi.

— Ç'mund të themi, shoku komandant? Me siguri do ta rregullojmë, por do të vonohemi.

— Atëhere hiqeni fare një helikë, se do të ecim vetëm me njérën dalngadalë.

Po ndërkaq doli njëri nga mekanikët e tha:

— Na prisni edhe pak, se e rregulluam!

— Jepni, pra, he petritë, se po ju presim! — tha komandanti, që erdhi në qejf.

Më bënte përshtypje qëndrimi i atyre detarëve, i atyre njerëzve të detit që e përballonin të keqen pa u dëshpëruar. Bile më dukej sikur ata ndjenin kënaqësi kur kacafyteshin me ndonjë vështirësi. Tek shikonim si zhyteshin në ujë motoristët dhe si i përplasnin dallgët andej-këndej, habiteshim.

Më në fund u ndezën motorët, u bë prova dhe u nisëm. Filloi të pikonte nga pakëz shi. Detarët iu afrojan njëri-tjetrit.

— Jepu mushamatë, nënoficer Sabriu! — e urdhëroi komandanti nënoficerin.

Sabriu hapi një bokaportë dhe nxori që andej një mushama të madhe me të cilën u mbuluam të gjithë. Kësaj here e pashë të nevrikosur.

— Po na prishet moti! Ka rënë mjegull gjithandej. Anija jonë nuk i ka të gjitha mjetet e lundrimit pér të lundruar me saktësi në çdo situatë — tha ai duke treguar mjegullën me dorë.

Kur pamë se nënoficer Sabriu qe shqetësuar aqë, ne u shqetësuam edhe më tepër.

Vijuam kështu udhëtimin të humbur fare në mjegull. Asgjë s'shihej para as mbrapa. Ujë e tym. Mbas afro njëzet minutash, kur e ndjeja veten pak në gjendje, se deti s'më zinte, u tronditëm aq rëndë, sa u shtypëm me njeri-tjetrin nën mushama. Dhe torpedinieri s'lëvizi më.

— Po kjo ç'dreq është? — pyeta unë.

— C'na ndodhi? — bërtiti Sabriu.

— Kemi dalë në tokë! Edhe kjo na duhej.

U mblodhën të gjithë mbi kuvertë. Si do të bënim?

Komandanti ishte i shqetësuar, por s'e bënte veten. Gjendja ishte pa rrugëdalje. Datarët që ishin atje, edhe sikur të uleshin të gjithë e ta shtynin anijen, s'mund ta luanin vendit. Edhe një gjysmë ore na mbetej për të shkuar në bazë.

— Duhet të kërkojmë ndihmë, — tha komandanti.

— T'i kërkojmë ndihmë dragaminës së komandant Luftarit. T'i bëjmë radiogram: ndoshta ndodhet ndonjë rimorkiator atje. Thuaji radistit të njoftojë edhe dragaminën, edhe komandën tonë — iu drejtua nën oficer Sabriut dhe, si na hodhi një sy neve, na tha:

— Mos u bëni merak ju! S'do të ndodhë asgjë! Eh deti ka shumë të papritura! Ka raste kur ke qejf të dalësh e të lundrosh në det, e sidomos në këta torpedinierët. E patë sot sa bukur e çante ujin dhe ngrinte atë shkumë të bardhë?... Mirëpo mund të ndodhë edhe ndryshe. Njeriut i rastis të provojë gjithshka. Pikërisht kjo e karakterizon ushtrinë tonë: sakrifica, kalitja me vësh-tirësitë. Ne jemi gjithnjë në luftë. Më afër kemi luftën se këmishën e shtatit. Prandaj q'është ai budalla që do të kërkonte jetë të rehatshme këtu? Kështu, o shokë dëtarë! Ju porosis një gjë: të mos përkulen para vështirësive.

Ndérkaq doli radisti nga kabina dhe njoftoi:

— Shoku komandant, urdhëri juaj u zbatua! Dragamina m'u përgjegj se do të vijë.

— E po mirë. Ja, po ju vjen dhe anija juaj! — na u drejtua komandanti. — Veç se shumë punë u kemi qitura. Është vështirë të na nxjerrin këndej. Është cekinë e madhe. Dragamina s'mund të afrohet.

Shi s'binte më, veç ishte mjegull andej nga bregu. Tokë e mal s'dukej askund. Datarët rrinin në këmbë mbi kuvertë. Meqë lëkundje s'kish më, e ndjeja veten mirë. Shikoja detin që kaltëronte pcshtë. Në atë kaltërsi herë më shfaqej, herë më zhdukej fytyra e Verës. Pastaj përfytyroja anijen time dhe përpinqesha të përfytyroja postin tim luftarak në anije.

Kur u duk dragamina së largu, kish nisur të binte muzgu. Mjegulla ishte zhdukur, por ishte shtuar një e keqe tjetër: kish nisur të frynte një erë që sa vinte e shtohej.

E ndoqëm me sy anijen dragaminë derisa u ndal në vend dhe lëshoi spirancën. Tani e ndjenim veten keq. Dallga që vinte nga deti i hapët, na binte sipër kuvertës. Brenda pak minutave u bëmë qull. S'kishim si të mbroheshim. Na thanë të futeshim në lokale, po unë ngula këmbë:

— Jo, shoku komandant, ne duhet të bëjmë diçka. Të fortë jemi, notin të gjithë e dimë dhe mirë fort bile. Pse të rrимë brenda?

— S'qëndroni dot. S'keni ç'të bëni të gjithë. Jemi mjaft për punë. S'kemi tjetër punë, veç të lidhim kavon që do të na sjellin ata.

Së fundi u futëm në lokal. Po s'rrinim pa dalë herë mbas here për të parë se q'bëhej.

Dragamina dérgoi një motolanxhë të na sillte kavon për rimorkimin e anijes. Po ajo nuk bëri shumë përpara dhe u kthyte në vend. Nuk mund ta kalonte atë det të stuhishëm. Sapo bëri disa metra përpara, filloi t'i hynte uji brenda. Dallgët shtoheshin aq shumë sâ, kur pérplasheshin mbi kuvertën e torpedinierit, dukej se po e shembnin fare. Tani të dy palët rrinim e vështronim. Ishte pikëpyetje si do të vazhdonim më etj. E, pra, torpedinieri duhej nxjerrë. Edhe komanda e repartit kish urdhëruar dragaminën që të kryente këtë mision. Komandanti i dragaminës rrinte në urën e komandimit dhe mendohet. Të urdhëronte ndonjë detar të hidhej me not, ishte vështirë, se duhej marrë parasysh vdekja. Të hidhej vetë ishte e pamundur, se s'kish kujt t'ja linte anijen.

Ndërkaq në urën e komandimit u paraqit një djalë i shëndoshë me trup mesatar e me një fytyrë kuqaloshe. Ishte kryeminjari i anijes,

— Shoku komandant, e shpie unë kavon atje! — tha ai me gjakftohtësi.

— Po ti duhet të jesh në anije për çdo gjë! — Je komandant i postit luftarak.

— Për këtë s'ka rëndësi, shoku komandant. Kam zëvendësin. Ai bile është më i vjetër.

Komandanti i tha kështu detarit se e kish të vështirë t'i jepte pëlqimin, po sa për postin luftarak s'kish edhe nevojë. Po sikur të mbytej? Ja, ç'do të thotë të jesh komandant! Çfarë përgjegjësie kish komandanti! Detar Vangjel Peta priste urdhërin e tij.

— Shkoni, pra, detar Peta! Vec, po të shikoni rrëzik, ju lutem kthehuni!

Vangjeli me shpejtësinë më të madhe u zhvesh, veshi salvaxhentin, mori kokën e kavos dhe u hodh në ujë. Vangjeli ishte notar shumë i zoti. Me gjithë pengesat e dallgëve, ai çante përpëra. Po torpedinieri ish larg. Uji ishte i ftotë. Aq më tepër era e pengonte për këtë. Vangjeli shkonte përpëra, sado që rruga që bënte ishte e pakët. Edhe një pash edhe një tjetër, distanca shkurtohej. Sytë thuajse s'mund t'i hapte. I digjin si në zjarr. Hunda akoma më keq, kurse barku i qe fryrë nga gllénkat e ujit të kripur. Edhe një pash... edhe një pash... Vangjeli tani po luftonte me shpirt. Komandanti vërente nga ura e komandimit plot ankth. Edhe një pash... Vangjeli mbeti për një moment. I buçisnin veshët. I buçiste tërë koka. Po zotimi që kish marrë para komandantit? Urdhëri i komandës për nxjerrjen e torpedinierit, gjendja në të cilën ishte ekuipazhi i torpedinierit dhe ne detarët e ri e bënim që të mos jepej...

Kur u ngjit në kuvertë, ishte bërë si i vdekur. Detarët u vërsulën dhe e lidhën mirë e mirë anijen me kavo. U bë gati për t'u tërhequr. Si u njoftua anija me anë të prozhektorit të fillonte tërheqjen, ne u vumë në vëzhgim. Tashmë dita i kishte lënë vendin natës, po fat-mirësish nuk ishte edhe aq terr, sepse hëna ishte afër gjysmës. Por drita e fortë e prozhektorëve të dragamës s'kish nevojë fare për hënë as për diell.

Më në fund filloi tërheqja. Kavoja u tendos aq shumë, sa kujtuam se do të këpütej, por në ato çaste torpedinieri lëvizi nga vëndi dhe filloi të lëkundet si një

gogël. Ne e kuptuam se ishim në rregull. Dragamina na têrhoqi gjer thellë, pastaj u morëm vesh, zgjidhëm kavon dhe u nisëm pér në port.

Atë natë u futëm në dragaminë të gjithë: ne dhe ekuipazhi i torpedinierit, mbasi atje kish mjaft vend pér të fjetur. Ne detarëve të rinj na mblodhi zëvendëskomandanti në kubrikun e parë të fjetjes. Ai na foli mbi jetën që do të kalonim atje dhe mbi detyrat që kishim simbas specialiteteve.

Ai kishte një bisedë të ëmbël, një ton të këndshëm dhe takt; komunikonte fare mirë me detarët. Ndoshta se më pa si më të dobët nga të tjerët, më pyeti jo pér të marrë përgjegje:

— Ti je elektroshтурmani, ë? Shumë mirë. Ti ke të bësh me mua gjithmonë...

— Ku është, mor, elektroshтурmani? — na ndërprenë zëri i një detari që u dëgjuat në atë çast. — Ka ardhur muçua, zëvendësi im? Ha-ha-haaaa! — qeshi dhe qiti kokën në një derë, ku kish postin luftarak.

— Futu atje, or djall! — i bërtiti oficeri.

— Jo, shoku oficer, po... — ai mbylli derën dhe u zhduk.

Kur mbaroi oficeri me ne, shkuam në mensë. Ajo ishte si ndonjë restaurant luksoz. Në çdo skaj të kubrikut kish altoparlant. Me muzikë të kënaqej veshi ngado që të shkoje. Sa bukur ish!

Qysh të nesërmen fillonte pér ne jeta e anijes, regjimi sipas rregullave ushtarake të flotës. Dhe pikërisht qysh në orën gjashtë, Nikua e theu disiplinën. Kur ra zilja pér zgjim, u kthyte në krahun tjetër; pa le që në gjimnastikën e mëngjezit s'doli fare. Kjo u bëri përshtypje të gjithëve. Kish disiplinë atje. Në gjimnastikë dilte edhe vetë oficeri, kurse Nikua s'trazohej. Oficeri dezhurn e pyeti pse s'kishte dalë, po ai u justifikua duke thënë se ishte i tronditur nga deti. Ai e këshilloi të mos e përsëriste dhe nuk i tha gjë më gjatë.

Në orën tetë ra zilja pér ngritjen e flamurit.

Pastaj na shpërndanë në rimont. Një pjesë do të kruante ndryshkun mbi kuvertë, një pjesë do të bënte

ca lyerje me bojë, një pjesë do të merrte postet luftarak. Mua më caktuan të shkoja me komandantin.

Ai nisi të më fliste për postin luftarak, për pjesët që duheshin riparuar, për veprimtarinë e tij në atë post luftarak. Natyrisht më foli për raste suksesesh në teknikë si dhe për avarira që kish pasur në momente të ndryshme. S'prioste pyetje prej meje. Ndezëm edhe bu-sullën xhiroskopike dhe pamë funksionimin. Për teknikën interesohesha shumë.

Si shikuam dhe ca gjëra në postin luftarak, na thirri oficer Agimi në kabinën e shturmanit. Atje zuri të më pyeste për njohuritë që kisha rrëth specialitetit dhe e pashë se mbeti i kënaqur nga përgjegjet e mia.

Mbasdite filloj përsëri puna për rimontin. Stërvitje s'bën fare ato ditë në anije. Vetëm punë. Duhej kryer rimonti sa më shpejt. Rimonti ishte shumë i kufizuar: pastrim ndryshku, lyerje me bojë, riparim i ndonjë pjese të ndonjë maqinerie e tjera. Ndoshta për këto gjëra s'do të kish ardhur dragamina, po shkaku ishte tjetër: ish parashikuar të nxirrej një motor ndihmës dhe të dërgohej në uzinë për rimont të përgjithshëm. Mirëpo ende s'ish nxjerrë. Uzina mekanike ishte shumë e zënë me punë. Pastaj s'ish dhe aq punë e lehtë. Motori do të hiqej nga anija dhe do të dërgohej në Tiranë. Nga java e ardhshme thoshin se do të vinte ndonjë shok nga uzina «Enver» dhe të shihte gjendjen në përgjithësi të motorëve. Atëherë do të çonim motorin atje. Pra, se sa do zgjaste rimonti s'dihej.

Paraditën e kalova mirë, por mbasdite më kapi mallengjimi. Isha mësuar në shkollën e instruksionit me shumë shokë. Komandantin e postit tim e dëgjoja tek më fliste për aparaturën dhe i përgjigjesha rrallë.

Dilja herë mbas here mbi kuvertë dhe sodisja natyrën. Sikur më davariste ca mërzitjen soditja e natyrës dhe kuriozitetet e qytetit që shtrihej në atë bregdet. Si dola disa herë jashtë, kohë e pa kohë, komandanti im më tha:

— Shiko, Çlirim! Mos dil mbi kuvertë pa rënë zilja, se nuk lejohet! Është orar stërvitjeje tanë.

— Ashtu?! Nuk u lejoka tē dal gjithnjë?

— Po, kështu është rregulli, mor Çirim.

— Është punë që rregullohet ajo, po nuk e dija.

— S'ka gjë, po mos e përsërit!

Kështu kish vepruar edhe Nikua në lokalin e makinive, por s'kish çarë kokën që e kishin porositur e prorët e shokët. Dilte e pinte duhan sipas qejfit!

Më në fund e gjeti vetë dezhurni i anijes:

— Shoku detar! Pse s'ke shkuar në postin tēnd luftarak? Tē ka dhënë kush leje? — e kish pyetur.

— Jo, s'më ka dhënë njeri leje. As që kam kërkuar. M'u ça hunda pér një cigare dhe e ndeza një herë, mbasi në post luftarak s'lejohet.

— Shko më thirr komandantin tēnd!

Nikua njoftoi shefin mekanik. Ky u ngrys në ftyrë.

— Dreqi ta hajë! Tē ha vërejtje unë pér sherrin tēnd!

— Mos ha vërejtje. Ti je në rregull! — tha Nikua me gjakftohtësi.

— Por këtu komandanti është përgjegjës pér veprimet e vartësit tē tij! Ende s'je sqaruar?

Kur shkuan para oficerit dezhurn, shefi mekanik e pati vërtet keq.

— Pse ky detari yt del tash sa herë e pi duhan në kuvertë në kohë tē stërvitjes? Përse rri ti atje? Për burrë tē mirë tē kemi vënë komandant posti? Më thuaj si është puna.

— Po ja, shoku oficer... janë tē rinj...

— Mor, po s'është i ri se ka një vit në ushtri, ky. I ke dhënë leje ti?

— Jo, s'më ka dhënë leje. Bile më ka këshilluar tē mos dilja. Po unë pa pirë duhan s'rri dot. — tha Nikua.

— Mos folë pa leje, detar! Në ç'rregullore ke parë se mund tē flasësh pa leje?

— Po i flisni pa tē drejtë këtij. — Nikos i kish hipur gjaku në kokë dhe fliste pa u tundur fare. — Unë bëj faj e ti i flet këtij! S'është e drejtë, shoku oficer!

Oficeri dezhurn mbeti në heshtje pér një moment.

Ja kish ngulur sytë dhe e vrente me habi. I kish ndryshuar fare shprehja e fytyrës.

— Ti na qenke i padisiplinuar... Do ta fillosh jetën e anijes me ndëshkim më së pari!

— Ama, më trembe!

— Si guxon të kundërshtosh kështu?!.. Si guxon të flasësh kështu para oficerit të rojës?

— Pse, mor, ç'u bëre ti?

Zemërimi i oficerit kish arritur kulmin.

— A je anëtar i Bashkimit të Rinisë?

Nikua s'u përgjegj.

— Jo, s'është! — tha shefi i tij.

— Bjeri ziles për rreshtim! — urdhëroi oficeri nën oficerin, që rrinte e dëgjonte jashtë kabinës.

Kur u rreshtua gjithë efektivi, oficeri doli para ekuipazhit. Urdhëroi Nikon të dilte dhe ai atje.

— Për qëndrimin arrogant, për fyerjen e menduar të oficerit dezhurn, detar Niko Gjoshit i hiqet vrejtje me shënim në biografi.

Kur dëgjova këto, unë lëshova një «oh» dhe ula sytë përtokë, ndërsa Nikua shikonte indiferent.

Oficeri dha urdhër të shpërndaheshin detarët, kurse ai vetë shkoi në kabinën e tij.

Çështja e ndëshkimit të Nikos bëri bujë në anije. Detarët bisedonin me njëri-tjetrin. Kush ishte ky njeri që ndëshkohej që ditën e parë? Kjo s'kish ndodhur ndonjë herë. Këtë lajm e mori vesh oficer Agimi dhe, pas pak, zëvëndësi për punë politike, Llukani. Ai e thirri oficerin dezhurn, dhe u mundua t'ja mbushte mendjen të mos ja jepte ndëshkimin Nikos, por ai s'tundej.

— Nuk e prapësoj vendimin e marrë! Kjo e drejtë më takon sipas rregullores dhe, bile, po ta prapësoj vendimin, dë të shkel rregulloren. S'kam parë ndonjëherë njeri të tillë arrogant, pa respekt ndaj eprorit. Nuk është ndonjë tip budallai. Është mjaf i zgjuar. Edhe në gjyq ushtarak do ta çojmë po të vazhdojë me atë mendje — i foli me një frymë oficeri Llukanit dhe shtoi: — Ju s'keni parë gjë, shoku zëvëndëskomandant. Po ta kishit dëgjuar si fliste me mua, do ta kishit ndëshkuar edhe më rëndë.

— Do jetë ndonjë tip kush e di...

— Të jetë ç'të jetë. Po të jetë i tillë, le ta heqë mjeku nga detyra. Përderisa na e kanë sjellë këtu, do të zbatojmë rregulloren.

Llukani u mendua një çast. Pastaj tha i dëshpëruar:

— Më vjen keq për përpjekjet që ka bërë ky kollektiv për të fituar titullin «Anije Shembullore», po fundja s'ke ç'bën. Për hir të këtij titulli s'bëhen lëshime të tilla. Po sikur të pranojë fajin ai dhe të kërkojë ndjesë? Ta provojmë njéherë?

— E mirë, mirë! Bisedoni një herë me të, pastaj flasim bashkë. Ai s'do t'ju bindet.

Nikos iu desh të paraqitej edhe te zëvendësi për punë politike. Kur hyri në zyrën e tij, ai u ngrit në këmbë dhe i dha dorën. E pyeti për familjen, në kish marrë letër apo jo, e të tjera. Nikua ish mësuar me taktin e punëtorëve politikë dhe pak i bënte përshtypje një pritje e tillë.

— Ulu! — i tha, duke i treguar me dorë karrigën përballë tij.

Nikua kundërshtoi, por ai nguli këmbë. Ç'të bënte? U ul dhe priti luftën! Mbas shumë bisedash, ai i tha:

— Të pëlqen ndonjë çikëzjeta e anijes apo jo?

— Mund të jetë e këndshme, po për mua nuk është — tha Nikua i vendosur.

Ai tendosi lëkurën e fytyrës dhe pyeti i tronditur:

— Pse kështu, pa më thuaj?

— Mua më zë deti. E kaloj me shpirt ndër dhëmbë. Ndaj s'di ç'bëj, thyej disiplinën, ngatërohem me një rëzit kot më kot...

— Është tepër shpejt për të arritur në këto përfundime. S'e ke provuar akoma nëse të zë apo nuk të zë deti — tha ai dhe qeshi me zë të lartë. — Me dy të lundruara nuk nxirret ky përfundim.

— E kam provuar sa e sa herë. Me detin nuk më ecën.

— Po mirë, ore Niko, po qe ashtu, ne do të interesohemi. E zgjidhim problemin. Ne mund të të nxjerrim me ndonjë shërbim në tokë. Duhet ta marrësh punën

shtruar. Ta përmbaje veten, të bisedoje me ne, pastaj shikonim e bënëm. Jo ta çosh veten sa të fyesh edhe oficerët

— S'mund të qëndroj pa pirë duhan.

— Kush ta ka ndaluar duhanin?

— I ndaluar është se s'të lënë ta ndezësh vëç me orar. Unë, kur të më vijë qejfi, e dua duhanin. Po të mos e pi atëherë, mund të mos e pi edhe më vonë dhe e lë fare, por kjo s'mund të bëhet.

— Shiko këtu ti, Niko! Që t'i vemë kapak kësaj punë, mendoj të shkosh dhe t'i kërkosh të falur oficerit.

— Shoku zëvendëskomandant, ç'të falur t'i kërkoj unë atij? Se mos i kam bërë gjë? Fundja ca sedër e kam edhe unë.

Nikos i kishin kërcyer nervat, po nuk foli. Zëvendëskomandanti bisedoi shumë atë ditë me të. Por akoma nuk pranoi t'i kërkonte të falur oficerit.

Bisedova pastaj dhe unë me të, por ishte e pamundur të hiqte dorë nga teka e tij.

Mua më vinte plasje më tepër nga që e kisha pasur në patronazh gjithnjë dhe kisha kërkuar ta kisha pranë gjatë gjithë kohës, duke pasur besim se ai njjeri do të bënte kthesë. Sikur të merrte vesh shefi i shtabit të shkollës, do të më thoshte:

— Ama po e ndihmon shumë Nikon! S'pate aq forcë sa të mos e lije të gabonte. Kështu ai do të kalonte edhe pa ty.

E kapa edhe një herë Nikon për krahu dhe dolëm jashtë anijes në bankinë.

— Lere këtë kokëfortësi, Niko, të lutem! Si ka mundësi të vësh tekat e tua mbi idealin e madh të partisë e të atdheut? Unë prisja kur do të të plotësonim dokumentat për në organizatën e rinisë, kurse ti më bën të tilla marrëzira. Nuk është vend për teka këtu. Mendo për detyrën që kryejmë.

— Ashtu si ka teka për atë ka edhe për mua! — tha Nikua.

— Ai nuk ka teka. Kryen detyrën.

— Në djall të vesh dhe ti! — më bërtiti Nikua në kulnun e zemërimit. — Unë s'pyes pér asgjë.

— O në djall o në lumë të dy bashkë do të shkojmë!

Ai më shikoi vëngër.

— Ti nuk e di që kam kërkuar nga shefi i kuadrit të jem gjithnjë me ty dhe ai ma ka përm bushur dëshirën. Ndaj unë nuk ndahem nga ti.

— Ashtu na qenka puna?!

Ai uli sytë dhe nuk foli më.

Në mbrëmje erdhi komandanti në anije, se gjatë ditës kish qenë diku me shërbim. Unë i shkova fill në kajutën e tij. I tregova krejt çështjen siç ishte, duke ja përshkruar ngjarjet që nga shkolla, i tregova edhe pér kërkësen që kisha bërë pér të ardhur në atë ekuipazh e të gjitha me radhë. Më në fund, si u mendua ca, më tha buzagaz:

— Mos u bëj merak. Do ta rregullojmë punën. Nikua do të bëhet një detar i mirë, do të bëhet një ushtar i denjë i partisë. Do të bisedoj edhe unë me të ndonjëherë dhe qëllimi yt i mirë ka pér t'u arritur. Po më vjen mirë që interesohesh kaq shumë pér shokun:

— Dua që të mos na ulen pikat si nënrepart shembullor, shoku komandant. Nuk duhet ta pësojë ekuipazhi pér një njeri.

— Aha, pikat do të humbasin medoemos. Nikua është anëtar i këtij ekuipazhi, prandaj thyerja e disiplinës nga ai i ul pikët medoemos sikur edhe të mos ndëshkohet. Por kjo nuk është kryesorja. Ne duhet ta ndihmojmë të bëjë kthesë. Do të punojmë më shumë unë dhe ti.

## 12

Nikos i pat shkrepur në kokë të largohej nga anija me çdo kusht, prandaj shkonte herë pas here në vizitë te mjekët dhe kërkonte nga ata që të ndërhynin pranë komandës pér këtë çështje.

— Unë nuk mund të qëndroj në det! — u çirrej mjekëve. Ju lutem më shpëtoni nga kjo gjendje. Shëndeti im do të shkatërrohet.

Mjekët i thoshin se do të mësohej, se ish në rregull me organizmin dhe se kjo gjendje do të zgjaste shumë pak. Po Nikua ngulte këmbë në të tijën. Atëherë mjekët e dërguan në komisionin mediko-legal, i cili e nxori krejt të aftë për të kryer detyrën në det. Tani s'dinte nga t'ja mbante. Në anije e thyente pak disiplinën. Kish nisur të ndryshonte. Komandantit të anijes, Luftar Bibës, nuk i kundërshtonte kurrë.

— Këtij nuk ja kthej dot fjalën — thoshte. — Më imponon respekt. Ky e ka treguar veten bile. Por ama, kur të flasin disa të tjerë, plasja të vjen.

— Edhe ata të tjerët do ta tregonin veten, po t'u qëllonte rasti — i thosha unë Nikos.

— Lëre aman, mos më bën të flas shumë! — më bërtiste.

Fjalën kishte nisur të ma dëgjonte më shumë Nikua. Sidomos kur mori vesh që unë kisha kërkuar të isha pranë tij gjithnjë, që prekur shumë.

Një natë u bë një mbledhje e madhe e ekuipazhit, mbledhje e lirë e nënrepartit, siç i thonë në gjuhën ushtarake. Komandanti nuk foli shumë.

— Do t'ju pyesim ju, shokë të ekuipazhit, ka apo s'ka të drejtë Niko Gjoshi të mbajë atë qëndrim që nban? Ka arësyte të vazhdojë rrugën e tij të arrogancës, rrugën e shthurjes disiplinore?

— Me leje, shokë të presidiumit! — u hodh Bektashi.

— Folë, Bektash.

— Shoku Niko është shpirti i mohimit — tha ai. — Jemi mbledhur një ekuipazh i tërë për thyerjet e disiplinës të shokut Niko, kurse ky të gjitha i quan «gjëra të vogla». Kështu i ka quajtur vazhdimi. Ky habitet duke menduar se jemi shqetësuar «për hiçgjë». Mua më duket se na e ka sjellur te hunda. Të mos zbatosh orarin e veprimeve, të pish duhan në postin luftarak, të zihesh me oficerët, të grindesh me shokët, të shtiresh si i sëmurë, të duken pak këto gjëra, shoku Niko? T'i lemë këto për një moment, po ky vazhdon akoma dhe avazin e vjetër me muzikën. Merr kitarën e çirret e përdridhet si i çakërdisur. Dhe krenohet me këto pa le. Ç'domethënë

kjo? Unë e kam këshilluar disa herë edhe vetëm për vëtëm, po këndejej i hyn, këndejej i del.

— Shumë rëndë po i bie kontrabasit, shoku Bek-tash! — u hodh Nikua.

— Mos e ndërpren! — tha zëvendëskomandant Llu-kani. — Folë kur të të vijë radha.

— Edhe unë merrem me muzikë. Por gjithnjë kë-naqësinë e kam gjetur në muzikën tonë, në artin tonë të shëndoshë. Mendoj që këtij njeriu s'i duhet bërë më asnje lëshim. Kur nuk erdhi në vete me kaq kohë që ka në ushtri, nuk di kur do të vijë. Prandaj mendoj që ndaj këtij njeriu të merren masa më të rënda.

Oh, sa të rënda më erdhën këto fjalët e fundit! Po q'mund të bëja? A mund ta mbroja Nikon? Bile edhe unë, kur të ngrihesha, do ta kritikoja ashpër.

— Bektashi ka të drejtë — tha njeri nga fundi i sallës, po sikur e tepëroi një çikë. Ka disa kohë që shumë rrallë e kam dëgjuar Nikon të këndoje e të marrë nga ato pjesët me kitarë, siç tha Bektashi. Bile një ditë Nikua më foli me pasion për këngët tona të reja.

— Shumë keq po flet ti — u hodh një detar i vjetër. — Nikua s'duhet të këndoje fare nga ato marrë-zirat e perëndimit. Kemi muzikën tonë dhe e kemi shumë të mirë. Më falni, se s'mora lejë, po u revoltova nga kjo kritikë e sheqerosur. Domethënë, në qoftë se ky këndoka rrallë, duhet ta përkëdhelim. Meqë u ngri-ta, a do më lejoni t'ju tregoj diçka?

— Folë, folë! oshëtiu salla.

— Kur isha në maturë, klasa jonë organizoi një takim me një kompozitor, se me cilin, s'më kujtohet. Ai na citoi fjalët e një kompozitori italian, që kish vizituar vendin tonë. «Ju keni dëgjuar muzikë italiane, po ajo s'është më italiane. Ajo është gllabëruar nga muzika e shfrenuar amerikane. Është çoroditur fare. Kurse ju po ecni në rrugë të mbarë. Muzika juaj është krejt juaja. Ajo është si një nuse e re që stoliset për ditë e më bukur. Vazhdoni kështu.»

— Bukur e paska thënë. Ashtu është. — u dëgjuan zëra në sallë.

Nikon s'e zinte vendi dhe më të rrallë, hidhte sytë nga presidumi.

— Mjaft t'i kemi mbuluar të metat! — tha një tjetër nga fundi i kubrikut. — Ne jemi përgjegjës, që nuk t'i kemi futur të dy këmbët në një këpucë. Ç'u bëre ti që të na qëndrosh kështu me kryeneçësi? Ne e dimë që ti nuk je armik, por je infektuar nga ata që i shërbijnë punës së armikut. Dhe ky infektim të ka hyrë aq thellë në shpirt sa edhe tani, që do të shkundesh, ndjen një farë nostalgie, që s'të le të shkëputesh menjëherë. Të ngrihesh e të bësh autokritikë dhe jo vetëm me gojë, siç ke bërë herët e tjera, por me punë dhe sa më shpejt. Ne s'durojmë më njolla të zeza në kolektivin tonë luftarak.

Folën shumë detarë. Fola edhe unë.

— Jam i një mendje me shokët që kjo mbledhje të jetë paralajmërimi i fundit për Nikon — thashë. — Qortimet s'kanë vend më. Ky shok është bërë barrë e rëndë në shpinën e kolektivit.

— Edhe ti, Çlirim, po flet kështu?! — tha Nikua i habitur.

— Më duket se të kam folur edhe veçan, apo jo?

Nikua uli kokën, nxori shaminë dhe fshiu ballin.

— Tani mendoj që të na flasë vetë Nikua — tha komandanti.

Nikua u ngrit në këmbë. Të gjithë drejtuan sytë nga ai.

— Unë... unë... jam fajtor..., — buzët i dridheshin, qerpiqët i lëviznin pa pushim. — Por... unë... — sytë iu mbushën me lot.

Atëhere komandanti tha:

— Ulu, Niko! Qetësohu! E kuptojmë. S'ka nevojë. Nikua u ul me ngadalë, nxori shaminë dhe fshiu djersët dhe lotët.

Kur u ktheva nga shtëpia ku kisha qenë me lejë, pashë se kish ardhur biga lundruese për të vendosur

gjeneratorin dizel që e kishim dërguar për riparim në uzinë. Kishin ardhur edhe disa specialistë të tjerë dhe po kontrollonin gjendjen e maqinerive në përgjithësi.

Mbasi u vendos motori, u ndez\* dhe i dha korrent anijes. Tani ky motor do të përdorej gjithnjë për korrënt në anije.

Remonti i pjesshëm i anijes mbaroi.

Atë ditë që mbaroi remonti i anijes, organizuam një mbledhje të hapur të organizatës së rinisë. Merrte pjesë edhe Nikua. Merrnin pjesë gjithashtu edhe shokët e partisë, kuadri komandues dhe aparati politik. Në këtë mbledhje shtroheshin detyrat për veprimtarinë e ekuipazhit mbas remontit. Të gjithë të rinxjtë folën dhe kritikuani të metat e njeri-tjetrit e morën zotime për plotisimin e detyrave.

— Po ti, Niko, ç'na thua? — e pyeti atë zëvendësisi për punën politike.

— Unë nuk jam anëtar i Bashkimit të Rinisë.

— A, mos e thuaj atë! — i tha komandanti i anijes.

— Je anëtar i kolektivit dhe besoj se do të bëhenet dëshironi i organizatës, po hajde, folë!

— Për punët në det s'merren dot angazhime, se po të të zérë deti, rrinë të tëra në një anë pastaj.

— Kjo s'është fjalë... Mirë, po sikur të mos të të zérë deti, ç'do të bësh me detyrën?

— Atëherë do të mudohesha ta mbaja në gadishmëri postin luftarak me sa të më bënin fuqitë.

— Vullnetin e ke?

— Si urdhëron, shoku komandant!

— Këtu jemi në mbledhje organizate, prandaj mos më thirrni komandant. Shoku Luftar, më thuaj.

— Nuk ju thërras dot me emër — tha Nikua sin-  
qerisht.

Të tjerët qeshën. Qeshi edhe komandanti një herë, pastaj u ngrit në këmbë dhe foli:

— Ju e dini, shokë detarë, se në ç'kondita punon efektivi i flotës sonë për të realizuar programin e stërvitjes. Blokadat revisioniste krijuan vështirësi për të gjithë punën ndërtimtare të popullit tonë, po për flo-  
tën qenë pengesë e madhe.

Ai foli gjerë e gjatë mbi tradhëtinë e Hrushovit dhe këlyshëve të tij, foli për punën sabotuese të specia-listëve sovjetikë në flotë, si e lanë flotën dhe për qëllimet e tyre të fundit. «Por revizionistët i mban edhe një shpresë — tha. Mendojnë se do të falimentojmë, kur teknika jonë të ketë nevojë për riparim. Ata janë të bindur, se ne e kemi mësuar mekanikisht drejtimin e anijeve, dhe janë të bindur gjithashu se s'do të bëhem kurrë teknikë asinxhinerë. Prandaj, duhet ta mbysim edhe këtë shpresë të fundit të revizionistëve sovjetikë...»

Komandanti foli shumë atë natë.

Ditët që kaluan sillnin secila diçka interesante. U mësova kaqë shumë me jetën e anijes, sa nuk kisha dëshirë të ndahesha asnjë minutë nga ajo. Funksionimin e postit tim luftarak e kisha mësuar mirë dhe isha i bindur që çdo detyrë do ta kryeja me sukses. Mirëpo komandanti im i postit më thoshte:

— Praktika do ta vërtetojë sa i aftë do të jesh për teknikën luftarake.

Nikoja kish filluar të ndryshonte. Tani nuk mendonte më për t'u larguar nga anija, po për misionin e tij si ushtar i atdheut dhe i partisë. Me detyrën e tij si elektriçist kalonte mirë. Profesionin e kish përvetësuar. Ish bërë një ndër elektriçistët më të mirë. Këtë e kish me pasion.

Kjo kthesë që po ndodhë në ndërgjegjen e Nikos më entuziasmonte, bënte që t'i kryeja detyrat akoma më me qejf.

Erdhi dita që shoku im u çmobilizua. Posti luftarak më mbeti mua. Tani isha i shqetësuar, po zëvendëskomandanti më jepte zemër.

— Po të kesh nevojë — më thoshte — do të të ndihmoj unë, mos u bëj merak, vetëm mos u kurse në punë.

Vjeshta po kalonte. Ditët e fundit të saj qenë tërë vranësira e bubullima. Rrallëherë kish rënë aq shi. Gazetat e radiot njoftonin dëmet që bënte shiu nëpër botë dhe në vendin tonë.

Një ditë na erdhi një radiogram nga komanda e flotës, ku thuhej se në një fshat po bëheshin përmbytje, prandaj urdhërohej ekuipazhi i anijes sonë t'i vente në ndihmë. Të vihesin të gjitha lanxhat e motolonxhat në dispozicion të fshatit, të shkonte gjysma e efektivit të anijes atje. Unë kisha qenë me shërbim atë natë dhe isha i lodhur shumë (Bënim shërbim në një objekt jashtë anijes vetëm natën). S'dija se ç'do të ishte atje, po përderisa ishte diçka e re, kisha qejf të shkoja.

- Dua të shkoj edhe unë — i them oficer Agimit.
- Po ti ke qenë me shërbim mbrëmë.
- S'ka gjë, kam dëshirë të vete!
- E po mirë se të vish!

Na shoqëruan komandanti, bocmani, shefi i organizt Luftarak «pesë» (kryemotoristi) dhe zevendëskomandant Llukani. Unë isha në lanxhë me komandantin. Atje ishte dhe Nikua.

--Nuk do ta kemi aq lehtë, djema! — na tha. — Eshtë punë e vështirë, por duhet t'i dalim mbanë. Moti sot nuk eshtë dhe aqë i keq. Shi bie, po era do të na sillte telashe, po të frynte.

Për të shkuar në fshat, hymë nëpër lumë. Fshati të cilit i shkuam në ndihmë, ishte katandisur si mos më keq. Uji kishte hipur gjer në katin e dytë të shtëpisë. Vijonte të binte shi. Ne ishim të veshur me rrobat e lundrimt dhe s'mund të na hynte shiu në shtat, por në punën tonë na sillte telashe.

Kur na vunë re fëmijët e fshatarëve, të mbledhur te një kodër, thirrën.

— Ushtria! Ushtria!

Këta fëmijë ishin fare pak. Pjesa e madhe ishin nëpër shtëpi në një gjendje rreziku. Duhej të nxitonim për t'i shpëtuar.

Disa fshatarë ishin përhapur kush me ndonjë sandalle të vjetër, kush me ndonjë trap, të ndërtuar dosido dhe përpinqeshin të luftonin me ujin.

Kur zbritëm, na priti sekretari i partisë dhe kryetari i këshillit popullor të fshatit. Ata kishin qenë të trishtuar, po tanë fytyrat e tyre u çelën. Ata u bindën që me ardhjen e detarëve do të shpëtonte fshati. Disa fshatarë u grumbulluan para nesh. Ata dukej se kishin hall të madh, por u vinte zor të ankoheshin. Komandanti e hetoi shpejt gjendjen e tyre.

— Do të bëjmë ç'është e mundur, vëllezër. Mos u bëni merak.

— Jau paçim borxh, o shoku komandant! — tha një plak. — A po vini të pimë nga një gotë, o burra?

— Jo, xhaxha, tanë kemi punë — tha komandanti. Filluam nga puna. Më së pari filluam të nxirrinim njerëzit me motolanxha dhe lanxha pa motor. Ishin edhe dy-tre sandalle të këqia që kishin prurë fshatarët me të cilat përpinqeshin diç të bënin. Në një motolanxhë ishin komandanti, një detar tjetër i vjetër, Nikoja dhe unë. Ata shkuam në një shtëpi që kish brënda dy gra, tre fëmijë dhe një plak. I futëm në lanxhë ata dhe disa tesha të tyre që kishin mundur t'i vinin nëpër trarë (shtëpia ishte njëkatshe). I morëm dhe i nisëm pér në kodër. Kur shkuam në gjysmë të rrugës, u dëgjuva një kujë e madhe nga një shtëpi tjetër. Komandanti i dha tërë shpejtësinë motolanxhës.

— Atje janë në rrezik! — tha ai.

— Do t'u jetë mbytur njeri! — tha njëra nga grata dhe gau me dënesë.

I shkarkuam këto të qullura nga shiu dhe nxituam te ajo shtëpia. Familja përbëhej nga nëntë veta. Kur kishin hipur në trarët e shtëpisë, një fëmijë tre vjeç kish rrëshqitur andej dhe ish fundosur në ujë. Mirëpo ata të rriturit s'kishin qenë të fortë në not dhe mezi e kishin nxjerrë; fëmija ish në prak të vdekjes.

— C'kemi hequr! Na ka ardhë uji në befasi! — tha njeri nga burrat. — Kur kam pa se hynte uji brenda, u munduam të hipin te trarët... Mor burra, kjo s'na ka bërë vaki kurrë... Unë jam bërë pesëdhjetë vjeç dhe kështu s'mbaj mend...

Fëmijët bërtisin. Disa nga ata kishin frikë të hy-

nin në motolanxhë. I shpëtuam dhe ata. Shiu binte gjithnjë më i fortë, por me ndërprerje. Po frynte dhe nga pak erë.

Motolanxha e lanxhat e tjera vazhdonin punën e tyre me shpejtësi. Lanxha, në të cilën ishte bocmani, pësoi një aksident. Kishin ngarkuar në të tetë veta, por ata s'kishin ditur të qëndronin në lanxhë; nga frika e nga të shtyrat kishin arritur të përmbyssnin fare lanxhën. Kishin ngelur vetëm detarët dhe një fshatar pa u rrëzuar. Bocmani na sinjalizoi për këtë aksident. Sapo shkarkuam ato që kishim në motolanxhë, shkuam në ndihmë të bocmanit. Detarët zhyteshin me not dhe nxirrin ata që përpëliteshin për vdekje. Atëhere u sulëm dhe ne në zhytje. Kur hoqa rrobat e lundrimit dhe u hodha në ujë, m'u ngjeth mishi. Uji ishte i ftohtë. Ishim në prak të dimrit. Më ra rasti të nxirrja nga uji një nuse të re.

Mirëpo nusja kishte qenë peshë e rëndë. Në përpëltje e sipër, duke u munduar të shpëtonte në mënyrë të pavetëdijshme, më kapi për flokësh, që, për dreq, asaj here më ishin rritur mjaft, m'u lidh për koke dhe mundi të më fundosë brenda. Duart e saj nuk më shqiteshin, si të ishin darë hekuri. Mblodha të gjitha fuqitë dhe e nposhta fuqinë e saj, e ngrita pezull dhe kërkova ndihmë nga shokët. Në çast pashë Nikon që e kapi nusen për njërin krah dhe na tërhoqi afér lanxhës. Me shumë vështirësi mundëm ta hipnim në motolanxhë. Ajo ishte gjysmë e zalisur. E vumë me kokë poshtë që të nxirrte ujin që kish pirë. Përfundimisht të gjithë shpëtuan.

Kur i shkarkuam, unë vesha rrobat e lundrimit. Tani kisha filluar të ndjeja shumë të ftohtë. Nisa të dridhem, por për punë isha gjithnjë i zoti. Si hoqëm ato familje që ishin në shtëpitë njëkatëshe, puna na u lehtësua, po telash i madh na doli me bagëtinë. Dhëntë dhe lopët vërtet notonin dhe i shpëtonin mbytjes hëpërhë, po s'dinin të drejtoheshin për të dalë në ndonjë vend të pambytur. Lodhjen më të madhe e pësuam nga ato. Fuqia po më linte. Më kish kapitur dhe uria. Ne s'kishim ngrënë as në mëngjez. Kishim ardhur menjëherë apo

ishte dhënë alarmi. Mbasdreke vonë një fshatar më tha:  
— Tashti, shokë marinarë, punën e kryet. Ka mbetur ndonjë punë që pret edhe pak. Prandaj hajdeni të shkojmë e të hamë bukë në shtëpinë time — dhe, si qeshi një herë, shtoi: — Unë kam shpëtar pa u mbytur se e kamë shtëpinë kullë.

— Duhet të mbarojmë punën! — tha komandanti. Por fshatari, së bashku me kryetarin e këshiliit, nguli këmbë që ne të hanim bukë. Dhe ashtu bëmë.

Fshatari kishte një shtëpi të mirë, sidomos dhomën e pritjes. Kishte mbushur oxhakun me dru dhe, veç kësaj, kishte ndezur edhe një stufë të madhe. Dhoma ishte e nxehëtë. Na shtruan rakinë, po komandanti kundërshtoi.

— Ju falem nderit, po për këtë s'na del as koha. Po hamë bukë dhe dalim të vazhdojmë punën.

— Pa pirë raki s'mund të vazhdojmë më. Do të mërdhini.

— Nuk mundemi se po erret. Ju falënderojmë! Duhet të mbarojmë patjetër gjer në ora pesë!

Por, kur ngul këmbë i zoti i shtëpisë,është e pamundur të kundërshtosh. Komandanti na tha:

— Pijeni nga një gotë!

## 15

Dezhurni mekanik më zgjoi qysh në orën katër për të lëshuar busullën xhiroskopike. U ngrita me një entuziazëm të madh dhe bëra preqatitjet. Kur hapa çelësin e korrentit, u dëgjuan ca zhurma të ngatërruara si zérat e shpendëve të trembur, pastaj ato zëra u bashkuan në një melodi të vetme. Nikua u zgjua:

— C'djall bën? Zien groshë?

— Fli, fli, se po të pregatis një racion fasule përmengjes.

— Ah, muço, sa groshë do të ziesh këtu ti!

— Mjaft, mor Niko, se do të flemël — ja priti shoku që flinte mbi të.

— Rri, or gjumash, se ke fjetur boll! — i tha atij me të qeshur dhe përsëri m'u kthye mua: — S'ka këtu të dalësh në qytet e vrap mbas vajzave.

— Pa të keqën tënde! — ja prita unë.

— Sikur të bënim edhe mbrëmjen e vitit të ri këtu. Do të na ftonte kolektivi i kantierit detar dhe do të vallëzonim.

— Ti po, po unë s'kam vend aty ende.

— Do të ta kisha siguruar shpejt vendin, qerrata!

Nikua kish një vajzë të njojur në kantier. Kurse unë njihesha me ato vajzat vetëm pér fytyrë.

Mbasi mbaruam së ngrëni mëngjezin, në orën shtatë e gjysmë u dha sinjali me anë të translacionit.

— Anijen pér luftë e lundrim prebat!

Si prebatita gjithë ç'kisha sipas rolit luftarak, i raportova me anë të tubit bisedues zëvendëskomandantit.

— Shoku zëvendëskomandant, posti luftarak katër gati pér luftë e lundrim!

— Po, xhirobusulla a ka ardhur në meridian? — pyjeti oficer Agimi.

— Si urdhëron, shoku oficer, ka ardhur!

— Pse s'raporton atëherë?

— Kam harruar fare... shoku oficer, po ja tani sa erdha.

— Por këtu s'lejohet harrimi. Oficeri dukej i nevrikosur si askurrë.

Dola në kuvertë. Koha ishte e mirë, po pér mua s'vlente. Jashtë portit kërcënöheshin kreshtat e dallgëve që përplaseshin mbi bloqet e betonit. Kushedi ç'do të më priste mua atje.

Mbas pak u dha sinjali me anë të zileve elektrike që të çankoroheshim nga porti. U dha komanda me al-toparlant:

— Nëpër vende qëndroni nga bankina pér t'u çakostuar!

Detarët e kuvertës hoqën cimat dhe kavot nga kalunat e portit dhe anija u bë gati pér të dalë. Lëvizje të vrullshme të helikave nxorën një duf shkumë të bardhë

dhe anija u largua nga bankina. Pastaj arganoja e bashit filloj mbledhjen e gadinës së spirancës dhe, dalëngadalë, spiranca e ngjer në ujë e baltë të bardhë u mbështet në bash të anijes. Kur morëm drejtimin për të dalë në det, pamë se nga bregu po na përshëndesnin punonjësit e kantierit. Nikua donte të dilte e të shihet, po ishte në postin e tij dhe s'lëvizte dot.

Kur dolëm jashtë portit, filluan hallet. Sado që anija ishte e madhe, dallgët e luhatnin si një gogël. Menjëherë më ra në kokë dhe nisi të më përzihet. Në çast vërvëlluar bilbili i tubit bisedues. E hapa dhe u përgjegja:

- Ju dëgjon posti luftarak katër!
- Lëshoje shpejtësimatësin!

Edhe kjo më duhej. Kur të hyja në lokalini e atij aparati do të më dilnin zorrët. Dhe ashtu e pësova. Duke rrrotulluar dorezën e salkometrit, fillova të vjell.

Mora një batanie, e shtrova pranë xhirobussullës dhe u shtriva si i vdekur. Ndërkaq ra sirena e pompës. Duke u zvarrisur, shtova shpejtësinë e ujit. Sapo rashë për së dyti, u dëgjua vërvëllima e ethshme e bilbilit. Para se të hapja tubin, lëshova dhe një shkul vrer, që më bëri gojën helm. Thashë me një zë të gjerrë:

- Ju dëgjon posti luftarak katër!
- Pse s'punon selkametri? — dëgjova pyetjen.
- Ku ta di unë? E kam lëshuar në ujë.
- Gjeje, gjeje, si është puna, se jemi batall!

Kontrolloje një herë!

- S'lëviz dot se më ka zënë keq deti!
- Qëndro sa të mundesh!

Atëherë m'u kujtua se kisha lënë myllur çelësin e treguesit. Dola në kabinën e shturmanit dhe e hapa.

- Ç'ke kështu? — më pyeti oficer Agimi.
- Mbarova! Po më dalin zorrët!

E, pra, kam katër-pesë vjet në det. Shko e shtrihu, se do të lehtësohesh.

- Ç'të shtrihem!

Duke u ulur poshtë te posti im, pashë se me të

vërtetë deti po zinte shumë detarë, por ata ishin të rinj.

Shkova dhe u shtriva përsëri. Nuk vonoi të më zinte gjumi. Si në ëndërr dëgjova trokitjen e derës. U ngrita dhe e hapa. Ishte komandanti i anijes, Luftari. Më vështroi një herë në fytyrë dhe tha:

— Të paska munduar deti... Është shumë i vështirë në fillim. Kështu kemi vuajtur të gjithë. Sa kam hequr derisa u mësova! Unë isha marinatë një anije druri. Si lëkundëj ajo në kësot dallgësh! Jeta është një betejë e gjithanshme.

Komandanti u largua dhe unë u shtriva siç isha më parë. Gjeta pak rehati dhe më shkoi mendja te fjalët që më tha më parë kapiteni «i kam provuar të gjitha». Ai i kish provuar me të vërtetë të gjitha. Edhe luftën e kish provuar. Nuk kish qenë në Luftën nacionalçlirimtare, por kish kryer një heroizëm që e radhiste me heronjtë e luftës. Ai nuk fliste për trimërinë e tij. Vetëm kur ja vinte detyrë organizata e partisë për të bërë bisedë me detarët, e tregonte atë ngjarje. Por i binte shkurt. Unë kujtoja atje shtrirë takimin që kisha pasur me komandantin kur kishim qënë në shkollë dhe ngjarjen që na pat treguar. Ai kishte shpëtuar një motovedetë dhe kishte vrarë tre tradhëtarë.

... Besas u duk për së dyti komandanti te dera e kabinës së postit luftarak, ku isha shtrirë në batanie. Ai buzëqeshi ca dhe më pyeti me shaka:

— E përbysse detin, apo jo?!

Unë u ngrita në këmbë gjithnjë duke u mbajtur se mos rrëzohesha, ndërsa ai m'u afroa.

— Më përbysni ky mua, shoku komendant.

— Jo, jo s'të ka përbysur. E shikoj që e ke vënë nën vete. Mos e thuaj atë.

— Jam trullo sur fare, shoku komendant! Nuk di ç'po bëhet me mua...

— Mos u jep!... Posti luftarak në rregull, ë?

— S'kam hetuar ndonjë difekt.

— Qëndro, se arritëm gadi — më dha zemër dhe kaloi përjashta.

Mbas pak vërvhëlleu bilbili i tubit bisedues. Unë i vura veshin dhe dëgjova urdhërin:

— Nxirre salkometrin nga uji!

Dhe në këto çaste zilet dhanë sinjalin e pregetitjes së anijes për akostim. U dëgjua nga altoparlanti:

— Nëpër vende qëndroni në bankinën luftarake numër dy për t'u akostuar!

Nxora salkometrin nga uji dhe dola mbi kuvertë. Pashë se kishim hyrën në portin ushtarak dhe po afro-heshim për t'u ankoruar në bordin e anijve të grupit tonë. Në borde të anijve dhe në bankinë kishin dalë detarët dhe po na përshëndesnin. Që nga larg dallova nën-reparti pregetitej për festën e vitit të ri.

Ishim duke ngrënë drekën, kur më kërkoi nënoficeri dezhurn i anijes.

— Mbasit të hash, ke për të shkuar te përgjegjësi i klubit të kulturës, se të kanë kërkuar, por shpejt, ama — më tha.

— Po përse, thua, më kanë kërkuar?

— Estrada e repartit ka për të dhënë një shfaqje nesër mbas dreke e mbase do të të fusin edhe ty. Kanë kërkuar edhe Nikon.

16

Kubriku ish pregetitur tamam për festë. Tryezat ishin mbushur me ushqime, émbëlsira, konjak. Atë natë komandanti kish lejuar të pihej në anije konjak, se herët e tjera pijet alkoolike ishin rreptësisht të ndaluara atje.

Gjithë ekuipazhi, me përjashtim të atyre që kishin shërbimin, ishin mbledhur rrëth tryezave e prisnin të vinte komandanti. Altoparlantet përhapnin nëpër kubrik tingujt e një valleje popullore. U duk dhe komandanti te dera. U ngritëm në këmbë të gjithë. Ai zuri vend në tryezën e tij. Ne prisnim të fliste diçka, po fjalën. e mori zëvendëskomandant Llukani, zëvendësi për punë politike në anije. Nuk e pat mbaruar frazën e parë, kur u dëgjua ulurima e sirenës së repartit. Ne heshtëm.

Mbajtëm vesh se ç'do të ish. Duhej të binte tri herë nga tridhjetë sekonda për alarm luftarak. Kur filloi të tretën herë, buçitën dhe sirenat e zilet e anijes të gjitha njëherësh. Pa vënë re se ç'bëhej me ushqimet nëpër tryeza, u shpërndamë nëpër postet luftarake.

Mbës dy-tre minutash u dëgjuan raportimet:

— Posti luftarak pesë, gati për luftë!

— Posti luftarak njëmbëdhjetë, gati për luftë!

— Posti luftarak katër, gati për luftë! — raportova dhe unë. E kështu me radhë derisa mbaruan të gjithë postet luftarake. Nga komanda eprore u dha urdhëri që të dilnin të gjitha anijet në detin e hapur. Më kaluan nëpër mendje të gjitha planet që kishim pasur për atë natë dhe të nesërmëni.

«T'i marrë dreqi shkaktarët!» thashë me një valë zemërimi.

Anjen e kishin errësuar gjithkah sipas rregullit. Duke kaluar nëpër shkallët e urës së komandimit me kundërgazin në krahë, më rrëshqiti këmba dhe u përplasa në kuvertën e hekurt. Shokët më panë dhe më kapën shpejt. Pësova një tronditje aq të rëndë, sa m'u duk sikur do më binte zali. Po e mora veten shpejt.

— Nuk kam gjë! — u thashë shokëve.

— Mos u rrëmbe, mor Çlirim! — më tha Nikua. — Të kryhen veprimet shpejt, po jo me gjaknxehtësi. Nikua më përçolli gjer te posti luftarak. Vajta fare në rregull, po isha i nevrikosur dhe i mërzitur.

— Dreqi ta hajë këtë punë! — shfreva unë, pa ditur se kë po mallëkoja.

— Qetësohu, Çlirim!.. Ke ndonjë gjë pa pregetitur në postin luftarak, të të ndihmoj?

— Jo, në rregull i kam! Të falem nderit shumë!

Sado nevrik të isha, përzemërsia e tjeterit më bënte të arësyetoja.

Ndërkohë dolëm jashtë portit. Na njoftuan se ujërat tona teritoriale ishin shkelur nga një anije e huaj, po se ç'ish ajo, s'dihej. Anija e dozorit kish raportuar se kish dëgjuar një zhurmë nëndetëseje me anë të aparatit të hidroakustikës, por ja kish humbur gjurmët. Nga

ana tjetër pikësinjalvroatuese kish diktuar në det një farë objekti të vogël që ish fshehur në ujë. Se çfarë do të ishte konkretisht, nuk dihej.

— Shumë herë — më tha kuzhinieri — ndodhin dhe keqkuptime dhe dyshime e ne sillemi ndofta me net të téra, pastaj del se s'kish qënë gjë. Ndodh edhe e kundërtat. Po sido që të jetë, ne jemi të destinuar vetëm pér këto gjëra.

Më dukej çudi sa me gjakftohtësi fliste kuzhinieri. Mua kjo ngjarje më dukej e jashtëzakonshme.

— Nuk ke frikë? — e pyeta kuzhinierin.

— Pse, ore, të kem frikë? Edhe po të jetë gjë e rrezikshme, fundja një herë do të vdesim. Frikë, thotë! U regja me këto gjëra tash tre vjet. Në luftë unë s'merrim vetëm me gjellën. Jam numëruesh topi. Në kuvertë, atje! Le që, po të vijë rreziku, eshtë njëlloj kudo. Luftë do të bësh edhe nga kuzhina me pushkë. Pse eshtë armatura atje?

Kuzhinieri fliste dhe buzëqeshte si pa gjë të keq. Anija vazhdonte lundrimin simbas drejtimit që kishte caktuar komanda e grupit. Lëkundjet e tallazeve ishin shumë të lehta. Nuk ish keq të lundroje në atë det. Mua s'po më zinte fare kësaj here. I bëra një kontroll gjithë postit luftarak dhe shikova në funksiononte qdo gjë në rregull. Pastaj u ula pranë busullës xhiroskopike dhe shikoja se si ngrihej temperatura e solucionit të xhirosferës e pasqyruar në termometër. Mendoza. Përfytyroja ngjarje të ndryshme që mund të ndodhnin atë natë me anijen e huaj. Aty-këtu këto skena më përzireshin, më dilte fytyra e babait, fytyra e nënës, e motrës, e gjithë pjesëtarëve të familjes.

Ku ishim duke shkuar? Ndoshta në luftë! Ne s'na ndante gjë nga lufta. Më afër kishim lustën se këmishën që kishim veshur. Kuzhinieri tha: «Një herë do të vdesim!» Ta kapim të gjallë armikun pa na dëmtuar.

Ndërkaq, anija u vu me të gjithë forcën përpara. Punën e madhe në këto çaste e kishin sinjalistët, radiostët, radiolokatorët, mbasi mendohej që anija e panjohur të ishte nëndetëse.

Komandanti i anijes me oficer Agimin, zëvendës-komandant Llukanin dhe shefat e organeve luftarake rrinin në urën e komandimit dhe shkëmbenin mendime në lidhje me gjendjen. Oficer Agimi herë pas here hynte në kabinën e shturmanit (ai kryente njëkohësisht edhe detyrën e shturmanit), bënte shënimet e duhura në ditarin e lundrimit dhe hiqte vija me laps nibi harten detare me ndihmën e rigës e të raportorit, pastaj deshifronte radiogramet që vinin.

Ndërkaq erdhë lajmi i saktë se anija armike ishte pikërisht nëndetëse, por ishte i një tipi shumë të përsosur, që s'ish parë ndonjëherë në ujërat tona territoriale. E kishin diktuar një herë nëndetëset tona dhe përsëri u kish humbur.

— Do ta kemi vështirë ta kapim — tha komandanti. — Është vështirë ta hetojë dhe hidroakustika. Do të jetë nga ato nëndetëse që lundrojnë në afërsi të fundit të detit.

— Sidoqoftë bën zhurmë — kundërshtoi zëvendës-komandant Llukani.

— Eshtë shumë e dobët zhurma që mund të bëjë ajo aq poshtë. Çdo mekanizëm atje punon me bateri. As helika s'prodhon ndonjë zhurmë.

— Po do të dalë në sipërfaqe patjetër për të nxjerrë periskopin. Ndryshe çfarë misioni mund të kryejë ajo në thellësi të detit? — tha Llukani.

— Del ajo. Gjen rastin e s'e le pa dalë.

— Mor, pa rënë në kurth s'rri atëherë, sikur me magji të punojë. S'ka nga të shkojë.

— Në kurth do të bjerë patjetër, por mund të na vonojë pa hesap. Mund të rrimë ditë të tëra duke ardhur vërdallë nëpër det — tha komandanti.

Mbas pak u dha urdhër të zinim një vend (koordinatë) të caktuar dhe të qëndronim atje në përgjim.

Si zumë koordinatën e dhënë, komandanti dha urdhër të haqej darka me ndërresa. Një ndërrresë qëndronte në shërbim, të tjerat hanin dhe anasjelltas. Gadishmëri luftarake numër dy. Çfarë antiteze brenda dy orëve! Hanim ushqimet pa u ndjerë as shijën. Ishim të

shqetësuar. Bisedonim vetëm rreth ngjarjes. Si do të ndodhët, kur do të ndodhët? Secili, pa mbaruar së përtypuri kafshatën, çohoj me gojën plot dhe ikte në postin e tij luftarak. Edhe unë veprova ashtu. Rrja menduar dhe shikoja kur agrepët e orës detare po bashkoheshin te dy mbëdhjetë. Njëzet minuta... pësëmbëdhjetë... dhjetë... Në këto çaste më kapi një farë mallëngjimi: Më kujtohej kremitimi i vitit të ri në familjen time. Sa bukur e kalonim! Familja ime kush e di si do ta festonte atë natë e unë s'ndodhesha atje. Sikur ta dinin se në që gjendje isha unë! Po prapë mendoja më mirë të rrija unë ashtu një natë dhe ata të dëfrenin. Më mirë të rrijë gati ushtria dhe të gëzojë tërë republika vitin e ri.

Kur u bashkuani të dy agrepat e orës te dy mbëdhjetë, komandanti iu afrua mikrofonit dhe foli:

— Shokë detarë, nën oficerë dhe oficerë, ju uroj vitin e ri!..

Kur dëgjova dhe këtë urim, më shkuani lot përfaqe. Atëherë plot zemërim e urrejtje shpërtheva:

— Dreqi t'ju marrë, o armiq, që s'po na lini të qetë! O gjakpirës të poshtër! Gjer kur do të merreni me kësos poshtërsirash? Ne jemi në punën tonë e ju na bini në qafë! Kur do të vijë dita të qëroheni nga faqja e dhet?

Ndërkaq erdhi aty kužhinieri dhe, i shastisur, pyeti:

— Ç'ke, mor Clirim?! Kujt i kërcënohesh ashtu? C'janë këto britma, ore?

— Si të mos bërtas, mor vëlla! Deri kur do të vazhdojnë këta të poshtër! Provokime, provokime! Deri kur!

— Mos më bërtit mua, or vëlla, se s'kam faj! — tha ai buzagaz dhe vijoi: — Këtë punë kanë bërë armiq-të gjithmonë. E ke mësuar nga historia. Kur kanë ndenjur të qetë ata? Ata e mbajnë pushtetin me zjarr e bazonetë në dorë. Pastaj jo vetëm kërkojnë të mbajnë pushtetin, por duan të shtypin popujt e tjerë, të likuidojnë rivalët e tyre, të zgjerojnë sferat e influencës... Më fal se po të bëj punë politike. Ti këto gjëra i di mjaft mirë.

T'ju them tē drejtēn, s'e kisha besuar se kuzhinieri ynë ish aq i ngritur politikisht. Sikur tē mos i dukej e tepert, do tē më fliste tërë natën dhe s'do tē më përsériste tē njëjtën gjë. E, pra, ai s'kish ndonjë shkollë kushedi.

Kuzhinieri vajti për tē rregulluar mensën. E kërkonte detyra edhe atë pranë topit. Orët ecnin me një ritëm tē ngadaltë. Në kalimin e kohës, ngjarja s'më dukej më e përbindshme. Nuk më trempte më ajo nëndetëse, edhe sikur ta dija se do ndesheshim me tē. Koka nisi tē më rëndonte. Më vinte gjumë. Isha zgjuar atë ditë që në ora tre. Pastaj, sa më kish lodhur deti, kur ishim kthyer nga kantieri! Mbas asaj lodhjeje duhej një pushim i mirë. Kurse unë e kisha harruar lodhjen, sa po më kishin kërkuar për provat e estradës.

Ora shkoi një... dy... tre... asgjë e re. Ekuipazhi ishte në përgjim. Nata sa vente e bëhej më e rëndë. Koka i rëndonte secilit mbi supe. Nxora kokën mbi kuvvertë dhe shikova horizontin. Nata nxinte si pus. Të ftohit e ditës së parë tē janarit tē priste si brisk. Detarët qëndronin në këmbë pranë topave. Komandanti rrinte kokë më kokë me timonierin. Për mua ishte e para natë e tillë dhe relativisht në kushte tē lehta, kurse për komandantin ishte kushedi e sata. Sa e sa net tē tilla kishte kaluar ail!

Sipërfaqja e detit nxinjtë. Anijet luftarake me tē gjitha dritat e fikura dukeshin si shkëmbinj tē zez, si ishuj në miniaturë.

Kur shkova në postin luftarak, pashë se tubi bise-dues qe hapur. Dikush do tē më kish kërkuar. Atëhere u afrova, i fryva, dhe thirra sipas rregullit:

- Ura e komandimit!
  - Urdhëro! — dégjova përgjegjësin.
  - Jam posti luftarak katër! Kush më kërkoi?
  - Ku ishe? — buçiti një pyetje me zë tē lartë.
  - Ja, këtej...
  - Si largohesh pa lejë nga posti luftarak në alarm?
- Nuk e di se kur tē kesh nevojë, duhet tē marrësh lejë nga ne? — e kuptova nga zëri se ishte oficer Agimi. Kur pa se s'u përgjegja, më pyeti:

— Pse s'tregon eholloti thellësinë?

— Nuk di.

— Kontrolloje dhe raporto, se jemi në një zonë të cekët e mos dalim në tokë!

Edhe kjo më duhej. Mora arkat e veglave rezervë të atij aparati dhe shkova atje ku ish i montuar, në kabinën e shturmanit. E zmontova kapakun dhe shikova brenda. Asgjë s'dalloje. Gjithshka dukej në rregull. Atëherë kontrollova aparatët e tjerë ndihmëse. Nuk dalloja gjë. Hapa skemat dhe shikova lëvizjen e korrentit dhe rrugën që bënte impulsi kur kthehej nga toka. Nuk më dilte që nuk më dilte gjë. I vura përforcuesin rezervë, po përsëri e njëjtë gjë. Dreqi ta hajë! Isha bërë nervoz. Më vinte rëndë nga komandanti. Ai e dinte këtë dështim. Dhe inati i tij ishte avaria në teknikën luftarake. Si të veproja? U solla poshtë-lart dhe asgjë s'kisha në vijë. Po isha bërë aq shumë nervoz, sa që s'do të bëja gjë edhe sikur difikti të ishte fare i thjeshtë.

— Shoku oficer nuk munda të gjej avarinë! — raportova.

— Kap skandalin e dorës! — më urdhëroi.

Atëherë unë fillova të masja thellësinë e detit me matësin prej litari dhe të raportoja herë pas here thellësinë te zëvendëskomandanti.

Lart në qiel qjet nisën të rrallohen. Konturet e zeza të maleve po ndriçoheshin pak nga pak e kështu po lindte dita e re, dita e viti të ri. Atë ditë njerëzit do të zgjoheshin vonë, se kishin ndenjur shumë pa fjetur, ndërsa detarët e kishin gdhirë. Anijet kishin zënë vend sipas koordinatave të dhëna dhe përgjonin. Gjuajtësit detarë, me bombat e thellësisë lëviznin poshtë-lart. Atyre s'u duhej tjetër veç të diktonin nëndetësen. Në fund të ujtit po të ish, ata e çonin përpjetë me bombard e thellësisë, të cilat, kur pëlcasin në det, nxjerrin dheun e fundit të detit në sipërfaqe. Aty nga ora tetë, hidroakustika e një nëndetëses sonë njoftoi se kishte kapur një zhurmë të dyshimtë, kish përcaktuar thellësinë e distancën në kabël (një e dhjeta e miljes). Kërcitën zilet në të gjitha anijet dhe u bë mësymja drejt

vendit ku duhej të ishte objekti. Nga komanda e flotës kish ardhur urdhëri që të mos qëllohet me bomba thellësie. Sikur të qëllohet, ndoshta do sillte ndonjë prezrik të madh, pasi nuk dihet se q'mund të kish benda. Ndoshta kish edhe bomba atomike. Kjo e bënte më të vështirë zgjidhjen e detyrës. Vazhdoi kontrolli në koordinatin e dyshimtë, por s'u diktua më gjë; përsëri kishin humbur gjurmët e asaj zhurme.

Mbasi nuk doli gjë atje, zumë disa pika të caktuarë dhe vijuam përgjimin me gadishmërinë luftarake numër dy. Unë nisa përsëri punën për të vënë në gadishmëri ehollofit. Mobilizova të gjitha aftësitë e mia dhe, më në fund, në orën njëmbëdhjetë të drekës, ehollofi u vu në gadishmëri. Punoja pa pushim. Në atë ditë janari rrija vetëm me kanotiere dhe më shkonin djersë. Natyrisht edhe kabina ish e mbyllur. Isha lodhur në kulm, po, kur pashë suksesin, m'u mbush zemra me kënaqësi. Atehere raportova me entuziazëm:

— Shoku oficer në postin luitarak katër, avaria u likuidua!

— E vure në gadishmëri? Të lumtë! — më uroi oficeri.

Pastaj më kërkoi komandanti në urën e komandimit.

— Ke vuajtur shumë me atë avari — më tha, — por më mirë. Tjetër herë do ta gjesh më shpejt difektin. Ky qe një ushtrim për ty dhe do të të vlejë pa masë... A i ke parasysh të gjitha detajet e aparaturës?

— Krejt. Edhe lidhjet elektrike i mbaj mend.

— Posi. Me disa ushtrime të tillë formon shprehi teknike. Vjen çasti që, me të parë punimin e aparatit, e di ku e ka difektin. S'ke nevojë për të shikuar skeemat fare... E pikërisht këto na duhen në flotë: shprehi të përsosura teknike.

Tek fliste komandanti, e vërejta sa i zbetë ishte në fytyrë. Ndoshta kish mërdhirë natën, se nuk kish veshur as gëzofin. Ndoshta mund të ish edhe i sëmurë. Atij s'i dihet, përderisa nuk ankohej. Kështu kalonte ai net të tëra. Pastaj sa telashe rëndonin mbi kokën e tij! Ishte përgjegjës për gjithë jetën e

anijes. Më kot e kishin pritur fëmijët e tij dhe gruaja atë natë dhe kushedi sa do të prisnin kështu. Ata ishin mësuar me zhdukjet misterioze të tij. Fëmijët i qetësonte nëna, por ajo nuk qetësohej. E dinte se këto zhdukje të paadresë ishin plot rreziqe, por këto i ndrydhte në zemër dhe s'ja tregonte kujt. As burrit s'ja thoshte. Pse t'ja shtonte telashet? Kishte mjaft punët e tija. Shikoja atë fytyrë të ashpër dhe të zbetë e mahnitesha me punën e tij, mahnitesha me sakrificat që bënte për hir të mbrojtjes së atdheut. Kur ish kthyer nga shkolla, ai mund të kishte zënë vend të mirë, një vend shumë të rehatshëm dhe të merrte pagë të mirë, por komandanati kish kërkuar të shërbente atje ku t'i jepte më tepër atdheut, në detyrë të vështirë.

Sa më tepër që e njihja komandantin, aq më tepër më ngjallte respekt. Kur përfytyroja se si kish punuar me ne në fshatin që ish përmbytur nga uji, më mbusheshin sytë me lot. Njëherë jepte komandë, ua caktonte detyrat dhe pastaj hidhej vetë në punë. I vija detyrë vetes që të mos e kundërshtoja e të mos ja prishja kurrë sa të rrija me të.

Erdhi koha të hanim edhe drekën. Kisha qejf të dëgjoja radion, por ajo s'mund të hapej në alarm. Atëhere humba në mendime rrëth planeve të asaj dite. Ja, në orën katër ne e kishim caktuar shfaqjen e estradës. Dhe ora katër s'ishte larg. Megjithatë, sikur të kapej armiku, ne do të shkonim në bazë dhe do të vazhdonim aktivitetin.

Ndërkohë ra zilja për rreshtim.

— Ndërrresat e para në postë luftarake, të tjera në rresht! — u dha urdhëri me translacion.

Si u bë rreshtimi, bocmani erdhni me ca bloqe e flëtë të daktilografuara në dorë. Na hodhi një sy dhe nisi të lexojë, ndërsa na qëndronim në komandën: «gatit!»

— Urdhër dite Nr. 1 i komandantit të anijes.

Ra ora katër. Asgjë e re. Unë përfytyroja trupën e estradës dhe skena të ndryshme nga shfaqja që duhej të jepnim.

Kaloi ora katër... pesë... gjashtë... shtatë... tetë  
nëndë...

Kaloi edhe ajo natë dhe dita mbas saj edhe dita tjetër e kështu me radhë u bënë katër ditë që s'pati gjë të re. Dihej vetëm që nëndetësja ndodhej në zonën që kishim në përgjim. Sa diktohej në një anë, humbiste gjurmat dhe pastaj ecë e kape. Komandan-tët e anijeve kishin bërë kërkesë nga komanda eprore të qëlløhej nëndetësja armike. Kështu mbas katër ditësh erdhë urdhëri që të qëlløhej. Ky mision u takonte gjuajtësve detarë dhe nëndetëseve.

Ditën e katërt pati lëvizje më të madhe. Bombat e thellësisë së gjuajtësve detarë rrinin gati për tu lëshuar në thelli të detit. Gjithashtu nëndetëset me si-luret e tyre donin vetëm komandën «zjarr!» për të nxjerrë ujet e kuq në sipërfaqe.

Atë natë nga ora nëndë e mbrëmjes, ndërsa po kaloja nga kabina e shtermanit në urën e komandimit, në anë të bordit të djathtë, disa kabla më tej, u duk një flakë vigane. Dyshoje sikur uji i detit u bë benzинë dhe po digjej. Pastaj u dëgjua një buçimë aq e rëndë, sa u trondit toka e deti njëherësh. Kjo krismë e tmerrshme u dëgjua disa herë. Gjuajtësi detar «x» kishte qëlluar në vendin ku ishte diktuar diçka e dyshimtë. Por asgjë nuk solli kjo. Në të gjithë flotën u dha alarm luftarak, gadishmëria luftarake numër një.

Mbas dy orësh përsëri u dha gadishmëria numër dy. Komandanti na dha urdhër të flinim me ndërresa, por gjithnjë duke mos i hequr rrobat nga shtati. Unë kisha rënë në krevat, por skena e mëparshme s'më linte të myllinja sy.

Bobooo, çfarë arme të fuqishme kishim në dorë dhe s'e kisha ditur! S'kisha ditur se bomba e thellësisë mund të bënte tërë atë tmerr. Pastaj mendoja minat vigane që kishim ne në këtë anijes, siluret e nëndetëseve dhe të torpedinierëve. U ngrita dhe kryqëzova llérët në jastëk. Ashtu më kish zënë gjumi dhe koka kish pu-shuar mbi duart të shtrënguara njëra me tjetrën.

Në këtë gjumë të pakët e të kujdesur pasqë në

— Më ka dalë nami — tha Nikua.

U ulëm nën hijen e ca borigave të vogla në një bar të njomë.

— Habitem si rriten pishat në klimën e bregdetit. — thashë unë.

— Këto nuk janë si pishat e bjeshkëve. Janë tamam për këtë klimë. — Alekua më spjegoi gjatë për pyjet e pishave të bregdetit.

— Lërë punën e pishave, se s'dua botanikë — tha Nikua. — A mund të na tregosh gjë si e diktove nëndetësen armike me hidroakustikë?

— Ç'të tregoj unë, ja, dëgjova një zhurmë të nënushme. E analizova duke bërë krahasime me llojet e tjera të zhurmave dhe më doli se ish nëndetëse; pastaj llogarita distancën dhe shpejtësinë e lëvizjes dhe raportova. Ç'të them më gjatë? Punën tjetër e bënë të tjerët pastaj.

■ **Të dallosh objektin me vesh ndërmjet zhurmave të tjera s'di si më duket. Nuk do ta kisha beguar tha Nikua** ■

— Ja, pra, që kështu ndodh.

Ndenjëm edhe ca në hije, pastaj u futëm në klub.

— Nuk rrighet më kështu — tha Nikua. — Se nuk na ecën muhabeti pa pasur ndonjë gotë përpëra.

— Ta kisha ditur, do të sillja nga dy gota të mëdha — i thashë unë.

Në klub gjetëm shumë njerëz, që po bisedonin për nëndetësen armike. Ata flisnin për krismat e lahtarshme të bombave. Secili gjente nga një fjalë për të thënë.

Unë porosita nga një konjak dhe ca llokume.

— Hajde, gëzuar! — tha Nikua, sapo na i vuri përpëra kamerieri. — Për komunistin e ri dhe përsuksesin që korrëm mbi armikun!

— Gëzuar! Mbas pranimit në parti uroj edhe për diçka tjetër — tha Alekua.

— S'ke ç't'i urosh më — tha Nikua, — Jo, harrova, se e ka rregulluar me një vajzë atje në atë fshatin ku kemi punuar. E quajnë Vera dhe është e shëndoshë.

Qeshëm ca, po mua më qëlloi plagë ama.

Spektatorët prisnin. Salla ishte mbushur plot. Spikeri doli në skenë dhe tha:

— Të dashur spektatorë, armiku desh të mos na lejonte të jepnim premierën tonë para jush, por, ndonëse na e shtyu për pesë ditë, nuk mundi të prishë planin e këshillit të kulturës.

— Urraaa! — bërtitën të gjithë njëheri spektatorët që e duartrokiten dhe u ngritën në këmbë.

— Ushtria Popullore! Ushtria Popullore!

Pastaj:

— Paaartia e punës! Paaartia e Punës!

Dhe mbaroi me brohoritjet:

— Enver Hoxha! Enver Hoxha! Enver Hoxha!

Pastaj spikeri zuri vend te orkestra; i binte violinës.

*alë ne te njejtën kohë e drejtonte orkestrën:*

*Qysh në numrat e parë estrada u pëlqye nga spektatorët. Atë duartrokiten me vjari. Una kisha mobilizuar të gjitha aftesitë e mia për të dale mire. Së pari më takoi të dilja me vjershën: «Shqipnisë së robnueme». Spektatorët u ngritën të gjithë në këmbë dhe duartrokiten. Kur interpretova monologun «Para lundrimit», spektatorët bërtitën të gjithë njëheri:*

— Biiis!

Doli spikerja për të dhënë diçka tjetër, po spektatorët s'e lanë:

— Biiis! — bërtisnin të gjithë.

Kur dola për të vazhduar, ma pritën:

— Nga fillimi! Nga fillimi!

E përsërita qysh nga fillimi.

I përhëndeta me kokë dhe u ktheva. Atëhere ri-filuan thirrjet akoma më keq. Atëhere u detyrova të them:

— Të dashur spektatorë, ne kemi dhe pjesë të tjera për të interpretuar, prandaj duhet të vazhdojmë.

Spikerja doli dhe vazhduam sipas programit.

Mbas shfaqjes filloi mbrëmja e vallëzimit.

\* \* \*

Pas një jave, ndërsa po pregetiteshim të dilnim në një lundrim, erdhi sekretari i organizatës bazë të partisë dhe më tha të qëndroja në bazë, se do të mbledhjej organizata e partisë së grupit për të shqyrtuar kërkesën time për pranim në parti. Kurse anija ime nuk do të kthehet në bazë deri të nesërmen.

— Meqë mbledhja bëhet nesër, pse të mos shkoj në lundrim? — e pyeta sekretarin.

— Kam punë me ty tani përparrë — tha ai.

U bë zëvendësimi në postin tim luftarak dhe anija u nis.

Ja dhe momenti i pranimit tim në parti. Atë ditë isha ca i habitur. Kisha gjithfarë mendimesh. Do të pranoheshë apo s'do të pranoheshë në parti? Gjatë gjithë jetës sime kisha punuar mirë. Kisha bërë përpjekje për t'u bërë një ushtar i mirë i partisë, por kisha pasur edhe të meta në punën time. Isha treguar si një frikacak i keq gjatë stërvitjeve për të mësuar notin. Kjo gjë s'më nderonte. «Po sikur të ngrihet dikush e të thotë që Çlirimi është frikacak?» mendoja. «Sa rol do të luajë kjo gjë për mospranimin tim në parti! Kanë të drejtë. Një njeri që ka pasur frikë të hidhet në ujë për të mësuar notin, a nuk do të tregohet frikacak në luftë?» E, pra, unë s'kam as do të kem frikë kurrën e kurrës nga asnjë sakrificë. Për partinë unë jap dhe jetën, sejeta ime është e partisë.

E ku numërohen të mirat që i detyrohem partisë? Ku ishim dje dhe ku jemi sot? Si do të ishte fshati im dhe atdheu, po të mos qe partia?

Po unë ç'kisha bërë për partinë? Në këtë drejtim isha krejt i pakënaqur. Vërtet që detyrat e mia i kisha kryer mirë, por kjo ishte pak. Jo, as detyrat nuk i kisha kryer gjithnjë mirë. Në shkollë nuk kisha mësuar mirë. A nuk ishte ky një minus i madh për nua? «Këto gjëra duhet t'ja them organizatës, — mendoja. — Të bëj autokritikë dhe të mos i përsërit kurrë më në jetën time.»

Atë natë thuajse s'fjeta fare. Mendoja e mendoja

e më dukej se nuk meritoja të pranohesha në radhët e partisë... «Unë duhet të njoh vijën e partisë e, për të njohur këtë, duhet të studjoj thellë materialet e partisë; kurse unë kam gjithë ato boshllëqe», mendoja. «Unë kam studjuar fare pak».

— Duhet studim, vazhdimisht studim, — më kishte thënë sa herë zëvendësi për punë politike.

Kështu kaloi ajo natë. Kështu edhe e nesërmeja deri në orën tetë të mbrëmjes, kur mbaroi mbledhja dhe kërkesa ime u miratua njëzëri nga organizata. Sa gjë e madhe qe për mua, kur i dërguari i degës politike të flotës më tha:

— Të uroj nga zemra! Ti ke perspektivë për t'u bërë një komunist revolucionar i vërtetë. Partia ka besim të madh tek ti.

— Nuk di të përshkruaj gjendjen time shpirtërore. Pranimi si kandidat në parti më jepte krahë, më bënte më të ndërgjegjshëm për t'i kryer detyrat e mia. Tani duhej të isha edhe më kërkues ndaj vetes për të merituar dhe mbajtur lart emrin e anëtarit të partisë.

Pastaj për ne filloj stërvitja e rregullt. Pregatiteshim për të dhënë detyrën «A-l». Kërkohej një preqatitje e gjithanëshme për këtë detyrë. Ditët e para u bë mbledhja e kolektivist, ku u morën zotime dhe u këmbyen mendime të ndryshme që tregonin si e si mund të dilnim më mirë me detyrën.

Efektivi punonte me një gjallëri të jashtëzakonshme; vlonëtë puna për të mbajtur pastër postet luftarakë. Të mbash pastër postin luftarakë në anije është punë e madhe. Ndryshku është një agresor i pabesë e i rrezikshëm. Punë tjetër intensive ishte preqatitja politike, stërvitja rreshtore, ajo e zjarrit dhe preqatitja teknike. Çdo detar duhej të dinte teorikisht funksionimin e teknikës së postit të tij luftarak dhe të dhënat taktilo-teknike të anijes në përgjithësi. Përveç lodhjes fizike duhej edhe shumë studim. Mbasditeve, në orët e kulturës masive, merreshim me punë të ndryshme kulturale: organizonim reçensione librash, biseda, dëgjime të organizuara të emisioneve më të rëndësishme të radios e tjera.

Unë fillova të lexoj letërsi artistike. Më parë nuk kisha lexuar libra. Veprën e parë në prozë e kisha lexuar në shkollën e instruksionit dhe pikërisht romanin «Afërdita përsëri në fshat», pastaj i hyra «Rreshterit të milicisë» dhe pas tij nuk e lashë më leximin e librave. Po leximin më të madh po e bëja tani në anije. Atje kishim edhe një bibliotekë të pasur. Përveç librave që sillte aparati politik, sillnim edhe ne vetë. Kishim krijuar një fond të vogël dhe blenim librat e reja.

Një ditë u bënë zgjedhjet e organizatës së rinisë. Mua më zgjodhën sekretar byroje, ndonëse sapo isha pranuar kandidat partie dhe kish të rinj të tjerë komunistë e më të aftë për atë punë. Kjo më nxiti për punë. Organizata e rinisë u bë më aktive. Dhe ky aktivitet e tërroqi edhe Nikon.

Ai një ditë më tha:

- Më duket vetja i ndarë nga shoqëria. Ndjej zbrazësirë në shpirt. Të gjithë jeni anëtarë të Bashkimit të Rinisë, bëni mbledhje, diskutoni probleme, kurse unë shikoj nga jashtë. Më është mbushur mendja të paraqes kërkesë për tu pranuar anëtar i organizatës.
- T'u mbush mendja më në fund, ë?
- Më ishte mbushur me kohë, po ju nuk po më thoshit. Tani vendosa të mos pres.
- E dija që do të të mbushej mendja vetiu, ndaj nuk të kam thënë — i thashë unë dhe e përqafova.
- Tani u bëmë shokë të ngushtë me gjithë mend.
- Pse, më parë nuk ishim?
- Ishim, ishim, po tani po e forcojmë shoqërinë më tepër.
- S'dihet a më pranon organizata.
- Besoj se po, — dhe shtova me të qeshur — zotohu, se do ta pish duhanin me rregull!
- Për duhanin nuk zotohem dot. Ti e di sa e pi unë. E kam inat, po q'të bëj?...
- Po të vendosësh, bën gjithshka. A mban mend ç'bëje në shkollë? Ishe bërë problem i tërë repartit. Por tani ke ndryshuar sjelljet. S'mund të besoja se do zbatoje pa fjalë urdhërin e një nënoficeri të shërbimit

të detyrueshëm. Të kujtohet kur nuk e përfillje as komandantin e kompanisë?

— Ashtu ka qenë vërtet — tha Nikua.

20

Isha duke dëgjuar një emision këngësh popullore, që po transmetonte radio Tirana, kur erdhi posta në anije. E prisja postën me padurim. Kisha një dëshirë të madhe për të lexuar. Një herë shikoja titujt e shkrimeve të të gjitha organeve që na vinin pastaj zija dhe lexoja. Kësaj here në revistën «Për mbrojtjen e Atdheut» pashë një fotografi që më bëri shumë kureshtar: Vera e veshur me rroba ushtarake dhe me pushkë, në pozicion zjarri! Një herë nuk m'u besua, por edhe diçitura e fotografisë tregonte për Verën si një qitëse e dalluar e organizatës së SHNUM-it. E mbaja revistën përpara dhe, duke soditur profilin e Verës, u zhyta në ëndërrime, që nuk i kisha provuar më parë.

Kur isha takuar me të në kooperativën e saj, ndoshta kisha qejf të dashurohesha me të, po tani ëndërra ish më e thellë. Nisi të më vërtitej nëpër tru mendimi: «Sikur ta bëja shoqe jete? Sa bukur do të ishte!» Ajo më pat thënë se nuk ish e fejuar. Po sikur të jetë fejuar gjatë kohës që ne nuk jemi parë? Jo, s'duhet të jetë fejuar. Ajo do të fejohet me mua... Po si do të merrem vesh me të? Kur të shkojmë në ndihmë të fshatit, unë do të kërkoj të shkoj në fshatin e saj. Po fshati nuk ka nevojë për ne para prashitjeve. Sa vonë do të jetë atëhere! Duhet të lidhem më parë. Po si të lidhem se? T'i shkruaj letër? Jo! Kushedi si do ta presë. Ndoshta do të më quajë budalla pastaj. Hajde rregulloje me të si të mendojë keq një herë. Si të bëj? Do ta gjej disi rrugën. Ah, sikur të mos jetë fejuar! Kur të dal në liridalje do të shkoj në fshatin e saj... Jo, edhe kjo mënyrë s'më pëlqen. Pastaj dhe nuk e njoh sa duhet. Shoqja e jetës duhet njobur mirë. Po, e mirë është. Që është kooperativiste e dalluar, jam i sigurt. Aktiviste e organizatës së rinisë është; një bisedë të ëmbël ka;

83

e zgjuar duket mjaft; dhe e mirë është. Si ta gjej mënyrën pér t'u marrë vesh me të që të mos fyhet? Sa budalla edhe unë! Pse s'ja hodha atëhere larg e larg? Nuk e kisha atë mendim atëherë. Si të veproj tanë?

Nisa të lexoj diçka në «Zërin e Popullit», po nuk e përqëndroja dot vëmendjen. Reshatat e shkrimit më ngatërrroheshin me fytbynë e Verës. Kisha rënë në dashuri.

Një javë para se të jepnim detyrën kursore, u bë mbledhja e organizatës së rinisë pér të marrë në analizë punën që kish bërë organizata pér të dhënë detyrën «A-1». Në mbledhje do të shqyrtohej edhe kërkesa e Nikos pér t'u pranuar në organizatë.

Kërkesa u lexua nga unë dhe u diskutua nga organizata. Në përgjithësi shokët folën pér kthesën e madhe që kishte bërë Nikua. Unë, që i dhashë rekomanimin, fola gjerë mbi jetën e tij, duke përmendur veset e këqia që kishte pasur në jetën civile dhe vazhdova me periudhën në shkollën e instruksionit.

— Sa pér jetën në anije — thashë unë — jemi dëshmitarë të gjithë. E kemi parë në ditët e para qendrimin e tij dhe po e shikojmë tanë.

Në përgjithësi diskutuesit kërkuan nga Nikua të sillej më mirë, të kish më shumë respekt pér nënëoficerët dhe oficerët. Këto ishin të metat e tij të dukshme tanë.

I mbetej radha Nikos pér të folur. Po fliste si duke kërkuar fjalët.

— Ashtu siç tregoi Çlirimi... ashtu ështëjeta ime — tha ndër të tjera. — Jam rritur larg hallevë të jetës. Gjithë njerëzit e shtëpisë i kisha në punë. Harxhoja lekë sa më tekej. U bëra një farë mikroborgjezi. Prandaj disiplina ushtarake m'u duk aq e tmerrshme në fillim. E tillë, ka qenë jeta ime. E tillë, si tha Çlirimi, ka qenë edhe periudha në shkollën e instruksionit. Këte e pëershkroi mirë ai. Mirëpo, pastaj, m'u mbush mendja të dilja nga rruga pa krye, ose, më mirë të them, koletivi më detyroi, përderisa s'gjeja pikëmbështetje kund pér veprimet e mia. Gjithsecili ma priste me dajak. Nga tërë ai efektiv që ish në shkollën e instruksionit s'i kisha as tre veta që të më bëheshin krah. Bile as ata

s'dilnin haptazi. Duke parë se mbeta vetëm, m'u mbush mendja të hyja në rrugën e vërtetë. Natyrisht nuk them se jam pastruar nga të gjitha të metat. Unë e di se kam shumë të meta ende, por do të bëj çmos që edhe këto t'i zhduk. Me atë-djall duhanin vërtet veproj keq, po e kam vështirë. Ju e dini se e pi tmerrësish... Rregullorja s'bën përjashtime, por... do ta kufizoj veten, ashtu si e kufizova për të tjerat. Sa për respektin ndaj eprorëve s'di q'të them. Unë e di që jam munduar ta ndreq edhe këtë të metë. Ka raste që sillem me ton familjar me eprorët, por sigurisht kur pranojnë ata. Sidoqoftë edhe në këtë anë duhet ndrequr diçka.

Më në fund e mori fjalën bocmani, që ish i dele-guar nga ana e organizatës së partisë të anijes si dhe nga organizata e partisë e repartit. Ai foli për Nikon ashtu si nuk e kisha pritur. Më mirë nga të gjithë.

— Nikua ka ndryshuar. S'është më ai i pari. Edhe sjelljen ndaj eprorëve e ka ndryshuar. Ja, mua, në filim s'më respektonte, po e shihja që s'do të vazhdonte gjithnjë ashtu, ndaj bëja sikur s'dëgjoja... Tani s'mund t'ja kërkojmë të gjitha fishek! Me kalimin e kohës do t'i zhdukë edhe ato pak të meta, siç tha vetë. Unë shpreh bindjen se Nikua do të jetë një kuadër mjaft i mirë i organizatës.

Në fund kërkesa për pranim u hodh në votë. Shokët i shtrënguan duart Nikos duke i uruar suksese në punë e në jetën e organizatës.

## 21

Mbas dy ditësh, trupa e estradës sonë do të shkonte në një repart tjetër të flotës dhe në fshatra për të dhënë numrin që kishim preqatitur. Me siguri do të takohesh me Verën. Pregatita me shumë kujdes uniformën. I hekurosa e stérhekurosa rrobat, gati sa s'i dogja. Të gjithë amatorët e trupës së estradës erdhën pa përjashtim. Shfaqjen e dhamë mbasdreke dhe pastaj shkuam në fshatin e Verës.

Ngaqë isha në tension gjatë shfaqjes, nuk e kisha vënë re Verën në mes të spektatorëve. Mbas mbaruam, për çudinë time, ajo erdhi e më takoi. Unë u skuqa. Isha i papregatitur në atë çast.

— Qenke bërë dhe artist — më tha.

— Të falem nderit për komplimentin! — i thashë. Më dha dorën dhe e pyetëm njeri-tjetrin për shëndetin e punët.

— Pse ke pyetur për mua, kur ke arritur këtu? — më tha.

Unë ngurrova një herë. Thashë:

— Se kam dëgjuar gjëra të mira për ty.

— Ç'ke dëgjuar? — pyeti ajo me kureshtje.

— Po ja, qitëse e mirë me armë, skuadërkoman-dante, punëtore e dalluar e ç'të them...

— Kaqë shumë qenke interesuar?

— Sigurisht...

Vera uli sytë dhe i hipi një purpur i këndshëm. Pastaj më tha: — Urime për pranimin në parti.

— Të falem nderit. Ku e more vesh?

— Ashtu si e more vesh ti për mua — tha ajo.

Shëtitëm ca në sheshin para shtëpisë së kulturës.

— Eja në shtëpinë time — më tha.

— S'kam kohë. Duhet të shkoj.

— Për një kafe të paktën. Sa herë kam qenë unë në shtëpinë tënde! Nëna kërkon të vish patjetër.

— Nuk të thotë gjë nëna për këtë punë?

— Përse të më thotë?

— Ti çosh një djale të ri në shtëpi!

Ajo nuk më ka ndaluar të shkoja në garat e qitjes as në aktivitete të tjera; aq më pak do të më thotë për ty, që të kemi mik.

— Nëna ime do të mendonte pakëz ndryshe — thashë unë.

— Nëna ime do të të presë edhe më me qejf, kur të marrë vesht që je edhe komunist. Ajo e di se komu-nistët janë të ndershëm. Një ditë i thashë se do të kër-koja të pranohesha në parti dhe ajo e priti këtë gjë me kënaqësi të madhe «Të bëhesh komuniste, moj, tă bëhesh

si ata që na sollën këto ditë, që edhe ne, plakat, të rrojnë në lumtëri.»

— Dhe pastaj?

— Kam vendosur me kohë, po ajo punë nuk bëhet ashtu lehtë.

— I ke preqatitur dokumentat?

— Akoma jo.

Kjo temë e bisedës na afroi më shumë në një anë, po edhe na largoi. E kisha vështirë tani ta hidhja fjalën atje, ku dëshëroja, te dashuria. «Po më mirë», mendova. «S'duhet të ngutem një herë. Nuk e njoh dhe aq mirë. Atëhere ka qenë njëmbëdhjetë vjeçë».

— A të kujtohet kur u rrähëm me grushte te Bira e Dhiye, Vera? Ti më re mua me një grusht hundëve dhe më doli gjaku. Pastaj qave. Ti ishe më e vogël e më rrahe mua.

— Ti ma le për mik. Isha mysafire.

— A të kujtohet, kur hymë në atë shpellë?

Ajo qeshi dhe uli kokën. Ju kujtua ajo ngjarje. Shpella ishte e errët. Dëgjuam një farë zhurme dhe Vera u tremb. Atëhere m'u afrua mua dhe më pushtoi me duar. Edhe unë e shtrëngova fort dhe qëndruam një copë herë ashtu.

— Kudo shkonim bashkë — tha ajo. — Te motra qëndroja fare pak. Vetëm në mbrëmje. Ti nuk ishe shumë i dhënë pas lodrave.

— As ti s'ke pasur merak.

— As unë, vërtet. Kisha qejf të rrinim malit nëpër ata gurët e mëdhenj dhe të bisedonim për natyrën.

— A të kujtohet, kur nëna ime dhe motra jote flisnin për fejesën tonë e unë s'kisha qejf? Skuqesha e turpërohesha, kurse ti buzëqeshje.

— Ashtu ka qenë vërtet.

— Çfarë qëndrimi do të mbanim, po të bëhej ajo bisedë tani?

Ajo uli kokën. Buzëqeshi.

— Sigurisht ti do të skuqeshe, do të kundërshtoje patjetër.

Unë i shtrëngova pak dorën, që e kisha mbajtur me dorën time.

— Je në shtëpinë time e mund të thuash ç'të duash tha ajo buzagaz.

— Meqë paskam mundësi të flas lirisht, atëhere do të shprehem mirë. — Ja shtrëngova edhe një herë dorën. Kishim hyrë në një rrugë të vogël. Ishim vetëm, unë dhe ajo. Anash rrugës kishte fiq e pemë të tjera. Ajo më shikoi me bisht të syrit. Ishte rasti të flisja hapur, por s'munda. Kur zë miqësi me një vajzë, e ke vështirë ta kthesh atë në dashuri. Mendoja të flisja hapur, por s'thashë asgjë. Megjithatë s'ish nevoja të flisja, se të gjitha kuptoheshin. Kur desha të largoresha, ajo më tha:

— Unë të lë të shkosh, vetëm me një kusht. Të vish një natë apostafat në shtëpinë time.

— Po s'kam kohë të vij!

— Të marrësh lejë në komandë posaçërisht për këtë punë.

— Të falem nderit.

— S'ka të falem nderit. S'dua të të bëj ndonjë nder me këtë punë.

— Atëhere, pra, të jap fjalën se do të vij.

## 22

Dita ishte e vrenjtur dhe mjaft e ftohtë.

— Pregatitni postet luftarake për dhënjen e detyrsë kursore «A-l». — u dha urdhëri me altoparlant. Mua filloj të më rrahë zemra. Ishte e para herë që do të jepja detyrën kursore detare. «Kjo ditë kurorëzon tërë punën tonë», mendova. «Po të mos dal mirë, do t'u prish punë edhe shokëve».

Komandanti me zëvendëskomandant Llukanin filluan kontrolllet nëpër postet luftarake. Mbas dy orësh më erdhi radha mua. Kur u dukën ata te dera, unë dhashë komandën dhe raportova:

— Gatiit! Shoku komendant, posti luftarak katër është gati për dhënjen e detyrsë «A-l». Komandanti i postit luftarak, detar Haka.

— Qetësohu, detar Haka! Je në rregull me të gjitha punët?

- Fare mirë!
- Ke marrë letër nga shtëpia?
- Kam marrë shpesh.
- Ç'hotë babai?
- S'hotë gjë. Mërzitet. Si plak.
- Edhe ti je mërzitur mjaft, ë?
- C'ka. Jo dhe aq.
- E di, e di! Do të të dërgojmë me leje të zakonshme tani!

- Jo, shoku komandant! Lejën s'dua ta bëj tani.
- Të pëlqen andej nga vera ty...
- Sigurisht.

— Mirë. Janë gjëra që rregullohen këto. Për kësogjérash nuk vuajmë ne... Tani do të shikojmë mirëmbajtjen e teknikës. Por, po pate ndryshk, e humbe lejën e zakonshme.

Komandanti kish veshur një palë kominoshe dhe futej gjithkund. Hapi busullën xhiroskopike, futi dorën andej nga rezervuari dhe, kur e nxori, ish bëre pis me vajra.

— E shikon? — më tregoi mua dorën e ndyrë.  
Unë s'bëra zë, por më erdhi plasje. Si nuk isha kujtuar ta pastroja atë vend? Sa keq!

Komandanti i futi pastaj në kallumë. Atje shikoi me imtësi me një llambë elektrike portative dhe, për dreq, në një rrëzë pa pak ndryshk. U bëra akoma më nervoz. Ku i kisha pasur sytë? Pastaj më kontrolluan veglat rezervë. Edhe atje në një çelës mekanik bullonash numër tetë u gjet një thërmi ndryshku.

— Kështu?... — ma bëri komandanti. — Ky është shumë pak; por për teknikën është vdekje e parakohshme. Si kryen kontrollin e teknikës, nisën të më pyesin për të dhënat taktiko-teknike të anijes.

— Këtu shumë mirë! — tha komandanti.

Pastaj filloi të më pyesë për postin tim luftarak.

— Më thuaj si arrijnë xhiroskopët që me rrrotullimet e tyre të gjejnë meridianet e kërkuar!

Si iu përgjegjja kësaj, më pyeti në skenat e radiopelegatorit, për llambën dedektore dhe për rolin që luan ajo në aparatin e radios.

Edhe për këto e kisha piërgjegjen gati. Më bëri edhe disa pyetje të tjera dhe më çuditit për njojuritë e thella që kishte për postin tim. Sa aparatura të ndërlikuara kishte nëpër postet luftarake! Unë kisha dëgjuar inxhierin që ish i degës, dhe s'më ish dukur më i zoti.

Pastaj nisën pyetjet për mësimin politik.

Edhe për këtë isha preqatitur mirë. Më pyeti zëvendës komandant Llukani për disa ngjarje të luftës nacionalçlirimtare dhe për disa gjëra ngajeta aktuale.

Pastaj kaluan nëpër postet e tjera luftarake.

Mbas kontrollit, nëpër postet luftarake u dha urdhëri:  
— Gjithë efektivi të marrë armët sipas rolit luftarak  
dhe të rreshtohet në kicin e anijes për shikimin rreshtor!

Mbas pak u gjendëm të rreshtuar me automatikë e karabina sipas rolit luftarak dhe me uniformën e liridaljes. Edhe oficerët po kështu ishin veshur. Me t'u dukur komandanti, oficer Agimi dha komandën dhe paraqiti forcën:

— Gatu! Shoku komandant, efektivi i anijes është rreshtuar për shikim rreshtor! Zëvendëskomandant i anijes, oficer Xhumari!

Na ndanë në dy rreshta dhe filluan të na bëjnë një kontroll të imtë për pastërtinë, qethjen, mbajtjen e uniformës dhe armët. Nga shprehja e fytyrës dukej se komandanti ishte i kënaqur. Në fund tha:

— Tani shpérndaji, oficer Agimi, dhe në orën gjashë të mblidhen se do të bëjmë analizën e detyrës. Deri atëherë të bëjnë pushim.

Kur u shpérndamë ishte ora tre, pra tetë orë kish zgjatur kontrolli. Gjatë drekës ne diskutonim për detyren.

Pastaj qelli zuri të dystohej me një shtresë resh jo të errëta dhe filloi të binte një shi i lehtë, por i ftohtë. Majave të maleve binte déborë. Mbas hengrëm drekën, dola një herë në kuvertë. Endërroja ta kaloja atë pak pushim me Verën, por ajo ishte larg.

Në orën gjashë u bë mbledhja e efektivit simbas urdhërit të komandantit të anijes. Komandanti bëri një analizë të kontrollit duke vënë në dukje anët e mira dhe anët e dobëta.

— Kam dëgjuar të thuhet shpeshherë që edhe dielli ka

njolla, prandaj dhe ne s'mund të jemi pa të meta — tha. — Dielli i ka njollat, por ne duhet të jemi pa të meta. Për shembull, në postin luftarak katër, ku shërben Çlirim Haka, kam gjetur një preqatitje të kënaqshme. Ai ka punuar shumë. Po a s'do të kish mundësi që ato dy njolla ndryshku të mos ishin, kur s'kish ndryshk në asnje vend tjetër më delikat? Po. Kishte mundësi të merrej detyra me notën «shkëlqyeshëm». Po këto gjëra të «vogla» na janë mbrapa. Mos kujtoni se është gjë e vogël ndryshku edhe po të jetë sa një majë gjilpëre... Në përgjithësi ekuipazhi ka punuar mirë. Detyra quhet e marre me notën «MIRË»

Kubriku oshëtiu nga duartrokitjet. Ajo natë u kthyte në festë. Ne, grupi diletant, dhamë para ekuipazhit numurin e parë. Komendantit iu bë qejfi për preqatitjen e mirë të grupit diletant. Pastaj ja filluam të vallëzojmë.

Kur të gjithë detarët zunë krevatet, unë u mylla në kabinën time dhe i shkrova një letër Verës. I tregova se shërbimi s'më kish lejuar të shkoja në shtëpinë e saj, por që shpejt do ia gjeja rastin. E mbusha letrën me fjalë boshe fund e maje nga që s'diia ç'të shkruaja; pastaj e palosa, e futa në zarf dhe rashë të flija. Gjumi s'po më zinte. Më hante gjithnjë meraku i Verës. Kaloi ora dy-mbëdhjetë. Vazhdonin të kalonin minutat...

— Tërr-rr-rr-rr-rr-rr! — u dëgjuan zilet elektrike.  
— Alarm! — u dëgjua zëri i nënöficerit dezhurn.

Kur tha ai fjalën «alarm» unë kisha zbritur nga krevati dhe, me rroba në dorë, vazhdoja preqatitjen e postit luftarak.

Brenda minutës raportova:

— Posti luftarak katër, gati për luftë!

Unë qeshë i pari që raportova. Pastaj u vesha shpejt e shpejt e dola në urën e komandimit për akordimin e repiterëve. Gjeta komendantin që po rrinte atje dhe shikonte preqatitjen e efektivit. Dukej se s'kish fjetur fare. Komandanti ynë ja bënte qejfin efektivit, kënaqej kur ne dëfrenim, po përmbi të gjitha kish detyrën. Ndërsa detarët kishin rënë në gjumë dhe oficerët familjarë kishin shkuar në shtëpitë e tyre, ai kish qëndruar atje për të kontrolluar preqatitjen e efektivit natën në befasi.

Për tre minuta zëvëndëskomandanti raportoi:

— Shoku komendant, anija gati për luftë!

S'vonuan të vinin edhe oficerët nga shtëpitë e tyre.

Komandanti dha urdhër të dilnim në det.

Brenda pak minutave, anija jonë ishte në detin e hapur.

Mbas pak u dha sinjali «Pushim alarmi» dhe u kthyem në bazë. Përsëri zumë krevatet. U vendos qetësia e mëparshme. Nëpër kubrike dëgjohej vetëm frymëmarrja e detarëve. Përsëri nisa të ëndërrroja për Verën. Kësaj here më kish zënë gjumi pa kuptuar dhe isha zhytur në ëndërra. Vetëm zilja e zgjimit më nxori nga bota e ëndërrave.

## 23

Gjithë ato ditë ishim të zënë me stërvitje, prandaj unë e gjeta rastin shumë vonë për të shkuar në shtëpinë e Verës. Disa herë kishim këmbyer letra dhe unë i kisha thënë që do të shkoja shumë më vonë nga ç'shkova me të vërtetë.

Plaka më pyeti gjerë e gjatë për fshatin tim e familjen. Ajo s'kish qenë ndonjëherë, por fshatin e kish të gjallë para sysh nga tregimet e të bijave.

Pastaj shtruan pijen. Asnjë nuk ishte i rakisë. Plaka s'e pinte fare. Vera vetëm sa për të më shoqëruar. Edhe unë gjithashtu fare pak. Megjithatë unë e Vera pimë sa për të mbajtur bisedën.

— Këta bëjnë raki të fortë, nënë, — tha Vera.

— Por ju këtej e pini më shumë nga ne.

Biseduam shumë rrëth zakoneve të fshatrave tonë.

— Fshati yt më ka lënë shumë kujtime — tha Vera.

— Kam dëshëruar që të vija edhe herë të tjera, por nuk erdha dot. Megjithatë fshatin, zakonet e mira dhe të këqia të asaj zone i kujtoj shpesh. Sa vajza vazhdojnë të shiten si bagëtia! Sa martesa me ndryshime të mëdha moshe! Atje martesa shpesh herë është për çiftin një trajedi e jetës, në vend që të jetë lumtëri, ashtu siç duhet të jetë.

— Ti hiperbolizon, Vera. Atje ka edhe vajza që martohen me dashuri.

— Këto janë raste tepër të rralla. Ju punoni fare pak atje për të futur të renë. Pajtoheni me gjendjen e nuk ju duken gjë ato të meta.

— Kjo është e drejtë. Ndryshe i shikoni ju, ndryshe ne që jemi rritur atje. Ja, fjala vjen, mua më është dukur e pabesueshme që të bëhen mbrëmje vallëzimi në fshat ashtu siç pashë këtu tek ju. U është dashur punë shokëve të më bindnin se vajzat që vallëzonin ishin kooperativiste. Unë mendoja se mos ishin arësimtare a dreqi e di çfarë.

— Edhe ne kemi zakone të këqia, more bir, — tha plaka.

— Sigurisht. Kudo në Shqipëri ka zakone të tilla.

— Pse nuk vjen atje tek ne për të luftuar me këtë vrull kundër kanunit?

Ajo buzëqeshi dhe ngriti gotën. Ma çeku pak edhe timen.

— Si të vij atje?

— Të vish si anëtarë kooperative. Kërkjoje dhe me siguri këtu do të të lejojnë, kurse ne atje do të mirëpresim.

— Jo, ishalla! — tha plaka.

— Prit, moj nënë, se nuk po nisemi tani! Ha-ha-ha!

— i tha Vera dhe m'u drejtua mua: — Atje duhet shumë punë. Pse nuk pi, Çlirim?

— E habite ti, duke mos pushuar kurrë me këto biseda — tha plaka.

— Unë rakinë e pi fare pak. Vetëm sa të mos ndahem nga shokët. Kurse bisedat po më kënaqin, nëna e Verës. Kështu dua unë... — Kur të mbarosh shkollën e mesme çfarë do të bësh, Vera?

— S'po të kuptoj — tha ajo.

— Ja, pra, do të vazhdosh universitetin apo do të hysh në ndonjë punë tjetër!

— E sheh që të kapa edhe një herë?

— Pse?

— Se ti ke koncepte të padrejta. Domethënë unë duhet medoemos të mos punoj në bujqësi, se paskam

arësim të mesëm! Ti nuk beson që unë s'kam pasur parasysh fare një gjë të tillë, kur ja kam hyrë shkollës. Qëllimi im është të punoj në kooperativë ose ku të ketë nevojë për mua shoqëria! — Po ti pse nuk vazhdon shkollën e mesme, Clirim?

— Unë? Po... si të them... Dësheroj mjaft, po e kam të vështirë.

— Po të ishte lehtë, do ta bënin të gjithë atë punë, por ti duhet t'i kapércessh vështirësitë.

— Agjuracion prapë, Vera! — qesha unë. Qeshëm të dy.

— Për nder, thua mirë ti, po a mund t'ja dal unë?

— Si s'ja dalke? Me korrespondencë. Merr librat e studjo dhe jep provime. Komanda të lejon të japësh provimet. Ka vështirësi patjetër, por do t'i imposhtësh.

— Më bëre të mendohem, Vera.

— Kjo s'është në vete, mor Clirim, — tha plaka.

— Leje, moj, rehat djalin! Ai ka gjithë ato halle ushtrie e ti do ta fusësh në shkollë!

— Ma ka mbushur mendjen, nënë, — thashë unë.

Ajo natë më afroi akoma më shumë me Verën. Fjeta pak atë natë. Gjithnjë mendoja për Verën. Sikur të mund të bëhesha shok jete me të! Kur më doli gjumi në mëngjes, vendosa t'ja thoshja haptazi mendimin. Por nuk ja thashë. Kur dola nga shtëpia për të shkuar në repart, ajo më përcolli dhe hymë përsëri në një bisedë të gjatë.

— Njëherë më ke thënë që në shtëpinë time mund të thuash ç'të duash, Vera, — i thashë unë në mes të tjerash.

— Sigurisht mund të thuash ç'të duash. Pse akoma nuk i ke thënë të gjitha? Ti the se u shteruan bisedat.

— Jo, nuk e kam thënë kryesoren... — i kapa dorën dhe ja shtrëngova.

Edhe ajo ma shtrëngoi ca timen. Tha:

— Cila është kryesorja?

— Të dashuroj, Vera...

Ajo uli kokën. Një zog fluturoi aty afër. Dallgët e detit lëpinin bregun ranor tutje.

Zëvendëskomandant Llukani u transferua. Në vendin e tij erdhi një tjetër i quajtur Thoma Aleksi. Ish i ri nga mosha. Kish një trup të gjatë e të hollë. Siç më thanë, ishte shumë i zoti pér marksizëm. Kish mbarruar akademinë. Sapo shkova në anije, mbasi bisedova me komandantin, më thirri edhe ai në kajutë. Më priti shumë mirë. Biseduam pér shumë çështje.

Në anije vazhdonte preqatitja pér detyrën «A-2». Atë mbasdreke kish trenazh nëpér postet luftarake, «luftë pér jetën e anijes».

Edhe unë ja hyra një trenazhi sipas sinjaleve që jepeshin nga shefi i organit luftarak, që pér mua ish officer Agimi.

Mbas stërvitjes, ne të grupit artistik u mblozhëm dhe bëmë provë numrin e preqatit me parë. Bëmë edhe ndonjë ndryshim. E plotësuam me ndonjë pjesë të re.

Mbrëmjen e kaluam në një atmosferë të kënaqshme. Zëvendëskomandant Thomai ishte entuziast. Ai kënaqej nga harmonia e efektivitet tonë. I pëlqeu koncerti që dhamë. S'e kishte besuar se ne kishim një preqatitje aq të mirë dhe një repertor të tillë artistik. Mua sa vente e më pëlqente më tepër figura e zëvendësit pér punë politike.

Mbas dy ditësh do të bënim qitje me karabinë e automatik. Efektivi ishte preqatitur prej ca ditësh duke bërë stërvitje zjarri dhe shkollë shënimë. Unë kisha vëtëm preqatitjen e shkollës së instruksionit. Qitja me armët e këmbësorisë përbën një element të rëndësishëm të preqatitjes luftarake të efektivit.

Në mbledhjen e ekuipazhit çonjeri u zotua të dalë shkëlqyeshëm. Qitja e mirë varet nga vlerësimi që i bëhet punës. Kjo nuk është çështje fati, siç thonë disa.

Mua më brente meraku se mund të mos dilja mirë, nga shkaku se s'kisha bërë shkollë shënimë. Por u mobilizova i téri. Fjalët e komandantit «Sa më shumë plumbë në shenjë tanë në kohë paqeje, aq më shumë plumbë në gjoksin e armikut në kohë lufte», m'u nguliten në mendje.

Poligoni ish larg repartit, ndaj vonuam një kohë të gjatë për të shkuar. Kaluam një pyll me lloii-lloii drurë dhe shkurre. Vend piktoresk. Nëpër degët e drunjëve cicéronin zogjtë. Bari i njomë të gëzonte sytë. Poshtë nesh shtrihej deti i pafund, në sipërfaqen e të cilët vegonin nga rrezet e diellit ca rrudhëza të imta, të shkaktuara nga puhiza e atij mëngjezi. Anjet e peshkimit ktheheshin nga gjuetia e natës me hambarët plot. Asnjëherë s'më ish dukur më e bukur natyra sa atë pasdreke. Vendi ku qëllonim ish një shpatinë e zhveshur nga drurët. Na ndante prej tij një lugine përroi. Atje ishin vendosur tabelat me shënjet përkatëse të piktuvara në ca fletë të mëdha kartoni. Atje ku ishin tabelat, kishte hendeqe të thella, ku fshiheshin detarët që mbanin tabelat.

Sa më tepër afrohej çasti i qitjes, aq më shumë emocionohesha. Zura të frikohem nga ky emocion. Ndofta do të më pengonte.

Shefi na bëri një kontroll paraprak rrith pregatitjes së zjarrit, na pyeti për të dhënat taktilo-teknike të armës që kishim. Skuadrat e para vazhdonin qitjen. Rezultatet ishin të kënaqshme. I erdhi radha edhe skuadrës sime.

Nënoficer Bektashi dha komandën:

— Skuadra nën komandën time, në vijë të zhërvjellët për një mblidhuni! ... Djathtas ktheu! ... Drejtum poligonit, para marsh!

Si shkuam dhe zumë vendet e caktuara, nënoficeri vijoi:

Skuadraaa! Drejtum tabelat me shenjet gjysmëgjoks, barkas, me tre fishekë armët mbush!

Zura pozicionin, futa tre fishekë në armë sipas rregullit dhe reportova:

Shoku nënoficer, detar Haka gati për qitje!

Kështu rapportuan të gjithë. Pastaj dezhurni i poligonit dha sinjalin me bilbil. Tabelat u ngritën dhe figurat e njerëzve të zez gjysmëgjoks sikur na u kërcënuan. Sipas këshillave të oficerëve unë përpinqesha të qëndroja shumë gjakftoftë në atë çast. Befas u dha komanda:

— Në shëeënje zjarr!

Duke mbajtur frymën, nisa të shtyj me gisht këmbë-

zën e shkrepjes pak edhe pak ... edhe pak ... deri sa u dëgjua krisma e pushkës. Raportova:

— Shoku nënöficer, detar Haka mbaroi qitjen me një fishek.

Përsëri u dha komanda e mëparshme. Përsëri kryem ato veprime derisa mbaruam me tre fishekët. Kur dhamë raportimin e fundit na u dha komanda:

— Armët zbraz!

— Skuadraaa! Çou!

U ngritëm dhe prisnim me ankth rezultatet. Dhe ja, më në fund, ai që kish tabelën time, mbas pak filloj të tundë flamurin e kuq. Një herë ... dy ... tre! ... Të tre plumbat në shenjë. Uh sa kënaqësi! Sa të lehtësuar e ndjeja veten!

Atë mbasdreke, shokut tonë, Vangjelit, i erdhi një telegram. Nusja e tij kishte lindur djalë dhe ish në gjendje të mirë shëndetësore. Ai u bë shend e verë. Së bashku me të, dhë ne. E uruam të gjithë me radhë.

— Ai ka për t'u bërë marinar me siguri — tha Nikua.

Të gjithë qeshëm njëheri.

Komandanti e thirri dhe tha:

— Sapo të mbarojmë detyrën kryesore, mbasnesër do të të nis te shtëpia. A të bëhet gjatë gjer atëhere?

— Jo, shoku komandant, mjafton që kam gruan mire. Po të jetë e nevojshme, nuk vete fare në shtëpi.

— Do të shkosh patjetër; veç duhet të jesh dhe në dhënjen e detyrës kursore.

— Si urdhëron, shoku komandant.

Kurse unë propozova në kolektiv:

— Shokë, unë mendoj t'i pregatisim një dhuratë të thjeshtë Vangjelit për marinarin e vogël.

— I ke rënë më të — më tha Nikua.

— Dakord jemi! — aprojuan të tjerët.

Unë mblodha një sasi lekësh nga të gjithë shokët dhe blemë në dyqan një palë tuta dhe një palë këpucë të vogla. Kur ja dorëzuam Vangjelit, unë e Nikua i thamë:

— Një dhuratë e thjeshtë nga kolektivi i anijes. Jetë të gjatë djalit dhe nuses sate!

Dhurata i erdhi e papritur, ndaj mbeti i habitur.

-- U jam mirënjohtës, o shokë, por më vjen shumë rëndë se këto kanë kushtuar. Ju jeni ushtarë...

— Po të flasësh edhe një herë, do të fyesh kolektivin — i thashë unë. — Kjo është vetëm një dhuratë simbolike.

Vangjeli u mallëngjye.

Në kontrollin e detyrës kursore «A-2» përveç oficerëve të anijes sonë kishin ardhur edhe komandanti i grupit, inxhinieri mekanik i repartit, dy komandantë të tjerë anijesh dhe një oficer nga shtabi i flotës.

U dha sinjali për fillimin e dhënjes së detyrës kursore. Anija për një kohë rekord u çakostua nga bantina dhe doli në det të hapur. Koha ish në favorin tonë. Deti ish i qetë, «vaj» si i thonë detarët. Ta kish enda të lundroje atë ditë.

Befas u dëgjua sinjali «Alarm avarie». Unë qëndrova gati për të marrë vesh ç'do të ndodhte. Mbas pak m'u dha njoftimi:

— Bordi i majtë, brinja 37... depërton ujë!

Kjo do të thoshte se në atë vend supozohej të kish rënë ndonjë predhë topi dhe të kish shpuar bordin e hekurt të anijes. Tani duhej zënë «vrima» në mënyrë që të mos fuste ujë. Unë e caktova ku binte vendi i «avarisë». Ai binte në një vend që nuk dija si mund të zihej. Të fusje ndonjë kunj druri që i përshtatej vrimës së predhës nuk mundja, për arësyse se përballë «vrimës» ndodhej një kuti e madhe kabllosh të sistemit të çmagnetizimit të anijes. Atëherë mora një jastëk avarie dhe ja vura vrimës, e shtrëngova me dy tri pyka dhe raportova:

— Në brinjën 37, bordi i majtë, avaria u evitua!

Erdhi inxhinieri mekanik dhe shikoi punën që kisha bërë. U ra atyre pykave me majën e këmbës. Aq deshën ato dhe ranë.

— Kaq fort e paske zënë avarinë? Kështu e ke sığuruar që të mos depërtojë uji? — më pyeti, i vrejtur, në fytyrë.

Unë, që e pashë sa keq ish bërë ajo punë, s'bëra zë

fare. Ç'mund të thoshja? Ai më urdhëroi të zija dhe një herë avarinë. Unë u mundova me të gjitha forcat e mia për ta siguruar mirë punën, po përsëri inxhinieri ngeli i pakënaqur. Prap më urdhëroi ta përsërisja atë veprim. Më në fund, avaria u zu sipas rregullave.

— Tani mund të raportosh! — më tha inxhinieri,  
— por jo si më parë. — Si më vrejti njëherë me vëme-ndje, më pyeti:

— Sa kohë ke që shërben në anije?

— Kam ardhur në vjeshtën që kaloi.

— Ke bërë ndonjëherë stërvitje «Në luftë për jetën e anijes»?

— Fare pak kam bërë, shoku oficer.

Pas pak, m'u dha varianti i avarisë në këtë mënyrë:

— Në brinjën 36, bordi i majtë, nën vijën e galizhimit, depërtton ujë... lokal u mbyt!

Hapa lokalini e matësit të distancës, ku ish dhënë avaria po ç'të shihja? Ishte mbushur gati plot me ujë!

«Si ndodhi kjo? Kush ma mbyti lokalini dhe unë s'munda ta diktoja?» thosha me vete.

Uji vazhdonte të futej me furi nga sistemi i përmbytjes së anijes. Dola me vrap dhe kërkova ndihmën e skuadrës së avarisë, por edhe ajo ishte zënë së tepërmësi në avarira të tjera. S'kishte mundësi të më ndihmonte. Kërkova motoriston e tretë dhe hidroakustikun e dytë, me të cilët duhej të punoja sipas rolit luftarak. Ata erdhën pas pak sekondash, por s'kishin ç'të bënин pa pompa për nxjerrjen e ujit. Motoristi u zhyt në ujë dhe i futi vrimës një tufë lecka.

— Na sill dy kova që të shterim ujin! — tha pastaj.

Si solla kovat, raportova:

— Në brinjën 36, bordi i majtë, avaria u zu! Vazhdojmë tharjen e lokalit!

Tërë ai ujë s'mund të hiqej shpejt me kova.

— Do të vazhdojmë kështu gjersa të na vijë në ndihmë pompa — tha motoristi.

Djersët na shkonin çurk. Ndërkohë, erdhi skuadra e avarisë me pompën. Ajo iu fut punës. Uji u shterua për pak minuta. Unë mendoja se si do të ishte hapur

sistemi përbrytës i lokalit. Pyeta shokët, po asnjeri s'dinte të më tregonte gjë. Më në fund mora vesh se avarinë e kish shkaktuar inxhinieri. Ndërsa unë rropatesha për të zënë avarinë e parë, ai kish përfituar nga rasti të hapte rubinetin e përbrytjes së lokalit.

— Duhen bërë sytë katër, — më tha kryemotoristi — që ish dhe komandanti i skuadrës së avarisë.

Ndërkaq, u dha njoftim tjetër nga vendkomanda kryesore.

— Në kubrikun e parë të fjetjes, zjarr!

Bashkë me motoristin e tretë, mora pompën e zjarfikësve dhe vrapiuam në vendin ku kishte rënë zjarri (atje q'është e vërteta s'kish zjarr). Veprimin tonë na e kontrolloi një nga oficerët e inspektimit, i cili tha:

— Mirë jeni prengitur për ta shuar zjarrin! — dhe pas pak shtoi: — Po sikur të mos i kishit këto mjete, si do ta shuanit?

— Do t'i zinim fryshten me ndonjë mushama ose me batanie duke kryer këtë veprim me shpejtësi; zjarri do të shuhej dhe ato s'do të dëmtoheshin — u përgjegja unë.

— Po sikur zjarri të binte në vende jo të rrafshta, ku s'ke mundësi të bësh këtë punë?

— Atëherë do ta shuanim duke marrë ujë në det me kova!

Mënyra ishte primitive, por s'mbetet tjetër rrugë. Zjarri shuhet edhe ashtu patjetër.

Oficeri tundi kokën dhe, pasi shënoi diçka në blok, doli nga kubriku, për të kontrolluar postet e tjera luftarake. Në të gjithë anijen valonte stërvitja: «Në luftë për jetën e anijes».

Në bashin e anijes, komandanti i grupit kish ndezur zjarr të vërtetë me karburant, po detarët me mprehtësi e zbuluan dhe e shuan. Variante të ndryshme jepeshin në lokalet e motorëve, në kiç e në hambaret e traleve, po kolektivi që prengitur për këto gjëra. Në përgjithësi iu bëri ballë detyrave.

Kur u ktheva te busulla xhiroskopike, pashë se e

kish ndaluar punë. Djall o punë! Iu përvesha kontrollit në të gjithë sistemin e mekanizmave të aparaturës, kontrollova sistemin elektrik, po s'gjeta gjë. Atëherë thashë me vete: «Taksirat! Duhet të raportoj për gjendjen e postit». Po edhe këtë rregull e prisha, pasi nuk raportova qysh në fillim.

— Alo, ura! Posti luftarak katër nuk është në gadishmëri luftarake. Busulla xhiroskopike nuk funksionon.

— Vetëm tani e zbulove? — pyeti oficer Agimi.

— E kam zbuluar ngahera, por... mendova që do ta gjej avarinë shpejt.

— Shiko se nuk lejohen faje të tilla. Si nuk na raportoke për gjërat që të ngjasin?

— S'e bëra për ndonjë gjë, shoku oficer, por... mendova se po e ndreq vetë difektin pa e bërë bujë...

— Hëéëë, Clirim o Clirim... Shpejt vëre në gadishmëri dhe njofto!

Deshë të thosha se s'kisha ç'ti bëja tjetër, por nuk e çova më gjatë. U solla dhe një herë e i bëra një kontroll të imtë të gjithë aparaturës, por s'diktova se s'diktova ndonjë difekt. Rryma elektrike nuk vinte fare në aparate. Kutia e sigurecave dukej në rregull. Ato, kur digjeshin, dukeshin që larg, për arësyse se nxiheshin, ndërsa tani ishin fare të tejpashme.

— Si u bë puna? — më pyeti oficer Agimi.  
— Nuk kam mundur ta gjej ende difektin, shoku aficer.

— Vazhdo kontrollin dhe gjeje!  
«Ah, mor Clirim, po ta sheh sherrin gjithë efek-tivi! Të gjithë u kanë bërë ballë të papriturave të detyrës kursore, kurse unë jo!» thoshja me vete dhe më vinte të pëlcisja nga inati. Rrobat më ishin bërë tërë ujë nga djersët. Temblat më rrinrin si çekani në kudhër. «Në vend që të jap shembullin si komunist, do mbeten prapa» mendoja.

Ndërkohë atje më erdhë vetë komandanti i grupit dhe më shikoi tek punoja i inatosur.

— Duhet të jesh ca më gjakftohtë — më tha; — duhet gjithashtu të mos nënveftësosh gjërat e vogla.

Kaq tha dhe iku. Unë iu vura përsëri punës. Vendasë të kontrolloj të gjitha sigurecat me tester, mbasi s'kisha ç'të bëja tjetër. Atëhere e gjeta difektin. Dikush kish këmbyer një sigurecë me një tjetër të skaduar. Ajo ish e këputur nga brenda, por nga jashtë dukej në rregull.

— Posti luftarak katër u vu në gadishmëri të plotë luftarake! — raportova entuziast.

Pastaj mora vesh se këtë gjë ma kishte punuar vetë komandanti i grupit. Ai e kish ditur se s'do të më shkonte mendja ta gjeja atë difekt, ndaj kish dërguar njerin nga oficerët të më ndërronte sigurecën pikërisht kur unë punoja me avarirat e tjera.

Mua m'u duk se i kisha humbur të gjitha pikat nga që e gjeta difektin me vonesë, por s'qe puna ashtu. Komanda ishte kënaqur që unë e kisha vënë në gadishmëri postin luftarak.

Përveç llojeve të tjera të stërvitjes, bëmë njëmbëdhjetë herë akostim e çakostim të anijes nga bankina dhe dalje nga porti, derisa, më në fund, kolegumi inspektues u bind për shprehitë që kish fituar efektivi. Udhëheqja e mprehtë e bocmanit na ndihmoi në çdo situatë.

Në orën katërmëdhjetë, komandanti i grupit njoftoi komandën e anijes se e kish marrë detyrën. Atëhere u kthyem në bazë shend e verë.

Në mbrëmje komandanti na dha konkluzionin e detyrës.

— Tani — vazhdoi komandanti — do të shikojmë çështjen tjetër: bashkëzëvendësimi në postet luftarake të shuhet ekuipazhi, posti luftarak të mos mbetet bosh, të mos ndërpitet veprimitaria luftarake e anijes. Është mirë që detari të dijë të kryejë detyrën në të gjitha postet luftarake të anijes. Nuk themi që ai të bëhet teknik për të gjitha, po të dijë t'i përdorë, ka mundësi. Sido që të jetë, në dy a më tepër poste luftarake duhet të dijë të manovrojë çdo detar... — Komandanti heshti ca, pa-

staj vazhdoi: — Tani e keni fjalën ju. Mendohuni mirë se q'punë mund të bëni, pastaj për zotimet tuaja do të mbajë shënim zëvendëskomandant Thomai. Tani kush e do fjalën?

U mata të ngrihesha, por ma preu fjalën Alekuat:

— Me leje?

— Hajde, Aleko! — ja priti zëvendëskomandant Thomai.

— Unë zotohem që përveç specialitetit si hidroakustik, do të përvetësoj edhe specialitetet si elektricist, artilier, minjor, kuzhinier, sinjalist.

— Shumë mirë! Pesë specialitete! — tha zëvendëskomandant Thomai.

— Një minutë, zëvendëskomandant Thomai — ndërhyri komandanti. — Shikoni, mor shokë detarë! Në zotimet tuaja duhet të ngarkoheni me gjëra problematike, me specialitete të reja për ju dhe të ndërlikuara. Alekuat vetëm një specialitet u angazhua të mësojë, jo pesë. Elektricist ka ditur ngaherë, se ka të bëjë me zanatin e tij, kurse kuzhinier e ka ditur që pa ardhur në ushtri. Të bëjë gjellën, të lajë, të qepë duhet të dijë çdo luftëtar. Vetëm specialitetin e sinjalistikës ka marrë si diçka të re e problematike.

Prapë u bë heshtje. Unë s'u ngrita të flisja shpejt.

Kësaj here foli Bektashi.

— Unë do të mësoj specialitetet radiolokator, elektricist, artilier, hidroakustik, elektroshturman dhe motorist.

— Ky ka folur bukur! — tha komandanti. — Por është ngarkuar shumë. Duhet të bëjë punë intensive për të përballuar vështirësitë për të fituar.

— Ka shkollë boll ai, shoku komendant. Ja bluan truri të gjitha — tha Nikua buzagaz.

— Sado shkollë të kesh, këto janë gjëra të reja, — tha zëvendëskomandant Thomai.

Mbas Bektashit folën Sadri Hoti dhe Vangjeli.

— Unë do të përvetësoj të gjitha specialitetet e anijes — tha Vangjeli entuziast.

— Vangjeli është rrëmbyer nga që i ka lindur gruaja djalë — tha zëvendëskomandant Thomai. — Do t'i shkodjalë

jë nesër gruas duarplot... Prit, ore Vangjel, se është një fjalë goje...

— Jo, shoku zëvendëskomandant, unë që tani kam mësuar specialitetet motorist, kimist, kuzhiner, sinjalist, artilier dhe radist. Më e vështira për mua ka qenë radio-telegrafia, transmetimi me alfabet «Mors».

Komandanti nuk foli, po tundi kokën në shenjë apro-vimi dhe bindjeje për fjalët e Vangjelit.

Ndërkaq e ngrita dorën unë.

— C'na thua ti, Çlirim? — më pyeti zëvendëskomandant Thomai.

— Unë zotohem të përvetësoj specialitetet radist, elektricist, sinjalist, artilier, minjor, radiolokator, hidro-akustik dhe...motorist.

— Si vështirë e nxore këtë të fundit — tha zëvendëskomandant Thomai.

— Më duket si më e rëndë.

— Mos u ngarko me ato që s'i bën dot.

— Ngarkohem se e di që do ta përvetësoj, por ndoshta jo shpejt.

— Ne duam të na thuash në se brenda afatit do të jesh në gjendje të punosh apo jo në postet luftarake të përmendura.

— E pra, po jua them që të gjitha këto specialitete do t'i përvetësoj.

Të gjithë detarët u ngriten dhe u zotuan se do të bëhen në aftë të bënin bashkëzëvendësimë në poste të ndryshme luftarake. Nikua foli në fund:

— Unë angazhohem të përvetësoj specialitetet motorist, elektroshturman, minjor, kuzhiner, artilier dhe... mitralier.

- 26 -

Tani kishim shumë punë. Duhej luftuar për të përvetësuar sa më shumë specialitete për t'u preqatitur përdetyrat e tjera kursore dhe për mirëmbajtjen teknike, le pastaj për aktivitetin sportiv, leximin e librave dhe

grupin diletant. Këto të fundit ishin gjëra që të zbatitnin po sidoqoftë duhesin bërë.

Problemi ynë më i ngutshëm ishte dhënja e detyrës kursole «A-3». Për këtë duhej të dilnim shpesh në lundrim. Kjo detyrë jepej e tëra në det. Tri ditë para se të jepnim detyrën, dualëm të bënim një përpunim të përgjithshëm të saj. Komandanti me qëllim kish gjetur një ditë ndër më të vështirat. Tërë natën kish fryrë erë. Dallgët ngriheshin si male dhe përplaseshin në shkëmbinjtë përtej portit ushtarak.

— Alarm luftarak! — u dha sinjali.

Në momentin që po çakostoheshim, u dha sinjali tjetër:

— Gazi!

Ne të gjithë vumë kundërgazet dhe vazhdonim punë, që ish e nevojshme në çaslet e daljes në det.

— Gazi u zhduk!

Përnjéherësh hoqëm dhe ajrosëm kundërgazet. Po kjo që vetëm për pak.

— Gazi! u dëgjua përsëri.

Ndërkëq u dha sinjali tjetër me anën e zileve që do të thotë «alarm kimik». Bëmë gati kompletet kundrakimike dhe i veshëm shpejt. Anija doli në det të hapur. Befas m'u duk se humbëm në një gropë gjigande me gjithë anije, sikur na përpiu fundi i detit dhe koka ime u përplas pas elektromotorit të ehollofit. Kapa kokën me grushte, si të doja ta qetësoja. Atëhere nga një lëkundje tjetër u hodha përmbyss mbi arkat e veglave rezervë. U vrava mjaft, po s'kisha kohë të mendoja për këtë. Sinjalet jepeshin njeri pas tjetrit me zile e megafon dhe secili duhej zbatuar.

— Rrezik atomi! — u dëgjua pas pak.

Frymëmarrja me kundërgaz na mërziste. Aq më keq ish për mua që duhej të rrija i myllur brenda, ku me vështirësi depërtonte ajri.

«Hiqe valvolën e kundërgazit!» më thoshte një zë i brendshëm.

«Nuk duhet ta heqësh!» më thoshte një tjetër.  
«Hiqe të marrësh frymë lirisht. Nuk do të marrë

vesh gjë asnjeri! Kur të vijë kush, vëre shpejt. Mos e torturo veten pa nevojë».

«Duhet të durosht, se përndrysht në luftë s'do të vlesh. Sa më shumë djersë në stërvitje në kohë paqeje, aq më pak gjak në kohë të luftës».

«Hiqe se luftës s'dihet në ja mbërrin apo jo!»

«Po t'ja mbërrish, do ta kesh keq! Pastaj mendo se këtu të ka prurë populli që kërkon prej teje detyrën. Nënshtroju pa fjalë rregullit të stërvitjes. Detari duhet të mësohet të rrrijë me javë të tëra me kundërgaz dhe me komplet kundërkimik veshur».

Nuk e hoqa valvolën e kundërgazit, as nuk e lirova kompletin kundërkimik.

— Në brinjën 35, bordi i djathë, predhë 45 milimetër, depërtion ujë! — m'u dha njoftim.

Edhe kjo na duhej. Duhej luftuar edhe për zënjen e avarisë. Për të kontrolluar punën time në këtë rast erdhi vetë komandanti. Ashtu si unë, ish i veshur edhe ai me të gjitha paisjet. Shikoi si i kisha vendosur binarët dhe kunjin e avarisë. Puna i pëlqeu.

— Si e ndjen veten? — më pyeti.

— Mirë, shoku komendant — u përgjegja.

— Qëndro, se e ke vështirë këtu brenda. Kjo mund të të duket si diçka qesharake, po është edhe e domosdoshme për t'u bërë — thoshte me një zë të turbullt në-përrnjet kundërgazit. Sakaq doli përjashta.

— Atomi majtas! — u dha sinjali pastaj.

Të gjithë detarët u strehuan nëpër objekte të ndryshme të anijes, që të mos dukeshin në bordin e majtë andej nga supozohej të vinin rezatimet e bombës atomike. Djersët kallonin rrëke nën kompletet kundërkimike të detarëve.

— Atomi djathtas!

Edhe për këtë sinjal duhej vepruar si për të parin.

— Alarm ajror!

Të gjitha tytat e topave u drejtuat nga qelli gati për zjarr para kohës së caktuar për këtë qëllim. Efektivi ynë kish arritur përsosmëri në kryerjen e detyrave. Të

gjitha urdhërat dhe variantet që jepeshin, zbatoheshin para normës së caktuar nga rregullorja e anijes.

U bënë disa orë që ne merrnim frymë nëpërmes kusisë filtruese të kundërgazit. Isha lodhur shumë e djer-  
situr, po nuk e lëshova veten. Kujtoja Verën. «Ti punon për të prodhuar bukë, Vera, kurse unë punoj për të mbrojtur atdheun. Ti derdh djersë, Vera, nuk është e lehtë puna jote. Po ti je e qetë dhe e sigurtë. Djersët tonë në stërvitje të mbrojnë ty dhe shoqet e shokët e tu. Vuajmë ne që të gëzoni ju, që të jesh e lumtur ti, Vera, që të punosh e të mësosh. Kështu si unë do të veprojnë nesër të tjerët, kur unë do të punoj dhe do të gëzojmë së bashku në fshatin tim. Puno Vera, puno e më zbardh faqen edhe mua. Armiqtë vringëllojnë armët kundër nesh, po ne armët i kemi gati».

— Pushim alarmi! — u dha sinjali. — Filloi deaktivizimi i anijes!

Shkova duke u mbajtur gjer në banjo, ku ishte skuadra sanitare që do të na hiqte kompletet kundërkimike. Si m'i hoqën sipas rregullave, pashë se bluza e pantallonat më kullonin djersë.

— Shko ndërro rrobat një herë! — më urdhëroi oficer Agimi. — Do të ftoshesh!

Mbasi u ndërruam, u bëmë gati për në mensë.

Sapo mbaruam së ngrëni drekën, ra alarmi. Përsëri gazi. Përsëri atomi. Përsëri djersë e mundim.

— Pregatituni për hedhjen e tralit elektromagnetik!  
— u dha komanda.

Bobooo, çfarë pune! Në ato kondita të hidhje tralin? Duke u përkundur e duke u mbajtur me dorë, u rreshnuam në këtë nëpër vendet e caktuara. Dallgët e shkumëzuara rrinjin bordin e anijes. Detarët mbaheshin e qëndronin.

— Shokë! — thirri — Vangjeli. — Trali elektromagnetik do të hidhet në ujë! Kujtoni zotimet tuaja! Kjo punë bëhet lehtë në ditët pa erë, në detin e qetë, po duhet bërë sot, se armiku nuk na sulmon vetëm ditëve të mira. Po sikur të jetë minuar vërtet deti, ç'do të bënim?  
Do ta linim kështu? Jo! Pra, përpara, shokë!

Ndërkaq, minjorët kapën kokën e tralit me bovën fillestare dhe trali u lëshua në det. Elektriçisti i jepte rrymë arganos së tralit duke vështruar rregullatorin si e lypte situata. Detarët e tjerë, duke pasur parasysh rolin luftarak, afronin bovat, lidhnin tralin me kavot e çelikta me anë të morsetave. Era fërshëllente. Dallgët ulurin. Flamuri valavitej në kicin e anijes. Të dukej sikur ai na jepte kurajë.

«Jepni, shokë detarë! Shikomëni mua si qëndroj në tufan! Jini të pamposhtur! Unë jam simbol i pamposhtjes! Qëndroni! Kryejeni detyrën!».

— Nëpër vende qëndroni për mbledhjen e tralit elektromagnetik! — buçiti komanda nga megafonët e fuqishëm.

Brenda pak minutave, trali ish në vendin e tij në hambar. Pa filluar ende të shpërndaheshim nëpër postet luftarake, u dha komanda tjetër e papritur:

— Nëpër vende qëndroni për hedhjen e tralit elektromagnetik!

Përsëri të njëjtat veprime. Kësaj here trali u lëshua në ujë tri minuta më parë.

Komandanti me zëvendëskomendant Thomain i bëri një kontroll të imtë stërvitjes në anije dhe, si u bind që qëllimi ishte arritur, dha urdhër të pushonte stërvitja.

Mbasdreke vonë u kthyem në bazë.

Atje na njoftuan se kishim shërbimin e gadishmërisë. Për njizet e katër orë nuk mund të luanim nga anija, për arësyse se çdo e papritur që të ndodhë, ne duhej të ishim në gjendje që të dilnim shumë shpejt në det.

Në kinemanë e repartit, po shfaqej një film i bukur dhe ne na mbeti merak që s'e pamë, po s'kishim q'të bënim. Detyra mbi gjithshka. Dëgjova pak nga kuverta muzikën e filmit, pastaj u futa në kubrik. Detarët merreshin me aktivitete të ndryshme. Nja dy-tre veta luanin shah në një qoshe, disa dëgjonin në heshtje radiomontazhin e operas «Mrika» të Prenk Jakovës, një tjetër kish hapur ca skema dhe i ndiqte me një laps plumbi, por s'i dilte ajo që kërkonte.

Detyrën «A-3» e dhamë një javë mbas afatit. Për të marrë detyrën erdhi edhe një ekip nga komanda e flotës. Po në ato ditë, aparati politik mori në analizë gjendjen e disiplinës dhe të jetës së anijes sonë. Konkluzionet qenë të gjitha të mira. Po ajo që u tërroqi vëmëndjen të gjithëve qe puna e Nikos.

Një ditë e thirri në zyrë zëvendëskomandanti për punë politike.

— Vendimi i komandës — tha ai — jepet ashtu siç merret. Komanda e vendos dhe e shpall para efektivit pa e vënë në diskutim. Kurse ne, jashtë këtyre rregullave, do të të pyesim ty për një vendim. Kemi menduar të të shpërblejmë me shtatë ditë leje, ose me letër pranë familjes për punën e mirë që ke bérë.

Nikua u mendua. Të dy variantet ishin térheqëse.

«Qejf kam të shkoj pranë familjes me leje se më ka marrë malli, por më mirë është letërlavdërimi. Kjo do të vejë në dorën e këshillit të lagjes dhe do të lexohet vesh téré lagjja që unë nuk jam më ai që kam qenë! Letra do ta gézojë shumë familjen time, që më do aq shumë», tha me vete.

— Ç'mendim ke ti, Niko? — e pyeti zëvendëskomandanti.

— Dëshira ime është t'i shkruhet letër familjes. Ky do të jetë shpérblimi më i madh për mua. Me atë të kaluar që kam pasur unë, do të ish diçka e mrekullueshme kjo.

— Kështu do të bëjmë, ahere!

— Jam shumë mirënjohës, shoku zëvendëskomandant — tha ai i mallëngjyer.

Letra u lexua para efektivit të anijes. Më ngelën të paharruara këto fjalë që shkruheshin në letër (letra ish e gjatë).... Biri juaj u shkëput tashmë fare ngajeta, e tij e kaluar dhe hyri në gjirin e shoqërisë sonë, duke u bërë një kuadër i vlefshëm për mbrojtjen e atdheut dhe vër shoqërinë në përgjithësi. Ai ka arritur suksese të

mëdha në preqatitje luftarako-politike. Mori teserën e anëtarit të Bashkimit të Rinisë dhe, së shpejti, kemi bësim të bëhet edhe komunist... Ne si komandë ju përgëzojmë për këto fitore të djalit tuaj që janë edhe tua-jat njëkohësisht...»

Tek lexohej letra, Nikua herë skuqeje e herë zverdhej. Nuk i vinte mirë që përmendeshin ato të kaluarat, por ish tepër i gjuar kur dëgjonte lavdërimet që i bënte komanda dhe që shpejt do t'i merrnin vesh prindët.

- 28 -

Tërë dita u shfrytëzua në preqatitje për lundrimin e gjatë. Të gjitha anijet e repartit dhe të flotës në përgjithësi këtë punë bënin: furnizim me ushqime, pastrime e rregullime teknike luftarake. Në mbrëmje u mblodh ekuipazhi në kubrikun numër një. Komandanti foli mbi detyrat jo të zakonshme që u dilnin në këtë lundrim.

Në orën dympëdhjetë të natës ra sirena e anijes në shenjë alarmi të përgjithshëm e mbas saj buçiten qindra zile e sirena nëpër anijet. Të gjitha jepnin të njëtin sinjal. Porti buçiste nga grahmat e fuqishme të motorëve. Anijet, sipas radhës së akostimit, dolën njëra pas tjetrës jashtë portit. Pastaj u ndamë në grupe. Anijet e një grupei shkonin të gjitha në një kurs, duke u prirë anija flamurtare. Deti ishte i mirë. Asnjë farë lëkundjeje s'kishte. Ta kishë ëndë të lundroje në një det të tillë. Mbas bëmë nya tri orë udhëtim, u ndalëm e hodhëm spirancat. U dha urdhëri të bënim pushim. Në orën gjashtë ra zilja e alarmit mësimor. Pas pak, u dha pushim alarmi dhe ne hëngrëm mëngjezin. Pastaj përsëri u vumë në udhëtim. Anijet kalonin varg njëra pas tjetrës pa e prishur radhën. Paksa të anohej njera, komandanti i grupit tërhiqtë vrejtjen nëpërmes radio-trasmetueseve.

- «Shqopaaa», mbaje radhën! Mos ano nga kursi!
- «Shqipja», zbato sinjalet!
- «Boriga», jam «Tërfili». Si më dëgjon? Marrja. Të tillë fjalë dëgjoja nga megafonët në qetësinë e

detit. Gjatë udhëtimit, njëkohësisht zhvillohej edhe stërvitja në bazë anijeje (nënreparti). Sinjalistët dhe vrotuesit në bash e në kic raportonin herë pas here.

— Bordi i djathtë, distanca tetë kabla, kursi 45 duket një bovë!

Pastaj zëri i komandantit të topit:

— Bordi i majtë, kursi gjashtëdhjetë, distanca katër milje, aeroplan armik!

— Topi dyzet e pesë milimetra, gati për qitje!

— Në shenjë, zjarr!

Këto ishin prova që bëheshin natyrisht pa zjarr të vërtetë, po supozohej sikur të ishin objekte të vërteta që duheshin qëlluar. Kështu stërviteshin detarët. Gjatë kohës së stërvitjes, sipas programit të bashkëzëvendësimeve në postet luftarake, unë herë shkoja te topi, herë te hidroakustika, herë shkoja në lokalin e maqinerive e bëja praktikë te motorët, po atje më zihej fryma shpejt nga era e gazeve. Menjëherë ndjeja pështjellim në stomak. Në fakt kisha mësuar mjëft gjëra për motorin: dija ta ndizja, ta fikja, t'i ndërroja vajrat, të manovroja me të sipas sinjaleve që jepeshin nga vendkomanda kryesore. Kisha mësuar dhe shumë gjëra teorerike mbi funksionimin e motorit. Sa për rrjetin elektrik dija që më parë.

Anija flamurtare ndërroi kursin; bëri një rrotullim në drejtim të mesit të detit. Mbas pak u duk sikur humbëm. Bregdeti ynë na u zhduk nga sytë. Në të gjitha anët e horizontit dukej vetëm ujë dhe hapësira qellore e puthitur me detin si një saç fantastik. Vetëm dielli, si një pare sermi, që na rrinte roje mbi kokë, na bënte shoqëri.

Ne vijuam rrugën në thellësi të detit. Tani fati i udhëtimit varej shumë nga aparatet e lundrimit. Do-methënë mua më binte barra kryesore. Unë qëndroja pranë radiopelengatorit dhe dëgjoja sinjalet e radiofenerëve. Një punë e tillë është shumë interesante. Në bazë të sinjaleve që japid radiofenerët, je në gjendje të përcaktosh me përpikëri ku ndodhesh. Secili radiofener ka sinjalin e vet të ndryshëm nga të tjerët. Mbas-

dreke vonë, eholloti tregonte thellësira të mëdha, që unë s'kisha parë ndonjëherë. Anijet vijonin lundrimin e shpejtë përpara. Herë pas here takonim vaporë tregëtarë dhe anije luftarake.

Të nesërmen, pamë një diçka të madhe si një ishull të zi, me disa si ishuj të vegjël si shkëmbenj përreth. Ishte një flotë e huaj. Sakaq, pamë lëvizjen në ajër të dy-tre aeroplanëve. Si dukej, ishin të asaj flote.

Ku po shkojmë, shoku oficer? — pyeta Agimin që rrinte mbi hartat detare në kabinën e shturmanit.

— Ja, në detin Mesdhe!

— Po sikur të ndeshemi me ato anijet?

— S'kemi pse të ndeshemi. Ne jemi në punën tonë, ato në të tyren. Këtu jemi në ujërat ndërkombëtare. Kemi të drejtë të lundrojmë lirisht. Kjo flotë e huaj ishte bërë gati për të sulmuar Shqipërinë tonë në bashkëpunim me Teme Sejkon. Po ne s'ja patëm frikën atëhere dhe s'i kemi as tanë. Nuk na trembin anijet e tyre aeroplanmbajtëse as kryqëzorët. Ne kemi mjete e forca të tilla që t'i shkatërrojmë fare, po të guxojnë të na sulmojnë.

Anija jonë flamurtare ecte po në atë kurs, megjithëse duhej të kalonim pranë anijeve të flotës së gjashtë amerikane. I kaluam përbri asaj dhe vazhduam lundrimin sipas programit të komandës.

Në mbrëmje nisi të frynte një erë e lehtë. Por kjo erë mjaftonte për të ngritur tallazet në atë det të pa-fund. Gjendja e detit nisi të keqësohej.

— Kështu e ka ky djall det — tha komandanti. — Tani bëhet mirë, tani bëhet keq. Duhet të jemi të pregatitur gjithnjë për tufanin. Deti është si puna e qenit te fjala e urtë: «Kur të kujtosh qenin, kap shkopin». Edhe kur të dalësh në det preqatitë mirë për çdo gjë. Po anijet tona përballojnë çdo tufan. Dikur lundronin me anije druri, dhe në çdo lundrim në det të hapët parashihnim rreziqe. Katër ballë det të kishte, ato mbyteshin.

Tërë natën ecëm po në atë kurs. Deti egërsohej e ulurinte gjithnjë e më shumë. Edhe pse tani kisha fituar, si të thuash, një farë imuniteti kundër dallgëve, deti më

zuri. Edhe u lodha së tepërmë. Të nesërmen deti ish tërbuar më tepër. Dallga arrinte të përplasej deri te ura e komandimit. Sipas sinjaleve të radiofenerëve, kishim arritur qendrën e Mesdheut. Dëgjoheshin radiofenerët e pellgut të Mesdheut, të brigjeve të Italisë, të vendeve të Afrikës Veriore e veçanërisht të Port-Saidit. Nga ora nëndë, u dha urdhër me radiogram që të ktheheshim mbrapa; u dha urdhër gjithashtu të ecnim në qetësi, pa stërvitje. Vetëm shërbim me ndërresa dhe zë-vëndësime në postet luftarake. Moti përjashta ishte i trazuar. Herë vrërej, herë kthjellohej, herë binte shi. Po era s'na ndahej, ndonëse s'ishte shumë e fortë. U ula mbi batanie pranë busullës xhiroskopike dhe po mendohesha. Befas u hap radioia dhe u dëgjua uvertura e operetës «Rrjetë e artë». E kisha dëgjuar edhe të tjera herë këtë pjesë muzikore, po kaq s'më kish pëlqyer kurrë. S'ka gjë më të këndshme se muzika në det në momentet e loddhjes psiqike e trupore. Mbasë mbaroi ajo pjesë, u transmentuan fragmente nga opereta «Lejlaja».

Atë natë qëndruam në spirancë. Atje bëmë një mbledhje të ekuipazhit kushtuar qitjes me artileri, që do të zhvillohej të nesërmen në poligonet detare shumë larg nga vendi ku ishim.

— Ky element i stërvitjes e kurorëzon tërë punën tonë të bërë gjatë shtatë diteve — tha komandanu.

Artilierët u zotuan të gjithë të qëllojnë në shenjë dhe të kursejnë predhat. Topat automatikë kishin në dispozicion nga dhjetë predha për të qëlluar. Në qoftë se tre nga këto futeshin në shenjë, qitja do të konsiderohet e shkëlqyeshme.

— Unë — tha komandanti i topit të bashit — zotohem të kursej shtatë predha.

Gjithë efektivi duartrokiti përnjëherësh.

— Pse, me dorë do t'i shpiesh ti atje, o? — e pyeti Nikua që e kishte zakon të fliste ashtu sa për të shkaktuar humor.

Ndërkëq u ngrit shenjuesi i njërit nga topat automatakë të kicít dhe tha:

— Edhe unë zotohem të kryej qitjen me tre predha.

Pastaj u ngritën edhe ata të topit tetëdhjetë e pesë milimetresh e të tjerë, të cilët, të fryshtëzuar nga shembulli i të parit, morën shumë zotime për kursimin e predhave. Dita e nesërme s'ishte dhe aq e përshtatshme. Deti ishte mjaft i trazuar. Që në orën katër të mëngjezit u nisëm për në poligonin e qitjes. Në orën njëmbëdhjetë pritej shfaqja e shënjos. Datarët provonin emocione të vrullëshme, një ankth të padurueshëm.

— Si do të dal në qitje?

Kjo ishte pyetja që i bënte vetes secili. Dhe ja, më në fund, një rimorkiator detar u duk si të ish ndonjë delfin i zi. Pas pak, figura e tij erdhi duke u zmadhuar dhe, lidhur mbas tij, u duk shenja që duhej të qëllonim. Ishte një si trap i ndërtuar me fuçi të salduara dhe në direkët e ndërthurur me binarë kish një rrjetë të bardhë cep më cep; kish pamjen e një barke me vela. Pra kjo ishte «anija armike» që duhej qëlluar.

«Predhën e parë në bordin e anijes armike» ishte hedhur parulla.

Ne presim me ankth ardhjen e anijes në koordinaten e caktuar. Më në fund, erdhi çasti.

— Nëpër vende qëndroni, për fillimin e qitjes! — buçiten megafonët.

Rradhën e kishte topi i bashit.

— O burra, Isa, për të realizuar zotimin! — tha shefi i artilerisë.

U dëgjua raportimi nga ana e sinjalistikët që zbuloi anjen «armike».

— Bordi i majtë, distanca pesë kabla, kursi 127, një anije armike!

Isai urdhëroi:

— Kundër katerit armik, distanca pesë kablo, kursi 127...

— Shenja u kap! — raportoi shenjuesi pa mbaruar mirë Isai.

— Zjarr! — ushtoi zëri i komandantit të topit.

Tri krisma të llahtarshme u përhapën nga bashi i anijes. U drodh anija, malet ushtuan. Pastaj heshtje.

— Predha e parë në shenjë!.. Edhe e dyta!.. Edhe e treta! — e prishi heshtjen vrojtuesi.

— Zjarr ndalo! — u dha urdhëri. — Anija «armike» u asgjësua me tri predha në bord. Të tjerat kursehen!

Pas pak, i erdhi radha edhe topit ku ish shenjues Shyqyri Pëllumbi. Ne ndiqnim me vëmendje veprimet e tij.

U dha komanda për të hapur zjarr. Shenjues Shyqyriu shkeli pedalin. Predhat njera mbas tjetrës ranë mbi «anijen armike». Malet e Shqipërisë bregdetare shungullonin si të lemerisura. Të gjitha anijet kryen qitjen për një kohë të shkurtër.

Më në fund erdhi radha për të bërë qitje sipas bashkëzëvendësimeve në postet luftarake. Pra, duhej të matësha edhe unë si shenjues i topit automatik. Po afrohej çasti dhe zemra më rrihte nga emocioni, kurse në qitje duhej të isha i qetë. Komandanti i topit më dha variantin. Unë, me syrin në shenjestër dhe me volante në dorë, përpinqesha të bashkoja shenjën «plus» me bordin e «anijes armike», po hasja vështirësi të madhe se «plusi» më dikte nga lëkundjet e anijes. Po më në fund ja mora dorën, edhe pse u vonova.

— Shenja u kap! — raportova dhe dëgjova komandën:

— Zjarr!

Shtyra pedalin dhe veshët më buçiten. U çlirova nga ankthi vetëm kur mësova se nga tri predhat, me të cilat kisha qëlluar, dy kishin rënë në shenjë.

Mbas qitjes ne u tèrhoqëm në një anije për të parë qitjen e gjuejtësve detarë. Gjëja më interesante për mua qe qitja me bombat reaktive, se s'e kisha parë ndonjë herë. Më dukej sikur shihja katjushat, që kisha parë në përfilma. Ishin ca gryka zjarri shumë të shkurtëra të ngjitura njera me tjetrën. Në ato gryka të shkurtëra e të gjera ishin vendosur bombat në fjalë. Vetëm një të shtypur suste bënte minjori, e ato fluturonin në ajër. Dhe, sipas gradimit që kish bërë minjori, sulmonin objektivin e caktuar. Kur zbraseshin, dukej sikur tërë deti ngrihet dhe shkumonte. Pastaj u erdhi radha minave. Kjo ishte një punë shumë delikate, që donte kujdes të jashtëzakonshëm, se një pakujdesi e vogël mund të shkurtonte jetë njerëzish.

Skuadra minjore me Vangjel Petën në krye u hodh

në lanxhë (këtu duhej përdorur vetëm lanxha) dhe u nis në drejtë minës. Ne shikonim me ankth.

— Hoooo, hop! Hoooo hop! — komandonte vozitësit Vangjeli.

Mua më sulmuan ca mendime ogurzeza. Përfytyroja gruan e Vangjelit me fëmijë të vogël në duar tek shikonte burrin që shkonte drejt minës dhe më dukej sikur i thoshte: «Pse vete atje, Vangjel? Ktheu, pér kokën tênde! Pse nuk e qëlloni minën me top nga anija, Vangjel?»

Vangjeli i jepte lopatës dhe i përgjigjej së shoqes: «Duhet bërë kështu, që të pregetitemi pér luftë. Atëhere ndoshta s'do të kem mundësi të qëlloj me top. Po ti mos u bëj merak, se të tilla prova kam bërë sa herë unë!»

Lanxha arriti te mina. U shqetësova shumë. Të gjithë qëndronim si statuje të ngrira. Komandanti vrente me dylbi. Lanxha u kthyte nga ne.

— Hooo, hop! Hooo, hop! — dëgjohej zëri i Vangjelit.

Edhe unë lëvizja duart sikur të kisha lopatat në dorë. Tymi qëndronte pezull mbi minën dhe sa vinte e dendësollëj. Kur lanxha po i afrohej bordit, u çiruam nga ankthi. Tani minorët kishin shpëtuar. Ndërkaj, një tym i zi u ngrit drejt qiellit dhe një si bubullimë shurdhuese u dëgjua e ushtoi nga malet përtej.

— Shumë mirë!

Ra sinjali pér të ngrënë drekë. Buka na ishte mbaruar dhe hanim nga rezervat e anies. Në vend të bukës, hanim galeta. Kuzhinieri na kish bërë kabuni pér drekë.

Mbasdreke nëndetëset zhvilluan qitien me silure. Ajo që më habiste ishte mënyra se si dilte siluri nga bashi i nëndetëses, kur ajo ish nën nivelin e detit. Asnjë pikë ujë nuk futej në lokalin e silurit. Sa me shpejtësi hapej kapaku, dilte siluri dhe mbyllej përsëri, pa i dhënë kohë ujë të futej brenda!

Një ditë më vonë u kthyem në bazë.

— 29 —

Po afrohei festa e 10 Korrikut.

Në një informacion politik që u bë në bazë grupi,

nga zëvendëskomandanti për punë politike i grupit, u fol shumë për këtë jubile. Si foli për disa çështje të gjendjes ndërkombe, zëvendësi për punë politike tha:

— Tani do të lexojmë edhe letrën që na dërgojnë prindërit e detarit Niko Gjoshit, që bën pjesë në dragaminën e komandantit Luftar Bibës.

«Të dashur shokë të komandës së repartit...

Me gëzim të madh morëm letrën që na dërgonit, e cila u lexua nga një shok i këshillit popullor të lagjes në një mbledhje populli. Ky ishte një çast shumë prekës për ne. Ishte një gëzim i madh për familjen tonë. Puna që ka bërë komanda e Partia në repart me djalin tonë, është një punë, vlera e së cilës nuk mund të shprehet. Ne e mbajtëm djalin nëndëmbëdhjetë vjet, e rritëm, e edukuam, i dhamë shkollën, por konceptet tona të gabuara për jetën, për edukatën, përkëdheljet e tepruara e shthurën. Nuk dimë si ta shprehim mirënjojen tonë për forcën tuaj të madhe edukuese, për atë forcë që mundi të bëjë djalin tonë të arrijë sukseset për të cilat na flisnit në letrën tuaj. Kjo na shtyn të kemi një admirim akoma më të madh për ushtrinë tonë popullore, përvjetorin e së cilës do ta festojmë me madhështi me 10 korrik. Ushtria jonë ka fituar lavdi, që nga krijimi i saj. Ajo shpartalloi pushtonjësit e huaj dhe klasat armike dhe na dha lirinë.

Ajo ka dërmuar gjitha komplotet e provokacionet që kanë organizuar armiqtë kundër vendit tonë. Ushtria jonë është bërë dhe një shkollë e madhe edukimi për brezat tonë të rinj. Kush e solli në vijë djalin tonë? Dhe nuk është vetëm djali ynë që u bë njeri i vlefshëm në radhët e ushtrisë. Atje janë edukuar dhe kalitur shumë bij të fshatit dhe të qytetit, të cilët janë bërë të vlefshëm për ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Na lejoni, shokë, që t'ju shprehim falënderimin për nderin që na bëtë me letrën që na dërguat dhe për shërbimin që na sualltë duke riedukuar birin tonë. Na lejoni t'ju shprehim urimet tona të përzemërtë me rastin e jubileut të ushtrisë dhe t'ju urojmë suksese në preqatitjen luftarako-politike. Ashtu si përfyteni ju me dallgët e detit për

të siguruar mbrojtjen e ujërave territoriale të Republikës sonë, përpinqemi edhe ne për të realizuar planin e shtetit dhe për të rritur cilësinë e prodhimit. Nga ana tjetër ne mbajmë edhe pushkën gati dhe nuk i myllim sytë. Jemi gati që, sa po të na lëshohet një zë, të bëhem barrikadë për mbrojtjen e atdheut.

Me nderime dhe respekt të thellë  
Familja e ushtar Niko Gjoshit.

— Urraaaa! — bërtitën përsëri detarët.

Pastaj zëvendëskomandanti për punë politike tha:

— Detarët që bëjnë pjesë në estradën e repartit do të shkojnë çdo ditë në orën katër te klubit i kulturës, se po preqatitet një numër i ri. Gjatë këtyre ditëve do të zhvillohet gara në mes të anijeve për not, vaterboll, vozitje dhe hedhje nga trampolina që janë sporte tonë speciale, pastaj do kemi garat atletike dhe futboll, voliboll e basketboll. Pra, këto ditë do të janë plot aktivitete kulturalo-sportive.

Nga ora një e natës, u dha alarm avarie.

— Çohuni se u copëtuan anijet! — bërtiste nëpër kuvertë dezhurni i maqinerisë. — Shpejt, shokë, se e kemi keq!

Ne dolëm mbi kuvertë të gjithë me rrroba në duar dhe atje nisëm të visheshim. Era ulurinte si e çmendur në direkët e anijeve, sikur do t'i shkulte nga vendi. Nuk qëndroje dot mbi kuvertë po të mos mbaheshe në ndonjë objekt; nga të katër anët dëgjoje zile alarmi, thirrje, britma, kërkëllitje të skeleteve të anijeve. Vardallakët këputeshin njëri pas tjeterit e binin në det. Atëherë bordet përplaseshin trup për në trup. Nga shkapatjet shumë herë prodhoreshin edhe shkëndija.

— Shumë vjet kam në det — tha komandanti i anijes më të afërt, por tufan të tillë s'mbaj mend.

Një grup oficerësh me komandantin e repartit në krye silleshin me elektrofenerë në dorë nëpër bankinë; s'po gjelin dot rrugëdalje. Ahere komandantii i repartit urdhëroi që disa anije të dilnin në det, jashtë portit.

Ndërsa anijet dilnin sipas radhës, ne po përpinqeshim

të mbronim anjen tonë të mos takonte me tjetrën afër saj. Detarët, nén komandën e oficer Agimit, shtynin anjen të largohej. Oficeri komandonte:

— Një, dy, tre, hooop! Nië, dy, tre hooop! Ashtu, djema, se u largua! Gati vardallakët! hooop!

Unë, kuzhinieri dhe Jorgo Qirua rrnim me nga një vardallak në dorë. Këto janë goma skodash të varura në një cimë të trashë, që s'ka djall ta këpusë. Ndërkaq, kuzhinierit i rrëshqitën këmbët dhe kaloi në mes të bordeve në çastin kur era po i detyronte anjet të afroheshin:

— Ooooh! — lëshoi nië të bërtitur.

Unë e kisha lëshuar më përpara vardallakun tim. E kjo ndihmoi që beli i kuzhinierit të mos bëhej palë.

— Jepni, burra, se mbaroi kuzhinieri — bërtita si i çakërdisur.

Fuqia e detarëve ishte e pamjaftueshme për të kundërshtuar forcën shtytëse të erës. Ishim para nië tragjedie të tmerrshme. E shihnim shokun duke u përfytyr me vdekjen dhe s'e ndihmonim dot. Ta tërhiqnim, nuk bënte, ta linim aty, prapë si ta linim? Oficeri bërtiste me të madhe:

— Të gjitha forcat, shokë detarë, në shtytje! Jeeepni!

Dy veta e kishin kapur kuzhinierin për krahësh dhe prisnin të largohezin bordet. Ai rënkonte nga dhëmbjet. Më në fund, forca shtytëse e të dy ekuipazhëve e mundi atë të stuhisë dhe kuzhinierin e çuam lart; e dërguam në infermicrinë e anijes. Ishte në gjendje të rëndë. Kafshonte buzët nga dhëmbjet. Kishte pësuar një shtypje të fortë dhe kishte thyer një brinjë.

Mbas pak na erdhi radha edhe neve të dilnim jashtë portit. Atje hodhëm dy spirancat e bashit dhe atë të kosit dhe u lidhëm mirë. Kuzhinieri ishte keq. Muarëm mjekun me motolanxhë. Ai i qëndronte kuzhinierit te koka.

Po furtuna sjell edhe të këqia të tjera. U dha alarmi në të gjitha anjet. Radiostacionet transmetonin sinjalin «SOS». Kurse nga ana tjetër një PSV lajmëronte se një objekt i panjohur ishte dukur në mes të dallgëve.

— Nëpër vende qëndroni, spiranca të ngrihet! — u dha komanda me translacion. Ne u nisëm menjëherë dhe pérleshja me dallgët filloj.

Kisha ca kohë që më ish mësuar stomaku me dallgët dhe s'më zinte dhe aq, po atë natë më mbërtheu në vend. Tërë ekuipazhi ishte në gjendje të keqe. Deri bocmanin, që ish më i forti, e kish urullosur.

Duke ecur në drejtimin që na ish dhënë, na u shfaq pérpara një si pirg dritash të shumëngjyrshme. Kur u afroam, morëm vesh se ish një vapor i huaj tregëtar, i cili kish përpjekur kallumën me një vapor të fundosur qysh në kohën e luftës së dytë botërore dhe ishte shpuar në tre-katër vende. Ekuipazhi ishte lebetitur fare. Nuk kishin mundur të ndalnin vërvimin e tèrbuar të ujit në anije. Lokali i motorëve ishte përmbytur; motorët edhe kaldaja kishin ndërprerë punën. Uji vërvonte gjithkak. Vaporit i kërcenohej mbytja. Ekuipazhi i vaporit na priti me mallëngjim. Njerézit bërtisin me të madhe. Dëgjoheshin të qara fémtrash.

— Shokë detarë, mobilizohuni të ndihmojmë këtë anije të huaj pa u kursyer!

Puna e parë që bëmë qe lidhja e cimave në vapor dhe rimorkimi. Po kjo s'mjaftonte për të shpëtuar vaporin, që po mbytej. Komandanti u mendua pak. Furtona s'na lejonte të shkonim.

— Elektroshturman! — m'u drejtua me zë të fuqishëm. — Rri pranë ellohotit dhe na trego thellësinë për çdo dy-tri sekonda! Rri i lidhur me mua direkt me anë të telefonit!

Unë shikoja me vëmendje dritëzën e kuqe, që shënone thellësinë dhe tregoja me zë të lartë në mikrofon:

— Dyzet e një metra... dyzet... tridhjetë e nëndë.

Komandanti kish urdhëruar që anija jonë të lundronte me shpejtësinë maksimale, por dallgët na pentagonin shumë. Anijet e tjera të flotës sonë ishin shpërndarë për të kërkuar objektin e panjohur, për të cilin njoftonte PSV-ja.

— ... tridhjetë e dy... tridhjetë e një... tridhjetë  
... — vazhdoja unë.

Kur arritëm në thellësinë shtatë metra, komandanti urdhëroi të vishej bashi me vardallakë e me mjete të ndryshme mbrojtëse. Pastaj dha urdhër të çrimorkiohej vaponi i huaj. Ekuipazhi u lebetit akoma më keq. Si u hoqëm cimat, komandanti i dha anijes ca prapa, duke iu shmhangu me kic vaporit, të cilat i dolëm mbrapa. Uji kish hipur gati deri në kuvertë. Si iu larguam ca vaporit, komandanti i dha anijes sonë përpara dhe, kur bashi ynë zuri në kicin e vaporit, atëhere dha urdhër. Me gjithë forcën përpara!»

— ... tetë... shtatë... gjashtë... pesë...

Atëhere pësova një tronditje të madhe dhe u përplasa me ballë mbi aparatin tregues. Me një përpjekje të madhe të muskujve u mbajta. Tronditja u shkaktua nga ndeshja e vaporit me tokën. Këtë qëllim kish pasur komandanti. Tani vapori ishte ngulur me kallunë në dhë dhe kish shpëtuar nga rreziku i mbytjes. Ekuipazhi i vaporit u qetësua. Përveç njerëzve ne shpëtuam nga mbytja edhe vaporin. Uji mund të shteret me pompa, kurse saldatrigeja do të ngjiste pjesët e prishura.

Atëhere gjeta rastin t'i afrohem derës së kajutes dhe pyeta mjekun:

— Si është kuzhinieri?

— Ca më mirë! — tha pa e zgjatur.

— A mund të hyj ta shikoj?

— Jo! — ma preu shkurt mjeku që e kish zënë deti.

Unë u ktheva në postin tim i mérzitur.

Kur u qetësua puna, kuzhinierit i thanë të shkonte në spital.

— Nuk shkoj në asnjë mënyrë! Unë do të shërohem këtu. Mbas dy ditësh do të filloj punën! — thoshte.

Mjeku përpiquej t'ja mbushte mendjen, por ish gjë e kotë. Atëhere komandanti i tha:

— Të urdhëroj të nisesh për në spital. Nuk jemi në luftë që të bëjmë sakrifica të tilla. Ç'punë do të bësh ti me brinjë të thyer?

Deshi e s'deshi kuzhinieri, u bë gati dhe mbas pak e ulën në portin e qytetit. Mjeku ynë e shoqëroi në autoambulancë.

Ne u kthyem në anije për të qëndruar në spirancë  
në gjiun, ku kish qetësi; por nuk doli kështu. Sipas një  
radiogrami të ardhur nga komanda eprore, ne duhej të  
shkonim në një zonë disa milje më tej. Furtuna kish zë-  
në në befasi në det disa anije peshkimi, që ishin duke  
gjuajtur peshk. Një lanxhë me dy peshkatarë ishte  
ndarë nga anija e saj. Me gjithë përpjekjet e anijes  
peshkatare, bashkimi me lanxhën qe i pamundur. Ani-  
jen e kish degdisur dallga larg. Sinjalistët e një pike  
sinjalovrojtuese kishin vënë re përpjekjet e dëshpëruara  
të dy peshkatarëve të lanxhës dhe kishin dhënë alarmin.  
Ne u afroam gjer në një farë pike. Gjithë efektivin e  
anijes sonë e kishte zënë deti. Peshkatarët ishin si mos  
më keq. Ata ishin shtrënguar fort te lanxha e tyre dhe  
mbaheshin me shpirt ndër dhëmbë. C'të bënim ne për t'i  
ndihmuar? As lanxha as motolanxha nuk punonin. Era  
vërvshëllente me tërbim. Dallgët ngriheshin dhe uleshin  
me shpejtësi. Lanxha e peshkatarëve ngrihej mbi shpi-  
nën e dallgëve, pástaj për disa çaste zhdukej. Pastaj  
prapë dilte dhe ne shikonim peshkatarët të lodhur e të  
munduar, por me shpirt të fortë. Njeri ishte i vjetër, tje-  
tri i ri. C'të bënim ne? Ata na kishin vënë re. Kur kishin  
mundësi na vështronin. Komandanti ynë vështronte nga  
ura e komandimit; ai nuk villte, po koka i dhimbte  
shumë. Detarët qëndronin në postë luftarake. C'të bënte  
komandanti? Cilit detar t'i thoshte të hidhej në det?  
Kush mund të notonte ashtu? Vetëm bocmanin e kish  
zënë deti fare pak, po ai ish i vjetër e nuk ish mirë me  
shëndet.

— Clirim! — më thërret Nikua.

— A të ka zënë deti, Niko?

— Shumë!

— Shko shtrihu!

— Jo, nuk do të shtrihem. Ne duhet të futemi në  
det! Duhet të shpëtojmë peshkatarët! Komandanti po  
pregatitet të shkojë vetë në ndihmë të peshkatarëve,  
prandaj, mblidhi forcat dhe eja të shkojmë bashkë.

— Komandanti do të shkojë? — pyeta unë sikur  
u zgjova nga ndonjë ëndërr.

— Po, po, do tē shkojë vetë. Ai nuk do tē rrezi-kojë jetën e detarëve, prandaj nuk i ka dhënë urdhër askujt tē hidhet në det.

— Nuk e lejojmë kurrë! — thashë unë dhe u ngrita me tē shpejtë nga vendi ku isha ulur.

Shkuam para komandantit. Si duket, e mori me mend se ç'donim ne. Paraqitja jonë i bëri shumë përshtypje, se ishim tē rraskapitur.

— Shkoni e pushoni në kubrik! — na tha.

— Jo, shoku komandant, ne nuk kemi nevojë pér pushim — tha Nikua.

— Jeni shumë tē dërmuar — tha ai.

— Jemi tē fortë, shoku komandant; duam tē shkojmë në ndihmë tē peshkatarëve — tha Nikua.

— Nuk keni fuqi. Nuk jeni tē zotët. Unë nuk mund tē jap një urdhër tē tillë.

— Ne kërkojmë tē na lejoni, shoku komandant.

— Ai na shikoi me vemendje.

— Ti, Çlirim, je dobësuar së tepërmi — më tha.

— Jam i fortë, shoku komandant! Sidomos në not, jam i fortë — thashë unë.

— Do tē shkojmë së bashku — tha komandanti.

— Kurrë s'do tē pranojmë tē lëvizni ju nga anija.

Vetëm po tē shkrihemë tē gjithë.

— Megjithatë duhet tē shkojmë së bashku. Ti, Çlirim, nuk duhet tē vish. Dy veta duhen. Nikua dhe unë.

— Shko! — më tha Nikua. — Ti nuk duhet tē vish.

Shko né kubrik!

Lajmi se do tē hidhej komandanti në det u hap me shpejtësi nëpër anije dhe ngriti në këmbë gjithë detarët, tē cilët u grumbulluan në kuvertë.

— Komandant, mos u hidh në det! — thanë ata.

— Nuk do pësoj gjë. Mua nuk më ka zënë deti

— u përgjegj komandanti.

— Do tē hidhem unë — tha bocmani.

— Ti nuk mund tē rezistosh — tha komandanti.

— Je i sëmurë. Të urdhëroj tē rrish në anije.

— Urdhërin tuaj do ta zbatoj gjersa tē mos hidheni ju.

Këmbëngulja e bocmanit, dhëmshuria që ndjente për të komandanti, e bënë këtë të fundit të têrhiqeji. Komandanti nuk mund të pranonte që bocmani të hidhej në ujë.

Dhe u vendos të shkonim unë dhe Nikua. Muarëm nga një salvaxhent llastiku për vete dhe nga një pér peshkatarët dhe u hodhëm në ujë. Njëherë më pérpiu honi i madh i krijuar ndërmjet dallgëve, më hyri uji i kripur në gojë; pastaj munda të dal ose më mirë më nxori vetë dallga. Po as nuk pata kohë të shikoja në siperfaqe. U zhyta prapë po me atë shpejtësi. Vërtet salvaxhenti nuk të lejon të zhytesh, po kreshtat e dallgëve ngriheshin aq lart sa arrinin të më sulmonin nga sipër.

— Çlirim! — më thirri Nikua.

— Niko!

— Qëndro se do të vemi shpejt!

— S'më lë uji të shikoj pérreth! — thashë unë.

— Ec në atë drejtim!

Ne na ndiqnin me sy e me ankth shokët e anijes sonë; ne ngriheshim lart dhe pérplaseshim poshtë. Koka ime u ndesh në një objekt të fortë. M'u përshkënditën sytë dhe m'u turbullua koka. Salvaxhenti që kisha marrë pér shpëtimin e peshkatarit më iku nga duart dhe u fundosa me kokë poshtë.

Atëhere Nikua u zhyt nën mua pér të më ngritur me kokën lart, po atje kish qenë cekinë dhe koka e tij kish ndeshur në shkëmb shumë më keq nga imja. Kur e mora veten, pashë se Nikos i rriddhte shumë gjak dhe nuk ish i zoti të mbahej. Po salvaxhentet e mbanin mbi ujë. E shtrëngova fort në krahërorin tim. Nga ana e djathtë e kokës deri në vetullën e syrit i rriddhte gjak.

Dallgët pérplaseshin rrëzë malit dhe peshkatarët qëndronin po ashtu si më parë. Mbaheshin fort te lancha e tyre. Unë shtrëngojja Nikon. Mali qëndronte i heshtur para nesh. Nga anija jonë kishin zbritur në det shumë detarë. Komandanti u printe. Ne kacafyteshim me dallgët: humbisnim dhe dilnim ashtu të pérqafuar. Nikua nuk bëzante. Gjaku i rriddhte çurk.

— Çlirim!

Kësaj here më thërriste komandanti. Na ngriti me duart e tija të fuqishme dhe na mbajti pezull. Pastaj na kapën shumë duar: të Vangjelit, Sadriut, Bektashit. Ata na kthyen për në anije.

— Merrni Nikon! — u thashë unë — Unë do të shkoj nga peshkatarët. — Nuk e dija në ç'gjendje ishte Nikua, sadoqë dukej keq. Komandanti me shefin e artilerisë kish marrë peshkatarët, u kishte vënë salva-xhentet dhe po i tërhiqte ashtu të venitur. Peshkatarët i sollën pranë nesh. U lidhëm të gjithë me njeri-tjetrin dhe iu afroam anijes sonë.

Nikua dukej gjithnjë më i lodhur.

— Niko! — .

Komandanti na tërhiqte me forcë. Asnjëherë nuk më ish dukur më i fortë.

— Niko! — thirra unë.

Ai nuk u përgjegj.

— Sikur e kisha parandjerë — më tha komandanti.

— E dija që ju nuk ishit në gjendje, po vullneti dhe këmbëngulja juaj më bënë t'ju lejoja. Nikua është keq...

— Është në rrezik — tha Vangjeli i pikëlluar.

— Nuk kemi as ndihmësmjekun këtu — tha Sadriu.

— Niko! — thirra unë.

— Mos thirr — tha komandanti.

— Ai e ka pësuar nga unë! — thashë.

— Pavarësisht — tha komandanti. — Nga ti a nga një tjetër nuk ka rëndësi. Puna është që ky është në rrezik.

Dallgët ulurinin.

— Kapuni fort me njëri-tjetrin! — tha komandanti.

Dhe ashtu të lidhur arritëm te bordi i anijes. Një vinç i fuqishëm na uli një lanxhë dhe ne mundëm të hipnim në kuvertën e anijes. Dhe nuk munda të ngrihem fare. Më çuan në kubrik. Edhe Nikon. Po ai nuk po jepte shenja jete. U mundua sanitari ynë me ndihmën e shpejtë, po më kot. Nikua nuk i hapi më sytë. Komandanti u përkul mbi të dhe e puthi. E vetmja herë që e pashë me lot në faqe.

— Niko! — bërtita unë dhe iu hodha sipër me ngashërim. Po Nikua nuk më dëgjonte më.

Deti uturinte dhe shfrynte me tërbim.

Kubriku ynë ish bërë më i heshtur. Bisedat ishin më të rralla. Ato zhvilloheshin vetëm kur ishin të domosdoshme. Unë isha bërë si i shushatur. Nuk i shkrova letër as shtëpisë as Verës.

Mirëpo ditët rridhnik dhe sillnin diçka të re. Dhe ne ditës rifitonim gjallërinë e dikurshme. Tani kur flisnim për Nikon nuk bënim më ndalesa të gjata. Një ditë më erdhë një letër nga shefi i shtabit të shkollës së instruksionit. Ai më ngushëllonte për humbjen e shokut tim të ngushtë dhe më uronte për detyrën. U mundova ta përmbaj veten por nuk durova dot pa qarë.

Në ato dit shkuam në ndihmë të fshatit.

Unë dhe disa shokë shkuam në fshatin e Verës. Kësaj here shkova drejt e në shtëpi të saj. Ajo kish vetëm të ëmën, dy motra të martuara dhe një të vogël. Një vëlla e kish në shkollë. Edhe Vera e kish marrë vesh humbjen e shokut tim.

— Ma mori mendja që do të kesh pasur ndonjë hall të madh gjersa nuk më ke shkruar letër! — më tha Vera.

— Qoftë i paharruar si shokët e tjerë dëshmorë! — tha vjehrra. — Edhe mua m'u vra yëllai në luftë.

Pastaj vjehrra u hodh në një temë tjetër. Ajo dëshronte që unë të martohesha me Verën dhe të qëndroja atje.

— Jo! — tha Vera. — Do të verni në shtëpinë e Çlirimt. S'bëhet ndryshe.

— Nuk po të pyes ty — tha vjehrra. — Unë po flas me Çlirimtin. Si thotë ai?

M'u desh t'ja prisja shkurt që shpresë e saj ishte fare e kotë.

Në fshat punuam për hapje tokash të reja, po kjo nuk zgjati shumë. Mbas dy ditësh e ndërprenë, se na doli një punë tjetër në repart, kurse mua më dhanë lejën e zakonshme.

— Unë do të shkoj me lejë në shtëpi dhe kam menduar të vish dhe ti me mua — i thashë Verës. — Nuk shkoj pa ty.

— Se si më vjen nga familja jote. Andej ka zakone të tjera.

— Ne duhet të luftojmë për të çuar kudo frymën e re. Të gjithë e dinë në fshat se ne jemi të fejuar.

## 32

Atë ditë u ngritëm herët. Kur dualëm nga shtëpia, natyra më dukej sikur qeshte. Dolëm në rrugën e maqinës.

— Leu dielli e nuk vjen maqina — tha Vera.

— S'ka gjë — thashë unë.

— Pse të mos shkojmë shpejt, meqë jemi nisur?

— Mjafton që jemi bashkë — thashë unë. — Mërzitesh?

— Jo, i dashur, pse do të mërzitem? Kam hallin tënd, se nuk ke qenë në shtëpi qysh kur. — Pastaj... ajo deshi diç të thoshte, po nuk foli. Bëri një lëvizje drejt meje.

— Ç'deshe të thuash, Vera?

— Jo, asgjë...

— Tregomë.

Ajo më shigjetoi me ata sy të zez e të mëdhenj.

— Kam qejf të të largoj këndej një herë — tha.

— Ti je shumë i dëshpëruar; je trishtuar shumë nga Nikua.

Unë hodha vështrimin andej nga ishin akostuar anijet tonë dhe m'u duk sikur e pashtë fytyrën e Nikos. M'u kujtua dita kur ngarkuam arkivolin e tij në maqinë. Ishim gjashtë detarë të armatosur e së bashku me komandantin shkuam në qytetin e tij të lindjes. Familja e tij nuk dinte gjë. Komandanti i tha s'ëmës:

— Nënë, bëhu e fortë si nënët shqiptare, se djali yt ra në krye të detyrës.

— Eshtë vrarë Nikua?

— Është vrarë, nënë...

Ajo heshti për një çast. Ky lajm i erdhi i papritur. Ishte një humbje e tmerrshme. Nëna shpejt e mori veten. Iu afroa trupit të Nikos, e zbuloi, e puthi në ballin e çarë, pastaj foli, duke na u drejtuar ne:

— E gjeti ndonjë rrezik apo u vra në detyrë?

— Jo, nënë, u vra në detyrë — tha komandanti dhe më tregoi mua me dorë. — Ja, Nikua shpëtoi jetën e këtij djali, shpëtoi jetën e këtij e dha të veten...

Nëna m'u afroa, më puthi dhe tha:

— Shyqyr, o bir, që shpëtove ti!

Unë nuk i përbajta lotët. Ajo më ledhatoi kokën. Më tha:

— Po qan? Mos qaj! Ja, unë nuk qaj. Shyqyr që ju ka lënë ju dhe ju ka dorëzuar pushkën! Jo, biro, mos qaj! Kur vdes djali me nder, s'ke pse të qash. Të na rroni ju! Të na rrojë partia! Të na rrojë Enveri! Unë kam djem boll dhe ju keni shokë boll.

Të gjithë qamë, po ajo qëndroi pa iu lagur qerpiku i syrit. E shpumë trupin e Nikos te varret. Komandanti foli shkurt dhe na preku të gjithë. Shtimë disa breshëri automatikësh në shenjë nderimi. Nëna e Nikos më puthi dlie prapë nuk qau. Unë s'përbaheshha dot...

... Ja, edhe tani, duke biseduar me Verën, më rrrohdhën lot. Edhe sytë e saj u përlotën.

— Ti s'duhet të qash — më tha mua.

— Po ti pse qan? — e pyeta.

— Ti je ushtar dhe ushtari nuk duhet të qajë.

— Edhe ti je ushtare. Nuk je ushtare? — ja fshiva lotët.

— Po, edhe unë jam ushtare, po ndryshe kur je me uniformë.

Kur hipëm në maqinë dhe pastaj lamë prapa vendin ku qemë, sikur u larguan ca mendimet për Nikon. Megjithatë, bisedën nuk e vazhduam, deri sa hypëm në tren. Atëherë unë erdha në qejf. Kishim qëndruar të mbështetur në dritare në korridordin e një vagoni dhe shikonim pejsazhin që rrëshqiste rrëmbimthi para syve tonë.

- Sa fusha të begatshme! — tha ajo.  
 — Të pëlqejnë shumë këto fusha?  
 — Shumë. Fshat e zanat i thonë. Unë që merrem  
 me bujqësi e kam syrin te fushat me prodhime të  
 mbarë.  
 — Se unë nuk merrem me bujqësi, ë?  
 — Tani je shkëputur ca. E ke mendjen në anije  
 kryesish.  
 — Sa e mirë që je, Vera! — i thashë dhe ja përmblodha dorën e saj në timen.  
 — Edhe ti je shumë i mirë.  
 — Më duket gjatë të presim edhe dy vjet...  
 — Është ca gjatë, po ja, ne këtu jemi afër dhe  
 takohemi shpesh.

Ajo më ra lehtë te supi. Treni nisi të frenojë. Vërshtelleu sirena.

Udhëtuam më shumë se njëmbëdhjetë orë atë ditë. Arritëm në fshat kur po perëndonte dielli, po u vonuam ca në pyllin e sallgamave, që kish mbjellë kooperativa (edhe unë kisha punuar shumë atje) pak vjet më parë.

— Do të shkojmë mbasi të erret, që t'i gjejmë të gjithë brenda — i them Verës. T'i dalim ashtu papritmas.

Dhe ashtu bëmë. Kur hymë në shtëpi, aty për aty Verën nuk e njohën, po pastaj e morën me mend. Babait i thamë se ishte një e deleguar dhe ai ja shtroi gjatë muhabitetit me të. Mbas ca bisedash na tha:

— Më duket se më keni gënjer.  
 — Pse, baba?  
 — Kjo nuk është e deleguar. Më duket tamam si Vera.

Ne ja dhamë gazit të gjithë. Babai u ngrit dhe u përqafua ngrohtësisht me të.

— Ty të pastë babai! — i tha Verës dhe i rrahu shpinën. — Pse, mor kopuk, nuk më tregove me kohë se kush është? Ju paça të dyve! A ke ardhur të qëndrosh tek ne përgjithnjë? — e pyeti Verën.

Ajo qeshi, po nuk u përgjegj.

— Sidoqoftë puna, ne nuk të lëshojmë më.

— Kam nënën atje se.

— Pse, gjithmënë do të rrish me nënën? Ha-ha-ha!  
Po mirë, moj, të pastë baba, merre edhe nënën më vete, po qe se nuk rri dot pa të.

Familja ime e priti Verën ashtu si nuk e kisha menduar as unë. Shtëpia u mbush me gëzim. Vera filloj ta ndihmonte nënën në punët e shtëpisë dhe në preqatitjen e gjellave. Mjaft i thoshin, që të mos punonte, po asaj nuk i rrihej.

Një ditë babai i tha nënës:

— Patëm fat me nusen. A, kjo nuk paska shqeqe.

— E pastë nana! Mos e paftë syri i keq!

— Çfarë vajze se! Mashalla!

— Po kur do të vijë ajo ditë që ta marrim, mor plak?

— I paçim shëndoshë, se dita vjen!

Gjashtë ditë para se të mbaronte leja, më erdhi një telegram nga Vangjeli. Ai më njoftonte se po çmobilizo-heshin, domethënë po dilnin detarët e vjetër nga anijet, se muajt e fundit do të bënин punë në prodhim. Domethënë nuk do të shiheshë më me shokët e mi të vjetër. Dhe sa punë kish anija ato ditë!

— Vera, do të shkojmë — i them asaj. — Do të nisemi qysh nesër.

— Ç'thua?! — më thotë babai.

— Shokët lironen dhe unë pastaj nuk shihem më me ta. Anija ka nevojë për mua.

Njerëzit e shtëpisë nuk donin të më linin të largo-heshë, meqë unë kisha të drejtë të rrija sipas rregullores, po unë ua preva shkurt, se s'rrija dot pa shkuar.

— Rrini urtë ju! — tha babai. — Shko, bir, shko! Ti je ushtar dhe bëj ashtu si i duhet ushtarit. Ne jemi këtu prapë. Po të rrrijë Vera, do të na ëmbëlsojë shunië.

— Jo, duhet të shkoj — tha ajo. — Do të vij ndonjë herë tjeter shpejt.

Të nesërmen arritëm në bazën, tonë detare.

Detarët e vjetër po bëhenë gati të iknin. Një natë para bëmë një mbrëmje.

Sa mallëngjyes ishte çasti i ndarjes! Kurrë nuk i

kisha parë lot në sy Vangjelit. Edhe unë u mallëngjeva shumë. Pastaj u ngjall edhe kujtimi i Nikos.

— Mos kështu, Vangiel! — tha komandanti. — Ti po shkon te gruaaja, te fëmija. O burra, Vangjel, duam marinare të tierë!

— Ah, shoku komandant... Kemi shkuar si vëllezër... Kemi kujtime që... Sa vështirësi, sa tufane kemi kaluar bashkë...

— Prapë vëllezër do të jemi. Prapë do të takohemi. As paskëtaj s'do të jemi të ndarë. Republika jonë është nië anije e madhe, në të cilën shërbimë ne të gjithë. Ne jemi në bordin e verëndimit, ti në të lindjes, tjetri në bash. tjetri në kic. Të gjithë së bashku me punën tonë e vemë në funksionim këtë anije vigane. Mund të jemi ca larg nga njeri tjeri, por puna na afron shumë. O burra, Vangiel, të na shtosh detarë të vegjël!

Në orën tetë detarët e vjetër ishin rrështuar për tu përshëndetur me shtabin e repartit.

Komandanti i repartit u tha:

— Shokë! Detyrën tuaj të gjatë dhe të vështirë e kryet me nder. Ju jeni brezi, të cilit i takoi të vuante më shumë. Ju qetë dëshmitarë të blokadës dhe të shumë poshtërsive që u përpoqën të bënин revisionistët. Por ju s'u dorëzuat. Vuaitët shumë, por korrët fitore...

Datarët e vjetër hipën në rimorkiator, duke na përshëndetur me kapat e kokës. Oshëtinë sirenat e rërëshëndeties. Unë përshëndesja me duar dhe u mallëngjeva. M'u kujtua Nikua. Po të ishte ai, do të merrte kitarën dhe do t'i përcillte shokët me ndonjë melodi.

Datarët tundnin kapat.

— Mirë u pafshim! Mirë u pafshim!

Rimorkiatori çante dallgët me gulcima. Deti oshëtinte nga sirenat dhe zhaurimat e dallgëve.

— Mirë u pafshim!

- 33 -

Shokët tanë u çmëbilizuan. Ne vazhduam të kryejmë detyrën tonë. Punonim për preqatitjen e kuadrove të reja që na kishin ardhur.

Kështu kalonin ditët, muajtë, vitet: detyra të reja kursore, alarme, takime, ndarje.

Erdhi koha që edhe unë e shokët e datëlindjes sime të ndaheshim nga deti, të çmobilizoheshim nga radhët e ushtrisë.

Në një mëngjerez tatori u rreshtuam në sheshin e repartit. U mbajtën ca fjalime të shkurtëra. U përqafuan me shokët dhe komandantët, hipëm në anijen e transportit, oshëtinë sirenat, u tundën kapat e flamujtë. E njëjtë skenë, sadoqë me nuanca të ndryshme, ishte përsëritur çdo vit. Dita qe e kthjellët, e kristaltë.

Anija jonë çau drejt limanit. Unë kisha qëndruar në pupë dhe vështroja bazën ushtarake. Tani nuk i shquaja më shokët në bankinë duke përshëndetur me dorë, po e dija që atje ishin të grumbulluar. Disa të tjerë me sëguri na vështronin me dylbi nga urat e komandimit.

Baza mbeti gjithnjë e më larg, aq sa filluam të mos e dallojmë më. Atëherë në zemrën time ndjeva një zbrazëtirë të çuditshme. Më pushtoi një mall i patregueshëm.

— Ç'ke kështu, Clirim? — më tha një shok. — Shokët i lamë shëndoshë e mirë, puna shkon edhe më mirë, detyrën e kryem me nder, pse të mërzitemi? Aq më tepër ti, Clirim, që do të martohesh tani.

— A do të na ftosh në dasmë?

— E mirë, mirë, po ç'nevojë kemi përfesa ne? Vemi, ore, pa ftesa.

— Vetëm të dimë datën. A po na e tregon datën?

— Do t'ju marr adresat dhe t'ju bëj telegrame të gjithëve — thashë unë.

— Jo, do ta caktojmë qysh këtu datën — tha njëri.

— Si, pa i pyetur të dy familjet? — tha një tjetër.

— Familje jemi edhe ne. Po caktojmë një datë ca të largët.

— Nuk e prishin familjet vendimin e kolektivit.

— Atëherë flisni — u thashë unë. — Do t'ja them edhe Verës që datën e caktoi kolektivi.

— Sot një muaj — tha njéri.

— Shumë mirë! — e miratuan të gjithë.

— E lamë kështu megjithë mend?

— E lamë.

Kjo bisedë po ma largonte mallin e mëparshëm. Fillova të qesh nga pak. Shokët ja morën një këngë me zë shumë të lartë.

— Dëgjoni! — bërtiti njeri nga shokët.

Kënga u ndërpre, Nëpërmes zhurmave që lëshonte anija, me të cilën udhëtonim, dëgjuam një ulëritje të ethshme sirene, sado që vinte nga larg.

— Alarm në repart!

— Të marrim vesh përsë bëhet ky alarm.

Shkuam te kabina e radios dhe i thamë radistit të pyeste shpejt. Mbas pak minutash muarëm vesh se ish alarm luftarak. Dikush tha:

— Provokacioni!

— Ndoshta sulm i rëndë!

— Dhe pikërisht sot që u liruam ne!

— Shokë! — bërtiti njeri nga detarët e çmobilizuar.

— Të kthehem!

Të tjerët u ngritën nga vendi.

— Të kthehem! — Të kthehem! — repart! Ku e dimë ne se ç'do të ndodhë? Po sikur të sulmohemi? — vazhdoi detari.

— Propozim me vend.

— Duhet të kthehem! — bazë patjetër.

— Komandant, ktheje anijen në bazë — foli i shqetësuar njeri nga shokët.

— Si?!

— Anijen në bazë. Është dhënë alarm luftarak dhe ne duhet të shkojmë me shokët.

— Si kështu? Unë kam urdhër t'ju dorëzoj patjetër në qytet.

— Urdhéri ishte për kohë paqeje. Është dhënë alarm, mund të na jetë shkelur kufiri. Jemi në luftë.

— Unë kam urdhër...

— Kthejeni, ju lutemi!

Ne u ngritëm të gjithë në këmbë. Komandanti e ktheu anijen nga baza e flotës.

— Të gjithë forcën përpëra, komandant! Të lutemi shumë!

Anija po çante drejt bazës me shqetësinë më të

madhe. Nga porti ushtarak nisën të dilnin njeri pas tjetrit terpedinierët.

— Komandant! Shpejt, komandant!

Torpedinierët hapnin tunele shkume të bardhë. Në po afroheshim!

Oh, sa të gjata ato minuta!

Kur arritëm në portin ushtarak, disa anije ishin çakostuar. Në të tjerat kishte mjaft lëvizje. Arritja jonë shkaktoi entuziazëm. Me gjithë punën e madhe që kishin, detarët dilnin për një moment dhe shikonin e miratonin ardhjen tonë.

— Po ju? — na tha komandanti i repartit.

— Ne erdhëm për të zënë përsëri postet e luftimit...

... Alarmi luftarak nuk zgjati shumë. Sidoqoftë komanda nuk pati nevojë për ne. Të gjitha masat e duhura ishin marrë.

Atë ditë ne qëndruam në bazë. Do të niseshim të nesërmen...

Komanda organizoi me këtë rast një ceremoni të shkurtër, që ndryshonte nga të tjerat. Me urdhër të komandantit të repartit, u mblohdh gjithë efektivi. Ne u rrjeshtuam në rregull të plotë në një vend të vegantë.

Nuk do t'i harroj kurrë fjalët që na drejtoi komandanti:

— Shokë detarë të çmobilizuar! Gatishmëria juaj, shpirti juaj luftarak për mbrojtjen e Atdheut tregon se ju do të jeni për jetë ushtarë të partisë. Ne, si komandë, krenohemi me ju. Shembulli juaj do t'u vlejë detarëve tanë të rinj si një frymëzim i lartë.

Ngado që të shkoni, kini parasysh gjithnjë mbrojtjen e Atdheut tonë socialist, detyrën tonë më të lartë! Në emër të komandës, ju falënderoj!»

Një thirrje e fuqishme buçiti nga gjokset tona:

— I shërbejmë Republikës Popullore të Shqipërisë!»

## F u n d

Pukë, 1965